Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

Kadri BALAJ, Shaban XHELADINI, Zenel ZENELI dhe Mustafë NERJOVAJ

kundër

UNMIK-ut

Lënda nr. 04/07

MENDIM

27 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

Faqe nr.

I. PROCEDURAT PARA PANELIT 1
Error! Bookmark not defined.

II. FAKTET 3

A. Historiku i përgjithshëm

1. UNMIK-u si autoritet qeverisës në Kosovë 3
2. Lëvizja Vetëvendosje 4
3. Situata politike dhe e sigurisë para ngjarjeve 4
4. Struktura dhe përgjegjësitë e Policisë së UNMIK-ut më 10 shkurt 2007 6

B. Rrethanat që çuan në vdekjen e z. MonBalajdhe z. Arben Xheladini dhe plagosjene z.Zenel Zeneli dhe z.Mustafë Nerjovaj

1. Njoftimi për një demonstratë nga Vetëvendosje
7**Error! Bookmark not defined.**
2. Veprimet përgatitore të autoriteteve të UNMIK-ut 7
3. Demonstrata dhe ngjarjet e ndërlidhura më 10 shkurt 2007 9
4. Zhvillimet pas ngjarjeve 11

C. Hetimi

1. Hapja e dosjeve relevante 12
2. Hapat fillestarë hetimorë 12
3. Hetimi i Policisë së UNMIK-ut dhe prokurorit special 13
4. Të gjeturat dhe përfundimet e prokurorit special 16
5. Mbyllja e hetimeve nga prokurori special 20
6. Hetimi i kryer nga Inspektorati i Policisë së Kosovës 21
7. Hetimi nga autoritetet gjyqësore rumune 22
8. Hetimi administrativ i OKB-së / Procedurat disiplinore 22
9. Procedura për ankesa nga pala e tretë e OKB-së / Pagesa e kompensimit 22

III. ANKESA 23

IV. LIGJI

A. Ligji relevant vendor 24

1. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1 24
2. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 24
3. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë 25
4. Dispozitat e Ligjit dhe Procedurës Penale 26
5. Ligji mbi Prokurorin Publik 26
6. Emërimi dhe caktimi i prokurorëve ndërkombëtarë 27
7. Dispozitat ligjore në fushën e sigurisë publike 29
8. Rregullat që rregullojnë përdorimin e forcës nga policia 30

B. Parimet dhe normat relevante ndërkombëtare 32

C. Shkelja e pretenduar e nenit 2të KEDNJ-së 35

Pranueshmëria 36

Bazueshmëria 36

1. Parashtresat e palëve 36

a. Mbi obligimin esencial sipas nenit 2 36
b. Mbi obligimin procedural sipas nenit 2 37
2. Vlerësimi i Panelit 39
a. Dorëzimi i dosjeve relevante 39
b. Aplikueshmëria e nenit 2 të Konventës 39
c. Shkelja e pretenduar e obligimit esencial sipas nenit 2 41
i. Parimet e përgjithshme 41
ii. Pajtueshmëria me obligimin esencial sipas nenit 2 43
d. Shkelja e pretenduar e obligimit procedural sipas nenit 2 45
i. Parimet e përgjithshme 45
ii. Pajtueshmëria me obligimin procedural sipas nenit 2 48

D. Shkelja e pretenduar e neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së 53

E. Shkelja e pretenduar e nenit 11 të KEDNJ-së 53

1. Parashtresat e palëve 54
2. Vlerësimi i Panelit 55
a. *Aplikueshmëria e nenit 11 të Konventës* 55
b. *Ekzistenca e një interference me të drejtat e ankuesve* 56
c. *Arsyetimi për interferencë* 57

V. KOSTOT DHE SHPENZIMET 59

VI. KOMENTE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE 60

Shtojca:

SHKURTESAT DHE AKRONIMET 61

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 27 shkurt 2015,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 11 tetor 2007 dhe është regjistruar po të njëjtën ditë. Gjatë procedurave para Panelit, ankuesit u përfaqësuan nga z.HalimSylejmani, avokat nga Kosova dhe z.PaulTroopdhe z. Jude Bunting, avokatë nga Mbretëria e Bashkuar.

2. Për sa i përket historikut të plotë të procedurave, Paneli i referohet vendimeve të veta mbi pranueshmërinë për këtë rast të 31 marsit 2010 (§§ 11-31) dhe 11 majit 2012 (§§ 3-17)[1].

3. Më 5 shkurt 2009, duke iu përgjigjur kërkesës së Panelit, ish-ushtruesi i detyrës së drejtorit të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut (DD), informoi atë për pajtimin e vet për t'i paraqitur Panelit dosjen e plotë hetimore penale në lidhje me këtë rast.

4. Më 10 shkurt 2009, UNMIK-u i kërkoi Panelit t'ia dërgojë gjithë materialin e pranuar hetimor asaj zyre, pasi nevojitej "për procedurën e kërkesës për kompensim në rrjedhë në selinë e OKB-së në NJU JORK" (Procesi për ankesa nga pala e tretë e OKB-së).

5. Më 18 shkurt 2009, Paneli pranoi dosjet nga zyra e ushtruesit të drejtorit të DD-së. I gjithë materiali është transferuar së shpejti pas kësaj nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut, siç kërkohej.

6. Më 19 mars 2009, Paneli mbajti një seancë të mbyllur shqyrtimi për këtë rast, e cila u ndoq nga ankuesit, përfaqësuesit e tyre dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut. Gjatë seancës së shqyrtimit ankuesit njoftuan se ata nuk do të marrin pjesë më në një seancë të mbyllur shqyrtimi dhe kërkuan që ajo të bëhej publike. Nga ana e tij, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) informoi Panelin se përfaqësuesit e UNMIK-ut nuk do të ndiqnin seancën e shqyrtimit sipas procedurave të parapara nga Paneli dhe se ai kishte për qëllim të miratojë një udhëzim administrativ, i cili do të qartësonte natyrën e seancave

[1]Të gjitha tekstet janë në dispozicion në faqen e internetit të Panelit: www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/default.aspx

publike të shqyrtimit para Panelit. Në dritë të kësaj, më 12 maj 2009, Paneli vendosi të mosvazhdojë me seancën e shqyrtimit.

7. Më 31 mars 2010, Paneli e shpalli ankesën të papranueshme, duke pasur parasysh Udhëzimin Administrativ nr. 2009/1 të 17 tetorit të vitit 2009 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Në atë vendim, Paneli konkludoise sapo të përfundonte procesi i planifikuar për ankesa të palës së tretë i OKB-së, "ankuesit [do të mund] t'i kërkonin Panelit t'i rihapë … procedurat".

8. Më 17 dhjetor 2010, ankuesit informuan Panelin për përfundimin e procesit të ankesave të palës së tretë të OKB-së për sa i përket secilit nga ta. Të gjithë ankuesit kishin pranuar kompensim dhe nënshkruan një formular për t'iu dhënë fund pretendimeve në të ardhmen kundër UNMIK-ut. Ata i kërkuan Panelit qëtë procedojë me ankesën siç i është paraqitur fillimisht atij, në veçanti pjesët procedurale të ankesës.

9. Pas kërkesës së ankuesve, në një vendim të miratuar më 11 maj 2012, Paneli vendosi t'i rihapë procedurat, ta shpallë rastin të pranueshëm dhe të procedojë me shqyrtimin e bazueshmërisë së tij.

10. Më 14 maj 2012, Paneli informoi ankuesit dhe UNMIK-un për vendimin e vet për t'irihapur procedurat dhe ftoi palët t'ipërfundojnë komentet e veta.

11. Më 30 maj 2012, z.Sylejmani informoi Panelin se nuk do të kishte asnjë koment shtesë në të ardhmen.

12. Në dritë të përfundimit të procedurës për kompensim të OKB-së, më 30 korrik 2012 Paneli i kërkoi PSSP-së t'i kthehet atij dosja e plotë hetimore. Nuk kishte përgjigje ndaj kësaj kërkese.

13. Më 4 shtator 2012, PSSP-ja ofroi komentet përfundimtare të UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e ankesës, duke bërë të ditur se ai do të mund të dorëzojë komente shtesë në një fazë më vonë.

14. Më 23 prill 2013, Paneli kërkoi sqarim shtesë nga PSSP-ja dhe përfaqësuesi i ankuesve. Përfaqësuesi i ankuesve u përgjigj më 15 korrik 2013. PSSP-ja nuk përfitoi vetë nga mundësia për të ofruar sqarime shtesë.

15. Në kërkesën e njëjtë të 23 prillit 2013, Paneli ia përsëriti PSSP-së kërkesën e vet për kthim të dosjes së plotë hetimore te Paneli.

16. Më 30 tetor 2013, UNMIK-u ia ktheu dosjen e kërkuar Panelit (shih§ 61më poshtë).

17. Më 5 dhe 8 dhjetor 2014, me kërkesën e Panelit, Policia e UNMIK-ut ofroi informata shtesë.

II. FAKTET

18. Ankesa e paraqitur fillimisht nga ankuesit ka të bëjë me veprimet e Njësiteve të Formuara Policore nga UNMIK-u (NJFP) që përbëheshin nga policë nga vende të ndryshme, me rastin e një demonstrate protestuese të organizuar në Prishtinë nga Lëvizja Vetëvendosje, më 10 shkurt 2007. Si rezultat i këtyre veprimeve, z.Mon Balaj, djali i ankuesit të parë, dhe z.Arben Xheladini, djali i ankuesit të dytë, ishin vrarë, dhe demonstruesit e tjerë ishin plagosur, disa seriozisht, duke përfshirë z.Zenel Zeneli dhe z.Mustafë Nerjovaj, ankuesi i tretë dhe i katërt.

A. Historiku i përgjithshëm[2]

1. UNMIK-u si autoritet qeverisës në Kosovë

19. Ngjarjet në fjalë ndodhën në territorin e Kosovës derisa ishte nën kontroll të UNMIK-ut. Misioni u themelua nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, më 10 qershor1999, me miratimin e Rezolutës 1244 (1999), ku ai mori vendim për vendosjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe civile-përkatësisht të KFOR-it dhe UNMIK-ut, në territorin e Kosovës.

20. Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1244 (1999), OKB-ja u ngarkua me kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive për administrimin e Kosovës, duke përfshirë administrimin e drejtësisë. Përmes Rezolutës 1244 (1999), UNMIK-ut i jepet, po ashtu, mandati që t'i "promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

21. Nga themelimi i UNMIK-ut deri më 9 dhjetor 2008 (shih § 24më poshtë), Policia e UNMIK-ut, e udhëhequr nga komisari i Policisë së UNMIK-ut, kishte primatin në zbatimin e ligjit në të gjitha rajonet e Kosovës. Formimi i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) gjithashtu kishte filluar pothuaj menjëherë. Ndërsa SHPK-ja po rritej sa i përket kapacitetit dhe ekspertizës, nga viti 2002 e tutje, disa funksione për zbatimin e ligjit nisën që të ndahen gradualisht dhe t'idorëzohen më vonë SHPK-së nga Policia e UNMIK-ut. Megjithatë, Policia e UNMIK-ut ruajti kontrollin e përgjithshëm për zbatimin e ligjit në Kosovë, si dhe një rol monitorues dhe këshillues.

22. Ndërsa punonte për vendosjen e sistemit të administrimit të drejtësisë në Kosovë, UNMIK-u së pari themeloi, në qershor të vitit 1999, një Sistem emergjent të drejtësisë që përbëhej nga një numër i kufizuar gjyqtarësh dhe prokurorësh vendorë. Sistemi i rregullt i drejtësisë u bë operacional në janar të vitit 2000. Në shkurt të vitit 2000, UNMIK-u autorizoi emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, fillimisht në rajonin e Mitrovicës dhe më vonë në gjithë Kosovën, për të forcuar sistemin lokal të drejtësisë dhe për të garantuar paanësinë. Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë i ishin bashkangjitur gjykatave të qarkut dhe zyrave të prokurorive publike në Kosovë, duke kryer të gjitha funksionet gjyqësore dhe prokuroriale. DD i UNMIK-ut ushtroi kontrollin e plotë mbi funksionimin e gjyqësisë.

---

[2]Referencat e nxjerra nga Paneli për të përcaktuar historikun e përgjithshëm, mes tjerash, përshijnë: Raportet tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë; Raportet vjetore të Policisë së UNMIK-ut; faqja e internetit e Lëvizjes Vetëvendosje (www.vetevendosje.org).

23. Siç sqarohet në dokumentin e paraqitur nga Policia e UNMIK-ut dhe Komponenti i Drejtësisë (korrik 2003), Njësitet Speciale të Policisë së UNMIK-ut (NJSP) ishin "një komponent i veçantë i Policisë së UNMIK-ut. NJSP kryejnë funksion profesionalduke pasur parasysh atë që ato paraqesin një forcë të madhe, parushtarake, mobile dhe të pavarur të policëve të aftë për vendosje të shpejtë në situatat me rrezik të lartë." Pasi u vendosën, NJSP-të "erritën në thelb kapacitetin e UNMIK-ut për të kryer funksione policore taktike." Në dokumentin e njëjtë sqarohet më tutje se "detyrat kryesore të NJSP-ve janë që të përgjigjen ndaj trazirave publike, kontrollojnë turmën gjatë demonstrimeve të dhunshme dhe trazirave civile, ofrojnë mbrojtje të objekteve dhe asistencë agjencive të OKB-së ku është e nevojshme, dhe t'u ofrojnë mbrojtje dhe siguri zyrtarëve të OKB-së, Policisë së UNMIK-ut dhe Policisë Kufitare në kryerjen e detyrave të tyre. NJSP-të po ashtu i ofrojnë Policisë së UNMIK-ut përkrahje dhe mbështetje operacionale."

24. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli njëanshëm pavarësinë e saj nga Serbia. Më pas, më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

2. Lëvizja Vetëvendosje

25. Lëvizja Vetëvendosje (Lëvizja për Vetëvendosje, Vetëvendosje) me sa duket u formua në vitin 2004. Ajo e përkufizon veten si "një bashkësi e njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen, ... synojnë të arrijnë dhe realizojnë të drejtën për vetëvendosje për popullin e Kosovës ... duke punuar për të arritur ndryshime radikale shoqërore dhe politike që do të mundësojnë respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për secilin dhe çdo qytetar të Kosovës pa diskriminim."

26. Aksioni i parë kuVetëvendosje për herë të parë shprehu qëndrimin e saj të fuqishëm në favor të pavarësisë së Kosovës, u realizua më 17 korrik 2005 kur 24 aktivistë të lëvizjes spërkatën sloganin e tyre "Jo negociata – Vetëvendosje" në murin që rrethonte selinë e UNMIK-ut në Prishtinë. Që nga ajo kohë deri në shkurt të vitit 2007, kjo organizatë kreu një numër aksionesh publike të drejtuara kundër përfshirjes ndërkombëtare në çështjet "e brendshme" të Kosovës.

27. Veçanërisht e rëndësishme ishte demonstrata e mbajtur nga Vetëvendosje nëPrishtinë, më 28 nëntor 2006. Para kësaj demonstrate, Vetëvendosje kishte bërë deklaratën vijuese publike:

> "Populli shqiptar po përballet me rrezikun tjetër [për shkak të] armikut tonë të paepur, Serbisë. Populli i Kosovës tani shtypet nga institucionet politike të UNMIK-ut. Ata po i shkelin të drejtat tona në çdo fushë të jetës shoqërore … Kosova qeveriset nga një sistem politik neokolonial i quajtur UNMIK, një projekt politik i bazuar në Rezolutën famëkeqe1244 …Por problemi më i madh

mbetet fakti se, si maja e të gjitha këtyre gjërave për t'u përmendur, Serbia i ka hapur pretendimet për të riokupuar Kosovën."[3]

3. *Situata politike dhe e sigurisë para ngjarjeve*

28. Situata në Kosovë në muajt para ngjarjeve që janë si lëndë e kësaj ankese u karakterizua me një nivel të lartë të tensionit për shkak të "propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës" (Planii Ahtisaarit) dhe të ardhmen e paqartë të krahinës. Ajo përshkruhet gjerësisht nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, në raportin e tij të 9 marsit të vitit 2007 për Këshillin e Sigurimit (S/2007/134), në pjesët relevante të të cilit thuhet:

> "3. Statusi i ardhshëm i Kosovës ka mbetur çështja kryesore politike në Kosovë gjatë periudhës për të cilën raportohet. Njoftimi i të Dërguarit tim të Veçantë më 10 nëntor se paraqitja e tij e Propozimit për Zgjidhje palëve do të vonohet deri pas 21 janarit për të lejuar mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare në Serbi, u prit me pakënaqësi të thellë nga shqiptarët e Kosovës. Reagimi në mesin e popullatës ishte përgjithësisht i përmbajtur, me përjashtim të një demonstrate të Lëvizjes së shqiptarëve të Kosovës Vetëvendosje më 28 nëntor, Ditën e Flamurit Shqiptar, në të cilën të dyja, Qeveria dhe selia e UNMIK-ut në Prishtinë u sulmuan nga përafërsisht 4,000 demonstrues duke hedhur objekte**.**
>
> 4. Propozimi për Zgjidhje u pranua përgjithësisht mirë më 2 shkurt [2007] nga udhëheqësit e shqiptarëve të Kosovës dhe publiku, megjithëse një numër shqetësimesh u shprehën për elementet e tij sikur shpërbërja e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK) dhe decentralizimi. Elementet radikale të shqiptarëve të Kosovës dhe serbët e Kosovës refuzuan Propozimin për Zgjidhje, megjithëse për arsye të kundërta…
>
> 8. … Kishte një numër relativisht të vogël të incidenteve potenciale destabilizuese. Niveli i përgjithshëm i krimit shënoi rënie gjatë vitit 2006… Fusha e vetme me një rritje të rëndësishme ishte te krimet kundër pronës … Incidentet potenciale me motiv etnik, po ashtu, shënuan rënie të rëndësishme...
>
> 9. Vetëvendosjedhe lidhjet e tyre me grupimet e tjera sikur Shoqata e Veteranëve të Luftës mbesin një arsye për shqetësim. Grupet radikale ka të ngjarë të vazhdojnë të shfrytëzojnë çdo pakënaqësi publike që pason nga propozimi i të Dërguarit tim të Veçantë dhe procesi i ardhshëm për statusin, duke përfshirë vonesat në proces. Elementet e tjera radikale mund të kërkojnë që të shfrytëzojnë atmosferën e ngarkuar të procesit për statusin e ardhshëm për të provokuar dhunë ndëretnike për qëllimet e tyre të fundit …"

29. Në anën tjetër, ky është përshkrimi i demonstratave të 28 nëntorit të vitit 2006, i dhënë nga Vetëvendosje[4]:

---

[3]Shih Buletinin (në gjuhë nangleze) nr. 19, i 26 nëntorit të vitit 2006, në dispozicion në faqen e internetit të Vetëvendosjes [burimi elektronik] - www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/newsletter_19.pdf (e qasurmë 20 janar 2015).

[4]Shih Buletinin (në gjuhën angleze) nr.20, 3 dhjetor 2006, në dispozicion në faqen e internetit të Vetëvendosjes [burimielektronik] - www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/newsletter_20.pdf (i qasur më 20 janar 2015).

"Kjo është ajo që vërtet ndodhi të martën e 28 nëntorit. Dhjetëra/mija njerëz marshuan nëpër qendër të Prishtinës. Te ndërtesa e Qeverisë, Albin Kurti mbajti një fjalim të shkurtër për të potencuar përsëri objektivin e demonstratës: për të kundërshtuar ekipin negociator të Kosovës. Pastaj aktivistët gjuajtën shishe të mbushura me ngjyrë të kuqe në muret e ndërtesës, dhe në dritare, dhe ne ngjitëm '5 arsyet'[5]për sulmin tonë në porta. Disa njerëz në turmë gjuajtën gurë, të cilët organizatorët tanë provuan t'i ndalin. Ne e dinim se shumica e stafit në ndërtesë nuk punonte atë ditë, dhe para se të fillonte aksioni, ne i thamë policisë të largohenprapa ashtu që të mos lëndohen. As një person i vetëm nuk u lëndua si rezultat i demonstratës tonë. Kjo është një dëshmi e organizimit profesional të demonstratës dhe kontrollit të saj nga aktivistët tanë.

Pas kësaj, ne lëvizëm me turmën kah UNMIK-u ku ne vendosëm një dry në portën kryesore dhe e larguam një pllakë të murit mbrojtës që e rrethon ndërtesën. Një varg aktivistësh mbrojtën hyrjen, duke parandaluar turmën të hyjë sepse ky nuk ishte objektiv yni. Pastaj ne, po ashtu, gjuajtëm shishe me ngjyrë të kuqe në drejtim të UNMIK-ut. Ngjyra e kuqe është përdorur për të simbolizuar ngjyrën e flamurit dhe ngjyrën e gjakut. Policia e UNMIK-ut gjuajti gaz lotsjellës te turma, që nxiti një reagim të gjuajtjes me gurë, të cilin ne përsëri provuam ta ndalim. Megjithëse gjuajtja e gurëve nuk ishte plan yni, ne e kuptojmë indinjatën e njerëzve dhe si organizatorë e marrim përgjegjësinë për këtë akt. Pavarësisht gazit, ne ngjitëm'5 arsyet' për sulmin tonë në mur.

Turma u ribashkua pas pak minutash, dhe ne vazhduam marshin tonë derisa arritën në zyrën tonë dhe Albin Kurtisqaroi se demonstrata përfundoi. Të gjithë u larguan në mënyrë të qetë.

Lëvizja jonë kurrë nuk është njohur për 'rezistencë pasive'. Çdo aksion ka shkaktuar ndonjë formë të dëmit,me qëllim të dërgimit të një mesazhi UNMIK-ut dhe IPVQ-ve [Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje]: të shkruarit e grafitevenë mure, në Jeep-a të UNMIK-ut, shfryrja e gomave të tyre, gjuajtja e ngjyrës në ndërtesa, gjuajtja e vezëve, bojkoti i produkteve serbe, rënia e borisë për një njoftim emergjent për UNMIK-un dhe bllokimi i institucioneve dhe kufirit. A është bojkoti më pak i dhunshëm sesa thyerja e një dritareje?

Ne jemi të padhunshëm sepse ne kurrë nuk kemi kërcënuar jetët e njerëzve apo bërë përpjekje për të lënduar apo vrarë njerëz. Shënjestra jonë e vetme janë institucionet dhe ndërtesat apo veturate tyre. Ky është mjeti i vetëm i padhunshëm që ne e kemi për t'i parandaluar këto institucione nga çuarja e Kosovës drejt një lufte të sigurt."

4. Struktura dhe përgjegjësitë e Policisë së UNMIK-ut më 10 shkurt 2007

30. Sipas manualit mbi Procedurat dhe Politikën i Policisë së UNMIK-ut, i datës 16 gusht 2005, në atë kohë relevant për këtë rast, Policia e UNMIK-ut përbëhej nga Policia Civile, Policia Speciale dhe Policia Kufitare (PK).

[5]Për tekstin e plotë të këtyre"5 arsyeve" të Vetëvendosjes, shih *ibid.*

31. Policia e UNMIK-ut udhëhiqej nga komisari i Policisë së UNMIK-ut. Komanda e lartë e Policisë së UNMIK-ut gjithashtu përfshinte:

- Katër zëvendëskomisarët e policisë në fushat vijuese: Operacionet, krimi, Administrata e Policisë së UNMIK-ut, dhe Administrata e SHPK-së;
- Komandantin e PK-së;
- Shefin e shtabit;
- Drejtorin e operacioneve.

32. Deri në shkurt të vitit 2007, disa pozita në kuadër strukturës komanduese të Policisë së UNMIK-ut, për shembull zëvendëskomisari i policisë për SHPK-në, zëvendësasistenti i komisarit të policisë /operacionet, udhëheqësi i Departamentit të Rendit Publik dhe inspektori kryesor i Inspektoratit të Policisë së Kosovës (IPK),kishin qenë të zëna nga oficerët e SHPK-së. Paneli nuk e ka të qartë nëse ndonjë oficer i Policisë së UNMIK-ut ishte nën vartësinë e oficerëve të SHPK-së dhe, nëse po, nëse kjo e fundit ishte e autorizuar për t'iu dhënë urdhra oficerëve të Policisë së UNMIK-ut.

B. Rrethanat që çuan në vdekjene z. Mon Balaj dhe z. Arben Xheladini dhe plagosjen e z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj

1. Njoftimi për një demonstratë nga Vetëvendosje

33. Në njoftimin e vet publik të lëshuar më 5 shkurt 2007[6], Lëvizja Vetëvendosje i bëri thirrje publikut të gjerë qëtë dalë në një demonstratë kundër Planit të Ahtisaariit. Ata gjithashtu deshën të shprehin pakënaqësinë rreth mandatit të përgjithshëm dhe sjelljen e UNMIK-ut dhe IPVQ-ve në Kosovë. Demonstrata do të mbahej më 10 shkurt 2007, në qendër të qytetit të Prishtinës. Njoftimi dhe ftesa për t'iu bashkuar demonstratës gjithashtu u shpërndanë përmes mesazheve me tekst në telefonat mobilë, si dhe përmes internetit-rrjeteve sociale.

34. Sipas informatave të pranuara nga Paneli, Vetëvendosje nuk i informoi zyrtarisht autoritetet relevante të UNMIK-ut për planet e tyre për të organizuar këtë demonstratë apo për itinerarin e tyre të planifikuar; dhe as që bëri të ditura detajet e tjera relevante. Megjithatë, autoritetet e UNMIK-ut duket të kenë qenë plotësisht të informuara rreth kohës dhe vendit në të cilin ishte planifikuar të mbahej demonstrata.

2. Veprimet përgatitore të autoriteteve të UNMIK-ut

35. Plani i operacioneve,i quajtur "Urdhri Operacional për Demonstratën e LVV[Lëvizja për Vetëvendosje] më 10 shkurt 2007" (Plani Operacional),u përgatit nga Njësiti për Planifikim të Operacioneve i Shtabit të Përgjithshëm të Policisë së UNMIK-ut (SHP), dhe iu dërgua të gjithësektorëverelevantë të SHP të Policisë së UNMIK-ut, të gjitha SHP rajonale të policisë,SHP të PK-ve dhe të gjitha NJFP-ve. Në faqen e parë thuhet se, para shpërndarjes, Plani Operacional duhej aprovuar nga të gjithë komandantët rajonalë të policisë, të Policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së: drejtori i operacioneve, zëvendëskomisari për operacione dhe zëvendëskomisari i policisë. Aprovimi

[6]Shih Buletinin (në gjuhën angleze) nr.28, 5 shkurt 2007, në dispozicion në faqen e internetit të Vetëvendosjes [burimi elektronik] - www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/newsletter_28.pdf (e qasur më 20 janar 2015).

përfundimtar duhej dhënë nga komisari i Policisë së UNMIK-ut. Megjithatë, asnjë kopje e nënshkruar e planit operacional nuk është në posedim të Panelit.

36. Në kapitullin 1, "Informata", të Planit Operacional, mes çështjeve të tjera, vlerësohej rreziku i përgjithshëm i pritur si "mesatar" por paralajmëroheshin Policia e UNMIK-ut dhe njësitet e SHPK-së se disa provokime ishin të mundshme.

37. Në kapitullin 2, "Qëllimi", të Planit Operacional, theksohej: "Është qëllim i komisarittë Policisë që policia t'i përmbahet politikës strategjike siç është përcaktuar në dhjetorin e vitit të kaluar [2006] ... gjatë përballjes me protesta/demonstrata." Politika që përmendej atje, e titulluar "Udhëzime të komisarittë Policisë për t'u përballë me demonstratat spontane apo të njoftuara nga Lëvizja Vetëvendosje", me sa duket është dashur t'i bashkëngjitej Planit Operacional si "Shtojca A". Përmbajtja e saj nuk është e njohur për Panelin, pasi kopja në posedim të tij nuk ka shtojcë të tillë. Kapitulli 2 përfundon si në vijim: "Përgjigjja policore do të jetë proaktive dhe veprimi parandalues do të ndërmerretkurdo që është e nevojshme. Masat e sigurisë për këtë operacion duhet të jenë të profilit të lartë. Rregullat standarde të angazhimit vlejnë!"

38. Në kapitullin 3, "Metoda", të Planit Operacional, qartësoheshin linjat komanduese dhe përcaktoheshin funksionet e secilit element apo njësiti të policisë që merrte pjesë në operacion.

39. Në kapitullin 5, "Komunikimet", të Planit Operacional thuhej se udhëheqësi i operacionit ishte zëvendëskomisari për operacione dhe se "[a]ido të informohet për secilin incident në lidhje me këtë operacion duke kaluar përmes Dhomës së Operacioneve të SHP apo stafit të SHP të Qendrës Komanduese."

40. Nga deklaratat e një numri oficerësh të intervistuar të Policisë së UNMIK-ut duket se, së bashku me planin operacional tri NJFP-ve: polake, rumune dhe ukrainase u ishte dërguar një kërkesë e veçantë nr. 128/07. Ajo thuhet se përmbante udhëzime të tjera për vendosjen e atyre njësiteve dhe specifikonte se gazi lotsjellës dhe pajisjae plotë për kontroll të turmës dhe trazirës (KTT) nevojiteshin, por se armët me tyta të gjata nuk duhej sjellë. Megjithatë, Paneli nuk e ka këtë dokument në posedim.

41. Policia e UNMIK-ut i kishte ftuar përfaqësuesit e Vetëvendosjes qëtë marrin pjesë në përgatitjet për demonstratë, por ata nuk iu përgjigjën ftesës dhe refuzuan të takojnë përfaqësuesit e Policisë së UNMIK-ut.

42. Pas demonstratës së lartpërmendur të 28 nëntorit të vitit 2006 (shih § 27më lart), autoritetet e UNMIK-ut i kishin kushtuar vëmendje të veçantë aksioneve të Lëvizjes Vetëvendosje. Shumica e oficerëve të lartë të Policisë së UNMIK-ut, në deklaratat e tyre të dhëna më pas hetuesve, përmendën se udhëzimet nga lidershipi i Misionit, dhe kështu qëllimi i tyre, ishte të mos lejohej një përsëritje e asaj çfarë kishte ndodhur atëherë. Prandaj, një dokument i quajtur "Qasje strategjike për t'u përballë me demonstratat spontane apo të njoftuara nga aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje",ishte miratuar nga komisari i Policisë së UNMIK-ut, më 8 dhjetor 2006. Në këtë dokument, në pjesët relevante, thuhet:

> "1. Gjatë muajve të fundit është vërejtur një numër i demonstratave – të njoftuara apo spontane – nga Lëvizja Vetëvendosje…grup aktivistësh. Qëllimi është

pjesërisht të bëhet rezistencë kundër (veçanërisht) IPVQ-ve dhe UNMIK-ut dhe pjesërisht të provokohet një konfrontim me policinë dhe autoritetet e tjera, për të maksimalizuar publicitetin për aktivitetet e tyre dhe në këtë mënyrë të fitojnë më shumë përkrahës dhe shtojnë presionin mbi IPVQ-të dhe UNMIK-un. Aktivitetet e kohëvetë fundit të anëtarëve të LVV-së, kanë treguar se ata tani janë të gatshëm qëtë kryejnë akte të paligjshme dhe haptas më të dhunshme.

2. Parimet vijuese duhet udhëhequr qasjen e policisë në përballjen me aktivistët e LVV-së:

a. Demonstratat janë të ligjshme përderisa ato mbesin paqësore. Policia do të miratojë një profil të ulët por të dukshëm, dhe përderisa aktivistët e LVV-së mbesin brenda kufizimeve të protestës paqësore, nuk do të kërkojë për t'iu përgjigjur provokimeve të bëra dhe do të minimizojë mundësitë për konfrontim.
b. Të gjitha opsionet në dispozicion për mbledhjen e dëshmisë do të shfrytëzohen…
c. Sjellja e dhunshme kriminale nuk do të tolerohet. Policia do të ndërmarrë veprim të menjëhershëm të nevojshëm; duke përfshirë nëse është e duhur, arrestimet në vend të ngjarjes.
d. Nëse demonstruesit fillojnë të sulmojnë personat apo pronën, të bëjnë përpjekje të hapin me forcë rrugën e tyre për në objekte apo kryejnë krime tëtjera serioze, policia do të veprojë sipas qëllimit strategjik për t'u përballë me rebelimet dhe trazirat publike."

43. Në përgjithësi, policia u udhëzua të parandalojë një situatë që del të jetë e ngjashme me atë të demonstratës më 28 nëntor 2006.

3. Demonstrata dhe ngjarjet e ndërlidhura më 10 shkurt 2007

44. Më 10 shkurt 2007, Lëvizja Vetëvendosjeorganizoi një protestë në Prishtinë, e cila filloi përafërsisht në orën14:00 dhe zgjati deri rreth orës 17:30. Protestuesit vinin nga anë të ndryshme të Kosovës; sipas të dhënave policore, sëpaku 50 autobusë me protestues arritën nëPrishtinë mëngjesin e 10 shkurtit të vitit 2007. Protestuesit marshuan nga zyra e Vetëvendosje në lagjen "Pejton", deri në rrugën "Nënë Tereza", në drejtim të qendrës së qytetit. Protestuesve iu bashkuan gjatë rrugës shumë të tjerë. Sipas të dhënave zyrtare të SHPK-së, përafërsisht 2,500 persona morën pjesë në protestë. Me sa duket, plani ishte të bëhej një grumbullim para Kuvendit të Kosovës dhe ndërtesës së Qeverisë.

45. Megjithatë, policia bllokoi rrugën "Nënë Tereza" afër monumentit të Skënderbeut dhe nuk lejoi demonstruesit t'i afrohen ndërtesës së Qeverisë, e cila ishte më pak se 300 metralarg nga kordoni i vendosur nga policia. Kordoni përbëhej nga një barrierë metali për "kontroll të turmës", një linjë e parë e policisë e mbajtur nga policët e Njësitit Rajonal për Mbështetje Operacioni të SHPK-së (ROSU) dhe një linjë e dytë, që përbëhej kryesisht nga policët e NJFP-së të Policisë së UNMIK-ut. Pas kordonit, gjendeshin të parkuara disa automjete të blinduara dhe transportues personeli, disa të pajisura me mekanizëm të montuar për hedhje të gazit, dhe disa njësite të policisë rezervë ishin në gjendje gatishmërie.

46. Pajisjet vijuese janë përdorur nga NJSP: jelekët antiplumb, rrobat mbrojtëse për këmbë dhe krah, helmetat (pamburoja mbrojtëse me fibër qelqi), mburoja mbrojtëse plastike, maska për mbrojtje nga gazi, pranga, shkopinj gome, armë brezi të rregullta (pistoleta), sprej që shkakton djegie në sy, gaz lotsjellës dhe plumba gome. Armët për të shtënëme plumba gomeishin dy llojesh: NJFP-ja rumune shfrytëzoi dytytëshe, që mbushen dhe shkarkohen me dorë, me kanal të tytës të lëmuar, armë të kalibrit të madhësisë 12 (IZH-54), të cilat duken si pushkë gjuetie. NJFP-ja polake dhe ukrainase përdorën armë shkrepëse të kalibrit me madhësi 12. Disa transportues të blinduar të personelit dhe qenë shërbyes dukej se mbaheshin në në gjendje gatishmërie.

47. Duke mos qenë në gjendje për të vazhduar për në vendin e planifikuar, demonstruesit e bënë një grumbullim në sheshin para Teatrit Kombëtar, mu para kordonit policor. Në atë vend, një numër i udhëheqësve të Vetëvendosjes, duke përfshirë z. Albin Kurti, iu drejtuan turmës nga një kamion që shfrytëzohej si një platformë e improvizuar, e cila ishte e pajisur me mikrofona dhe altoparlantë. Automjeti tjetër, i cili ishte parkuar afër kamionit, mbante kukulla plastike që paraqisnin zyrtarët e ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë në lidhje me procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

48. Rreth orës 15:00, pasi kishin përfunduar fjalimet e udhëheqësve të Vetëvendosjes, protestuesit filluan t'i largojnë barrikadat (barrierë metali) me qëllim që të lëviznin më afër linjës së parë të policëve. Pasi policia nuk reagoi dhe nuk provoi t'i parandalojë protestuesit ta bëjnë këtë, barrikadat u larguan dhe u vendosën pranë rrugës, dhe kështu krijuan qasje të papenguar në kordonin e formuar nga policët.

49. Menjëherë pas kësaj, protestuesit filluan të bërtasin "UÇK, UÇK[7]" dhe filluan ta shtyjnë policinë. Për aq sa ka vërejtur Paneli duke shikuar inciziminnë video nga vendi i ngjarjes, i cili ishte në dosjen e siguruar nga UNMIK-u, protestuesit nuk ishin të armatosur. Pak momente më vonë, një grup prej rreth 20 aktivistëve të Vetëvendosjes, që kishin të veshura vetëm bluzatë bardha me mëngë të shkurtra, duke përfshirë z. Albin Kurti, u kapën për krahësh duke formuar një rrjetnjerëzishdhe provuan të kalojnë përmes linjës së policisë afër monumentit të Skënderbeut. Policia u zmbraps. Në këtë moment, disa gurë dhe objekte tjera (kanaçe, shkopinj etj.) u gjuajtën në drejtim të policisë. Përgjigjja e policisë pasoi menjëherë; ata përdorën sprej që shkakton djegie në sy dhe hodhën gaz lotsjellës për t'i shpërndarë turmat. E shtëna sporadike e plumbave të parë të gomës ndodhi në këtë kohë. Shumica e protestuesve u tërhoq menjëherë por nuk u shpërndanë plotësisht.

50. Kur u përdor gazi lotsjellës, policët e SHPK-së lanë pozitat e tyre në linjën e parë të kordonit të policisë, pasi ata nuk kishin maska për mbrojtje nga gazi. Kështu, linja e Policisë së UNMIK-ut, kryesisht e mbajtur nga policët rumunë të NJFP-së, u bë linja e parë në kordon dhe vazhdoi me veprimin kundër trazirës.

51. Megjithëse nuk dukej të kishte më shumë konfrontime të drejtpërdrejta, disa protestues kohë pas kohe afroheshin dhe gjuanin me objekte policinë. Policët e UNMIK-ut mbajtën pozitat e tyre fillestare dhe vazhduan të hidhnin gaz lotsjellës; gjithashtu në mënyrë sporadike shtinin me plumba gome, duke vënë në shënjestër veçanërisht ata që afroheshin për ta gjuajtur policinë me shkopinj, gurë dhe bombolat me gaz lotsjellës të marra nga toka.

[7] "UÇK" (shqip: *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*) përdoret për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

52. Pak më vonë, Policia e UNMIK-ut filloi të lëvizë përpara, duke i shtyrë protestuesit nga rruga "Nënë Terezë" në rrugët anësore. Në këtë kohë, policët e SHPK-së përdorën shkopinjtë e gomës për të shpërndarë turmën; disa protestues aktivë u arrestuan në atë kohë.

53. Deri në orën17:30, protesta u shpërnda plotësisht.

54. Gjatë dhe pas protestës së lartpërmendur, 19 persona u arrestuan dhe 82 kërkuan ndihmë mjekësore. Nga ta, rreth 30 u plagosën nga plumbat e gomës, 56 të tjerë kishin lëndime në pjesë të ndryshme të trupit, të shkaktuara kryesisht nga përdorimi i forcës fizike. Shumë nga protestuesit ishin lënduar në pjesët e epërme të trupittë tyre.

55. Për sa i përket pronës së dëmtuar nga demonstrata, tri automjete u dëmtuan (një automjet i OKB-së, një automjet i Qeverisë dhe një veturë civile), dritaret e hotelit Iliria dhe dy dyqane u thyen.

56. Të gjitha katër viktimat si lëndë e kësaj ankese morën plagë serioze dhe u trajtuan së pari në Qendrën Emergjente Spitalore Universitare të Prishtinës. Dy nga ta, z.Mon Balajdhe z. Arben Xheladini, menjëherë u transferuan në spitalin e KFOR-it të ShBA-së në kampin "Bondsteel" për trajtim, ku ata vdiqën menjëherë pas kësaj, me gjithë përpjekjete mjekëve. Z.Mustafë Nerjovaj gjithashtu është transferuar më vonë në spitalin fushor të KFOR-it gjerman në Prizren për trajtim të mëtejmë. Z.Zenel Zeneli, për shkak të seriozitetit të plagosjes së tij, mbeti në Spitalin Universitar. Lëndimet e pësuara nga katër viktimat, si dhe rrethanat në të cilat ato u shkaktuan janë dhënë në detaje më poshtë (shih § 90 "A", "B", "C" dhe "D").

4. Zhvillimet pas ngjarjeve

57. Ministri i Punëvetë Brendshme i IPVQ-ve të Kosovës, z. Fatmir Rexhepi, dha dorëheqje më 13 shkurt 2007. Në ditën vijuese, me kërkesën e PSSP-së, z.Stephen Curtis, komisar i Policisë së UNMIK-ut gjithashtu dha dorëheqje.

58. Më pas, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së iu referua demonstratës në raportin e tij të 9 marsit të vitit 2007 (përmendur në § 28më lart):

> "4. …Vetëvendosje mbajti përsëri një protestë kundër planit [për zgjidhjen e statusit], ekipit negociator të Kosovës, UNMIK-ut dhe Zyrës Ndërkombëtare Civile të parashikuar në të ardhmen më 10 shkurt, qëllimi i së cilës ishte qartas i dhunshëm. Dy protestues vdiqën tragjikisht, nga plagët e shkaktuara në kokë nga plumbat e gomës. Ministri i Punëvetë Brendshme i Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje në Kosovë dhe komisari i Policisë së UNMIK-ut dhanë dorëheqje menjëherë pas kësaj, ndërsa lideri i Lëvizjes Vetëvendosje mbetet në paraburgim. Një hetim për vdekjet dhe një hetim për Vetëvendosjen janë duke u zhvilluar. Ndërsa ka pak përkrahje të përgjithshme për aksionet e kësaj lëvizjeje, mungesa e vazhdueshme e qartësisë mbi statusin e Kosovës, e cila pengon progresin social, ekonomik dhe politik, krijon një ambient të brishtë i cili është shfrytëzuar nga elementet radikale."

59. Në dritë të rotacionit të ardhshëm të personelit rumun të NJFP-së, për shkak të përfundimit të periudhës së tyre në detyrë, PSSP-ja i kërkoi Qeverisë së Rumanisë ta shtyjë rotacionin e këtij kontingjenti për një muaj. Më 22 shkurt 2007, Qeveria rumune informoi PSSP-në për pajtimin e saj për të pranuar një zgjatje të tillë për të lehtësuar hetimin. Qeveria e Rumanisë, po ashtu, nuk bëri asnjë vërejtje ndaj veprimeve hetimore që përfshinin policët e tyre.

60. Më, 23 mars 2007, i gjithë kontingjenti rumun i NJFP-së u largua nga Kosova dhe u kthye në Rumani. Vendimi për t'i kthyer prapa këta policë u mor nga Qeveria e Rumanisë, pavarësisht një kërkese nga selia e OKB-së për t'i mbajtur policët"e armatosur" të NJSP-së në Kosovë derisa të përfundohet hetimi.

C. Hetimi

1. Hapja e dosjeve relevante

61. Në rastin aktual, Paneli pranoi nga UNMIK-u dosjen origjinale hetimore që më parë e kishte mbajtur prokurori special i UNMIK-ut dhe Task Forca nën mbikëqyrjen e tij (shih § 85 më poshtë). Dosja përfshinte 29 lidhje dokumentesh të numëruara; disa dëshmi materiale, me një sërë certifikatash nën mbikëqyrje dhe formularët origjinalë për pranim-dorëzim, janë gjithashtu në dosje. E bashkëngjitur në dosje është një DVD me incizimnë video të demonstratës dhe aksionit të policisë (shih § 49më lart).

62. Për sa i përket publikimit të informatave që përmbajnë dosjet, Paneli duhet të qartësojë që, megjithëse vlerësimi i dosjes aktuale rrjedh nga një shqyrtim i plotë i dokumentacionit në dispozicion, vetëm informata të limituara që ekzistojnë aty janë publikuar. Prandaj, një përmbledhje e hapave të ndërmarrë nga autoritetet e hetuesisë është dhënë në paragrafët në vijim.

2. Hapat fillestarë hetimorë

63. Hetimi për dhunën që ndërlidhet me demonstratën filloi më 10 shkurt 2007. Një pjesë e madhe e rrugës "Nënë Tereza" është mbyllur nga policët e SHPK-së, si vend i mundshëm i krimit, dhe rreth orës 18:00 oficerët e mjekësisë ligjore të SHPK-së tanimë kishin filluar ekzaminimin e vendit, duke përfunduar rreth orës 20:00. Vendi është matur dhe fotografuar. Një numër i madh i sendesh, sikur gëzhojat eshpenzuara, bombolat e zbrazëta të gazit, predhat e gomës, shkopinjtë dhe gurët u mblodhën dhe u mbyllën për ekzaminim të mëtejmë.

64. Rrobat e viktimës së ndjerë z.MonBalaju morën nga policët e SHPK-së në Spitalin e Prishtinës, më 10 shkurt 2007, dhe janë dërguar në gjendjen e tyre origjinale për ruajtje të sigurt në Laboratorin e Mjekësisë Ligjore të SHPK-së. Policia nuk ishte në gjendje të gjente rrobat e viktimës tjetër të ndjerë, z. Arben Xheladini.

65. Sipas të dhënave nga baza e të dhënave për informata penale e Policisë së Kosovës, të ditës së njëjtë, në orën 18:00, Njësiti Rajonal për Hetim i Prishtinës (NJRH) regjistroi një hetim sipas nr. 2007-AB-0526, në lidhje me shkeljet vijuese:

"1) N/A Demonstrim;
2)N/A Prishje e rendit publik;

3) 316 Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare;
4) 317 Sulmim i personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.”

66. Lënda nr. 2007-AB-0526 ka 15 të dyshuar, me z. Albin Kurtin në krye të listës. Shumica e dokumenteve hetimore të datës 10 – 12 shkurt 2007 mbajnë këtë numër për lëndën. Në dosje nuk tregohet nëse një lëndë e veçantë ishte regjistruar në lidhje me hetimin për vdekjet dhe plagosjet e protestuesve.

67. Po ashtu, më 10 shkurt 2007, hetuesit e SHPK-së shkuan në klinikën e Prishtinës dhe morën nga atje një numër sendesh, duke përfshirë rrobat e z.MonBalajdhe një numër të predhave të gomës, të nxjerra nga mjekët që trajtonin protestuesit e plagosur.

68. Më 11 shkurt 2007, NJRH i kërkoi Zyrës së Qarkut të Prokurorisë Publike (ZQPP) të Prishtinës të lëshojë një urdhër për autopsitë e dy viktimave të vdekura. Po të njëjtën ditë, një gjykatës i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës lëshoi një urdhër përkërkim; numri i regjistrit i Gjykatës së Qarkut i bashkëngjitur në të është PNH 85/07.

69. Po ashtu po të njëjtën ditë,hetuesit e NJRH të SHPK-së i kërkuan një prokurori publik në ZQPP në Prishtinë t’u paraqesë një kërkesë të gjitha kanaleve të mëdha televizive në Kosovë, që t’i ofrojnë Policisë incizimet në video në lidhjeme ngjarjet e 10 shkurtit të vitit 2007.

70. Me anën e një e-maili pasditen e vonë të 11 shkurtit 2007, një prokuror ndërkombëtar i UNMIK-ut i kërkoi udhëheqësit të hetimeve të Policisë së UNMIK-ut t’u ofrojë prokurorëve ndërkombëtarë, duke përfshirë z. Robert L. Dean, një raport të plotë për ngjarjet e 10 shkurtit të vitit 2007, veçanërisht raportet e autopsisë dhe vlerësimin e lëndimeve që u janë shkaktuar protestuesve.

71. Më 12 shkurt 2014, me urdhrin e gjykatësit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut (GJQ) në Prishtinë, një ekspert ndërkombëtar i mjekësisë ligjore nga Zyra e ekzaminuesit mjekësor të Zyrës së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, kreu autopsitë në dy viktimat e vdekura. Rezultatet paraprake u paraqitën menjëherë. Prandaj, u vërtetua se ata u goditën me plumba gome me diametër 18.5 mm.

72. Raportet e plota të autopsisë janë paraqitur më vonë: në lidhje me z. Arben Xheladinimë 27 shkurt 2007 dhe në lidhje me z.Mon Balaj më 3 mars 2007; të dyja përfshinin një përmbledhje të lëndimeve dhe gjetjeve mbi shkaktarin e vdekjes. Sipas raporteve të autopsisë, ekzaminimi i trupit të z. Arben Xheladini u ndoq nga katër policë të SHPK-së, shtatë policë të Policisë së UNMIK-ut, një prokuror ndërkombëtar dhe një asistent gjuhësor i UNMIK-ut. Ekzaminimi i trupit të z. Mon Balaj u ndoq nga katër policë të SHPK-së, shtatë policë të UNMIK-ut, dy prokurorë ndërkombëtarë (njëri nga ta Robert L. Dean) dhe një asistent gjuhësor i UNMIK-ut.

73. Deri më 12 shkurt 2007, hetuesit e NJRH të Policisë së UNMIK-ut kishin mbledhur gjithashtu mostrat e nevojshme të municionit të gomës të përdorur gjatë operacionit nga NJFP-të polake, rumune dhe ukrainase. Njëri nga këta hetuestë Policisë së UNMIK-ut ishte rumun. Po të njëjtën ditë, dy hetues rumunë të Policisë së UNMIK-ut shkuan në bazën e KFOR-it në Prizren, ku ata mblodhën informata për identitetin e viktimës në të cilin ishte shtënë gjatë demonstratës (z.Mustafë Nerjovaj),i cili po trajtohej atje, përgjendjen e tij shëndetësore dhe përshkrimin e lëndimeve që iu shkaktuan atij.

3. Hetimi i Policisë së UNMIK-ut dhe prokurorit special

74. Më 12 shkurt 2007, një "Task Forcë (Grup i veçantë hetimor) për 10.02.2007" u themelua zyrtarisht për t'ihetuar rrethanat e protestës dhe dhunën që kishte ndodhur.

75. Sipas skemës së vet organizative, Task Forca përbëhej nga 18 policë të UNMIK-ut të caktuar përhershëm në të, tre oficerë për ndërlidhje dhe dy policë nga Policia e Kosovës. Po ashtu thuhet se "më shumë se 30 PN [policë ndërkombëtarë] punuan për 'Task Forcën për 10.02.2007' përkohësisht [sic.]". Dy vëzhgues nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) gjithashtu i takonin Task Forcës. Sipas skemës së lartpërmendur organizative (në të cilën ishin të shkruar emrat dhe nacionalitetet e të gjithë pjesëtarëve të Task Forcës), në të nuk ishte i caktuar asnjë polic rumun i Policisë së UNMIK-ut.

76. Më 13 shkurt 2007, një hetues i Task Forcës kërkoi nga menaxhmenti i Klinikës së Prishtinës t'i lëshojë dokumentet mjekësore dhe rrobat personale të z. ZenelZeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj. Megjithatë, sipas një raporti policor të datës 14 shkurt 2007, asnjëra nga sendet e kërkuara nuk ishin gjetur në klinikë. Rrobat, të cilat z. Mustafë Nerjovaj i kishte veshur më 10 shkurt 2007, gjatë demonstratës, ishin marrë nga ai më 15 mars 2007, pasi ai ishte intervistuar nga Policia e UNMIK-ut në shtëpinë e tij. Megjithatë, ato ishin pastruar në ndërkohë. Dosja nuk ka asnjë të dhënë për vendndodhjen e rrobave të z. Zenel Zeneli.

77. Po ashtu këtë ditë, një ekspert për armë zjarri i SHPK-së i konfirmoi udhëheqësit të ekipit të Task Forcës se armët e përdorura nga NJFP-të polake dhe rumune ishin në gjendje të gjuanin municion gome të kalibrit 12, ndërsa karabinat e përdorura nga NJFP ukrainase nuk ishin të dizajnuara për të përdorur këtë lloj të municionit.

78. Më 14 shkurt 2007, z. Robert L. Dean, prokuror ndërkombëtar i UNMIK-ut dhe në atë kohë ushtrues i detyrës së drejtorit të DD-së së UNMIK-ut, u emërua si prokuror special për të mbikëqyrur dhe udhëhequr Task Forcën. Nga dosja duket se rasti i prokurorit ishte regjistruar me nr. PC 119/07.

79. Hetimi ka vërtetuar se NJFP rumune përfaqësoheshin nga tri togje: "Alpha" (32 policë, tre nga ta pushkatarë), "Bravo" (32 policë, tre nga ta pushkatarë) dhe "Charlie" (21 policë, tre nga ta pushkatarë). Ata ishin të vendosur në një formacion luftimi, me togun "Alpha" në krahun e djathtë, togun "Bravo" në qendër dhe togun "Charlie" në krahun e majtë (ana e rrugës ku janë të vendosur Teatri Kombëtar dhe hotel Iliria). Informata të ngjashme për pjesëmarrjen e NJFP-së polake dhe ukrainase iu vunë në dispozicion Task Forcës.

80. Marrjet në pyetje të oficerëve komandues të NJFP-së polake dhe pushkatarëve, të cilët përdorën plumba gome gjatë demonstratave u bënë më 13 dhe 14 shkurt 2007. Sipas regjistrimeve, shtatë nga nëntë policët u morën në pyetje nga dy hetues të Policisë së UNMIK-ut, njëri nga të cilët ishte rumun; regjistrimet nuk paraqesin asnjë informatë për praninë e një përkthyesi gjatë këtyre intervistave. Njëri nga policët është ri-intervistuar më 14 mars 2007, nga dy hetues tjerë të Policisë së UNMIK-ut (jo nga Rumania).

81. Pjesëtarët e NJFP-së rumune, të cilët morën pjesë në operacion më 10 shkurt 2007, u morën në pyetje në disa raste. Në valën e parë të intervistave, më 15 dhe 16 shkurt 2007,

hetuesit intervistuan pushkatarët dhe oficerët komandues të NJSP-së rumune. Sipas regjistrimeve, secila nga këto marrje në pyetje ishte bërë nga dy hetues të Policisë së UNMIK-ut, njëri nga të cilët ishte rumun. Asnjë përkthyes nuk ka qenë i pranishëm në këto marrje në pyetje; të dhënat e tyre ishin shkruar në gjuhën rumune dhe më pas ishin përkthyer në gjuhën angleze. Të gjithë ata ishin rimarrë në pyetje më 9 – 11 mars 2007, gjithashtu nga dy hetues të Policisë të UNMIK-ut, dhe asnjëri nga ta nuk ishte rumun, dhe një përkthyes profesionist.

82. Më 16 shkurt 2007, një ekspert për armë zjarri i SHPK-së i konfirmoi prokurorit se municioni i vetëm që përmban predha gome që përshtaten në madhësi me plumbat e nxjerrë gjatë autopsive ishin RB1, të përdorura nga NJSP rumune.

83. Më 20 shkurt 2007, dy hetues të Policisë së UNMIK-ut (njëri nga ta rumun) intervistoi tetë pjesëtarët e NJFP-së ukrainase, të cilët morën pjesë në operacion. Përkthimi gjatë të gjitha atyre marrjeve në pyetje ishte bërë nga një polic anglishtfolës i NJFP-së ukrainase. Këto tetë deklarata përmbajnë formulime shumë të ngjashme. Katër oficerë komandues të NJSP-së ukrainase ishin intervistuar më vonë, më 15 dhe 16 mars 2007, nga hetues të ndryshëm të Policisë së UNMIK-ut (jo rumun). Në tri intervista, përkthimi ishte bërë gjithashtu nga një polic i NJSP-së ukrainase, dhe një ishte bërë në gjuhën angleze.

84. Në mes 15 dhe 20 shkurtit të vitit 2007, policët e SHPK-së intervistuan më shumë se 50 dëshmitarë civilë, në mesin e tyre dëshmitarë okularë të gjuajtjes në katër viktimat e këtij rasti. Disa ishin në gjendje t'ua përshkruajnë policëve se kush kishte shtënë në viktimat, por asnjëri nga ta nuk ishte në gjendje t'i identifikojë ata përmes fotografive. Asnjë paradë e drejtpërdrejtë për identifikim nuk ishte organizuar në ndonjë fazë.

85. Përmbledhja e veprimeve hetimore të ndërmarra nga Task Forca nga fillimi i hetimit deri më 16 prill 2007 ofrohet në "Raportin e përkohshëm të prokurorit special për PSSP-në, lidhur me vdekjet dhe plagosjen serioze të protestuesve gjatë demonstratave të 10 shkurtit në Prishtinë" (Raport i përkohshëm i prokurorit special, faqe 5 dhe 6). Siç thuhet atje, qëllimi kryesor i hetimit në këtë periudhë ishte "të bëhen kufizime sa i përket pushkatarëve të mundshëm policorë, dhe të shihet kjo nga mjekësia ligjore, dëshmitarët, si dhe të shqyrtohet e gjithë dëshmia e mbledhur për të identifikuar personin apo personat që gjuajtën me të shtëna fatale dhe ato që shkaktuan plagë serioze."Janë ndërmarrë veprimet hetimore si në vijim:

> "Raportet e policëve nga e gjithë policia e përfshirë në aksionin policor ishin mbledhur dhe shqyrtuar; ishte vazhduar me intervistat e oficerëve përkatës; ishte zhvilluar hetimi dhe vazhduar intervistat me mbi 200 policë të NJRMO (ROSU) i SHPK-së, të cilët ishin të përfshirë në aksionin policor; ishin intervistuar pjesëtarët e njësiteve të NJFP-ve ukrainase dhe polake të përfshira në aksionin policor; ishte intervistuar krejt NJFP-ja rumune prej 93 personash dhe ishin ri-intervistuar ata që kishin përdorur plumba gome; ishin marrë fotografitë që misioni i UNMIK-ut ua kishte bërë pushkatarëve të mundshëm për qëllime të mundshme identifikimi; janë marrë fotografitë e bëra nga ajri dhe në vend të ngjarjes të vendit të përplasjes duke përfshirë lartësinë e terrenit dhe pikën referuese dhe është bërë matja e objekteve të caktuara; është bërë kontrolli derë më derë nga policia për t'i gjetur dëshmitarët në zonën e përleshjes; janë mbledhur dhe analizuar incizimet në video dhe fotografitë e zakonshme (mbi 1.800 fotografi) të demonstratës dhe përplasjes; janë gjetur dhe

intervistuar personat të cilët kanë bërë incizime në video dhe fotografi; janë intervistuar 21 pjesëtarë të stafit të hotelit Iliria dhe disa janë ri-intervistuar; janë intervistuar mbi 100 pjesëmarrës civilë të demonstratës; janë intervistuar personat e plagosur dhe të afërmit; janë kontaktuar dëshmitarët e gjetur në Norvegji dhe Gjermani; janë bërë autopsitë e dy të vdekurve dhe janë marrë të dhënat mjekësore për të plagosurit seriozisht; janë marrë predhat e gjetura te një i vdekur dhe një i plagosur; është bërë ekzaminimi laboratorik i armëve të zjarrit dhe municionit të gjetur dhe ekzaminimi i mostrave të plumbave të gomës të marrë nga NJFP-ja polake, ukrainase dhe rumune; janë marrë 170 mostra tjera të municionit me plumba gome RB1 nga NJFP rumune dhe i është dorëzuar dëshmia laboratorit gjerman BKA, ku është bërë testimi i shpejtësisë dhe ndikimi/distanca; janë bërë intervistat me koordinatorët e NJFP-ve dhe komandantët operacionalë lidhur me aksionin policor gjatë protestës; janë dhënë njoftime në medie lokale në të cilat u kërkohej dëshmitarëve potencialë të kontaktojnë lidhjen direkte 'hot-line' të menaxhuar nga SHPK-ja; është identifikuar prodhuesi i municionit RB1 dhe janë kërkuar detajet e specifikimit, shpërndarjes dhe përdorimi i rekomanduar i municionit."

86. Duke përfunduar përmbledhjen e tij të aktivitetit hetimor, prokurori special shtoi:

> "Nuk është befasuese, Task Forca u përballë me pengesa gjatë rrjedhës së hetimit të tyre. Disa pengesa mund të parashiheshin sikur gjuha dhe çështjet e kërkuara të përkthimit si dhe logjistika. Duhej gjetur dëshmitarët e mundshëm jo vetëm në Kosovë... Pavarësisht nga kërkesat e përsëritura, NJSHM francez dhe italian [Njësiti Shumëkombësh për Mbështetje] nën komandën e NATO-s, akoma nuk është pajtuar të intervistohet nga Task Forca. Task Forca shpresonte se lidhja direkte 'hot-line' e vendosur nga SHPK-ja dhe e publikuar nga mediet, do të rezultonte me informata dhe pista të dobishme. Fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi në këtë rast."

87. Policët rumunë të NJSP-së, të cilët fillimisht ishin intervistuar nga oficerë rumunë të Policisë së UNMIK-ut pa përkthyes (shih § 81më lart), ishin ri-intervistuar më vonë nga dy oficerë tjerë të Policisë së UNMIK-ut të nacionaliteteve tjera, me ndihmën e përkthyesve profesionalë nën betim.

4. Të gjeturat dhe përfundimet e prokurorit special

88. Rezultatet e veprimeve hetimore i janë paraqitur prokurorit special në Raportin e përkohshëm mbi hetimet për demonstratën e 10 shkurtit të vitit 2007, të datës 13 mars 2007, në Raportin e parë të Task Forcës për 10.02.2007, të 16 prillit të vitit 2007 (Raporti i parë i Task Forcës) dhe në Raportin e dytë të Task Forcës për 10.02.2007 (Raporti i dytë i Task Forcës) të datës 11 qershor 2007.

89. Duke u bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura në këto dy raporte, prokurori special lëshoi dhe i bëri publike dy raporte. I pari, "Raporti i përkohshëm i prokurorit special" i 16 prillit të vitit 2007 (shih § 85më lart) dhe i dyti "Raporti i prokurorit special për PSSP-në" (Raporti i dytë i prokurorit special) i 29 qershorit të vitit 2007.

90. Raporti i përkohshëm i prokurorit special i 16 prillit të vitit 2007, përmban nën titullin "Rezultatet" të gjeturat vijuese (është ruajtur theksi origjinal):

"Që nga fillimi, qëllimi i Task Forcës ishte të bëhen kufizime sa i përket pushkatarëve të mundshëm. Zbulimi i parë dhe më i rëndësishëm në lidhje me këtë është marrja dhe ekzaminimi i predhave që shkaktuan vdekjen e Mon Balajt dhe Arben Xhelladinit dhe plagosjen e Zenel Zenelit dhe Mustafë Nerjovajt. …

Në këtë pikë raporti do të trajtojë çfarë është konstatuar lidhur me katër individët e veçantë, të cilët ishin qëlluar nga policia gjatë pasdites së 10 shkurtit.

A. **Mon Balaj –** Një numër i njerëzve kishin dëshmuar për të shtënën në Mon Balajn. Është e qartë se gjatë protestës ai hyri në hotelin Iliria në rrugën "Nënë Tereza". Në një kohë ai vrapoi nga hoteli, kërceu nga tarraca dhe shpejt pas kësaj ishte qëlluar në kokë pas veshit të djathtë të tij me plumb gome, që përshkoi kafkën e tij. Ai vdiq si rezultat i plagës në kokë të shkaktuar nga një plumb gome i llojit RB1. Mon Balaj kishte hyrë në hotelin Iliria në rrugën "Nënë Tereza" dhe kur NJSHM (MSU) hyri në hotel, ai u largua nga hoteli, kërceu nga tarraca, dhe u rrëzua pasi ai ishte qëlluar me një plumb. Është kryer një autopsi dhe është gjetur plumbi. Plumbi ishte i llojit RB1.

B. **Arben Xhelladini –** Pak dihet lidhur me rrethanat në të cilat është shtënë në Arben Xhelladinin dhe vdekjen. Ai ishte qëlluar përpara në ballë. Është kryer një autopsi dhe është gjetur plumbi. Plumbi ishte i llojit RB1, plumb gome.

C. **Mustafë Nerjovaj** – Ai u qëllua në kokë me një predhë RB1. Kjo është marrë dhe ekzaminuar. Plaga e tij është shkaktuar kur u kërrus ta marrë një bombol të gazit lotsjellës me qëllim që t'ia kthente atë policisë. Plumbi ishte një plumb gome i llojit RB1.

D. **Zenel Zeneli** – Ai u qëllua në gjoks dhe predha mbetet brenda gjoksit të tij. Ai nuk është në gjendje t'i kujtojë detajet e shkaktimit të plagëve të tij. Nga rrezet e rëntgenit, shihet se predha e mbetur në gjoksin e tij është predhë e llojit RB1.

E. **Të plagosurit e tjerë** – Policia nuk ishte në gjendje t'i marrë predhat dhe nuk është në pozitë tani t'i vlerësojë specifikat e asaj se çfarë i ka shkaktuar këto plagë.

F. … 8 pushkatarë rumunë të NJFP-së deklaruan se ata kanë shtënë plumba RB1. Njësitet NJFP polake gjithashtu përdorën plumba gome, por jo të madhësisë dhe llojit me të cilët janë gjuajtur viktimat në fjalë. Të shtënat vdekjeprurëse u shkaktuan nga një plumb i veçantë i llojit të plumbave të gomës, RB1. Secili pushkatar rumun u identifikua dhe u mor në pyetje…

G. Njësiti tjetër i vetëm që ka përdorur plumba gome është NJFP-ja polake…

H. Tani ekziston një dyshim i arsyeshëm për të besuar se krimet u kryen nga një pushkatar apo pushkatarë rumunë që rezultoi me vdekjen e Mon Balajt, Arben Xhelladinit, dhe plagosjen e Zenel Zenelit. Siç është theksuar më lart, *dyshimi i arsyeshëm* *që krimet janë kryer* është standard i kërkuar i përcaktuar në KPPP[Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, *neni 207(4)*. Krimet në fjalë për të cilat ekziston dyshim i arsyeshëm janë: vrasje, vrasje nga pakujdesia,

tentim vrasje dhe lëndim i rëndë trupor. Megjithëse mund të argumentohet se këto vdekje ishin aksidentale, ajo nuk do të heqë dyshimin e arsyeshëm se e shtëna e tillë ishte kriminale. Të shtënat aksidentale mund të shkaktohen në një mënyrë të pakujdesshme, rrjedhimisht, kriminale... Për të ngritur një mbrojtje për mbrojtje të nevojshme aktori duhet të veprojë për të shmangur sulmin e paligjshëm, real dhe imanent. Çfarë është më vendimtare, akti i tillë duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut nga sulmi. … Asgjë në dëshminë deri tani nuk tregon se [viktimat] Mon Balaj, Arben Xhelladini, apo ZenelZeneli, ishin duke bërë diçka që kërcënonte jetën e ndonjë polici apo ndonjë personi në kohën kur ata ishin qëlluar. Nuk ka shumë të ngjarë se ata morën këto plagë nga rikoshet apo të shtënat në një trajektore të ulët. Në këto rrethana, të shtënat në kokë dhe gjoks me plumba RB1 çojnë te dyshimi i arsyeshëm për një veprim kriminal nga ana e policisë e cila kishte shtënë.

I. Tani nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm se një pushkatar apo pushkatarë specifikë rumunë të NJFP-së shkaktuan dy plagët vdekjeprurëse, apo një plagë gati vdekjeprurëse. Për të caktuar statusin "i dyshuar" për të gjithë 10 pushkatarët rumunë (apo për tetë të cilët përdorën RB1), do të ishte në kundërshtim me parimet e Kodit. Aktet e dyshuara si të paligjshme nga një, dy apo tre pushkatarë rumunë nuk mund t'u atribuohen pjesës së mbetur prej pesë, gjashtë apo shtatë policësh, të cilët duhet supozuar ta kenë bërë punën e tyre si duhet. Tani ne jemi në pozitë të supozojmë se kush mund të jetë pushkatari apo pushkatarët që kanë bërë shkelje. Ligji thjesht nuk pranon supozimin në paraqitjen e kallëzimeve penale dhe procedurat kundër një personi. … Megjithatë, për shkak të natyrës së armëve të përdorura (armë me kanal të tytës të lëmuar të kalibrit me madhësi 12) dhe tri llojeve të plumbave të gomës të përdorur, ekspertët e mjekësisë ligjore nuk janë në gjendje të bëjnë ndonjë lidhje mes ndonjë predhe të gjuajtur që është gjetur dhe ndonjë arme të veçantë. Përveç kësaj, pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme për të gjetur një dëshmitar, i cili do të ishte në gjendje të identifikojë pushkatarin e caktuar që shtiu në Mon Balajn, Arben Xhelladinin, apo Zenel Zenelin, nuk është gjetur asnjë dëshmitar i tillë.

J. Prandaj, faktet dhe rrethanat në këtë kohë nuk lejojnë paraqitjen e një fillimi të një hetimi penal. Asnjëri nga pushkatarët rumunë nuk mund të quhet si i dyshuar siç përkufizohet në *KPPPK neni 151(1)*, pasi niveli i dyshimit të arsyeshëm për sa i përket një pushkatari të caktuar akoma nuk ekziston. Ata janë thjesht të dyshuar "të mundshëm" apo "potencialë". Termi "i dyshuar i mundshëm" nuk ekziston në Kod. Ne duhet të vazhdojmë ta mbajmë në mendje për sa i përket shumicës së pushkatarëve rumunë të NJFP-së të 10 shkurtit të vitit 2007, se nuk ka asnjë indikacion për ndonjë keqbërje."

91. Në fusnotën nr. 8 të konkluzionit "I" më lart, prokurori special ofroi një sqarim shtesë për vendimin e tij që të mos fillojë hetim kundër të gjithë pushkatarëve rumunë. Ai theksoi (është ruajtur theksi origjinal):

> "Kur një rast penal avancon te shkalla e një aktakuze, duhet të ketë një *dyshim të bazuar mirë* se i padituri ka kryer krim. Shih *KPPPK neni 316 (1) 4)*. Dyshimi *i bazuar mirë* kërkon madje edhe më shumë dëshmi dhe provë sesa *dyshimi i arsyeshëm*. Dënimi në një gjykim kërkon provë përtej dyshimit të arsyeshëm, i cili është standardi më i lartë i provës në të drejtën penale."

92. Konkluzionet (pika 5) e Raportit të përkohshëm të prokurorit special të 16 prillit të vitit 2007 janë si në vijim (është ruajtur theksi origjinal):

"A. Dëshmia deri më tani çon te konkluzioni se vdekjet e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit ishin të panevojshme dhe të shmangshme. Duket se nuk ka pasur asnjë justifikim për të shtënë në kokë të Mon Balajt dhe kokë të Arben Xhelladinit apo në gjoks të Zenel Zenelit. Qëllimi i planit operacional ishte të mbroheshin ndërtesat dhe të kontrollohet turma. Shkaktimi plagëve fatale dhe pothuaj fatale ndodhi në distancë të konsiderueshme nga ndërtesat e Qeverisë që duhej mbrojtur. Njeriu arrin te përfundimi se përdorimi i plumbave të gomës fare atë ditë mund të ketë qenë këshillë e keqe dhe jo e duhur sipas rrethanave. Kjo do të jetë subjekt i hetimit të mëtejmë.

B. Dëshmia, tek e cila është arritur deri më tani, përkrah konkluzionin se të shtënat fatale dhe pothuaj vdekjeprurëse me plumba gome ishin bërë nga një apo dy pushkatarë rumunë të NJFP-së. Kishte 10 pushkatarë rumunë të NJFP-së atë ditë. 59 plumba gome të llojit RB1 ishin shtënë nga pushkatarët rumunë. Së paku tetë pushkatarë rumunë kanë shtënë këta 59 plumba gome të llojit RB1. Dëshmia, megjithatë, nuk ofron një bazë për të identifikuar më tutje se kush mund t'i ketë shtënë plumbat vdekjeprurës apo shkaktuar plagosje nga municioni RB1. Asnjë dëshmitar nuk ishte në gjendje të identifikojë ndonjë pushkatar që kishte shtënë në personat e plagosur në fjalë. Gjendja e dëshmisë e mbledhur deri më tani nuk plotëson pragun për dyshim të arsyeshëm të aktivitetit kriminal të kryer nga një person i caktuar. Prandaj, fillimi formal i procedurave penale në pajtim me *KPPPK nenet 220 dhe 221* nuk përligjet sipas ligjit në këtë kohë.

C. Në dritë të kësaj që u tha më lart, UNMIK-u, Organizata e Kombeve të Bashkuara, dhe Qeveria e Rumanisë mund të marrin në konsideratë fillimin e procedurave përkatëse për kompensim për pjesëtarët e mbijetuar të familjeve të atyre që janë qëlluar për vdekjedhe atyre që janë plagosur seriozisht."

93. Në pjesën e fundit të Raportit të tij të parë, "Përpjekjet e vazhdueshme hetimore", prokurori special theksoi:

"Deri më tani janë ngritur pyetje lidhur me planifikimin dhe përgatitjen operacionale për protestat e 10 shkurtit të vitit 2007, rregullat për angazhim, zinxhirin komandues si dhe shkallëtvendimtare të vendimmarrjes, e të cilat çuan te përdorimi i plumbave të gomës atë ditë nga policia. Përveç kësaj, ne jemi plotësisht të vetëdijshëm se përdorimi i plumbave të gomës është i diskutueshëm. Nuk është qëllimi ynë të mbrojmë apo dënojmë përdorimin e plumbave të gomës në përgjithësi... Ne do t'i shqyrtojmë standardet përgjithësisht të pranuara dhe ekzistuese për përdorimin e plumbave të gomës dhe trajnimin e bërë për taktikat e tilla. Po ashtu ka dalë në dritë se mund të ketë pasur transmetim jo të plotë, të paqartë, apo të pasaktë të informatave dhe urdhrave në mes komandantëve në terren dhe Shtabit të Përgjithshëm. Kjo mund të ketë ndikuar negativisht në vendimet komanduese gjatë protestës. ... Ekziston një pyetje nëse urdhrat operacionalë për protestë parashihnin përdorimin e plumbave të gomës... Duhet theksuar se hetimi

kishte ngritur pyetje serioze lidhur me prodhimin, përbërjen dhe cilësinë e municionit të plumbave të gomës të përdorur ditën nën hetim."

94. Në Raportin e dytë të prokurorit të përgjithshëm për PSSP-në, i datës 29 qershor 2007, prokurori special plotësoi Raportin e përkohshëm të 16 prillit të vitit 2007 me "një vlerësim dhe kritikë të praktikave dhe procedurave të përdorura nga Policia e UNMIK-ut për planifikimin dhe kryerjen e funksioneve policore para dhe gjatë protestave të 10 shkurtit, veçanërisht për sa i përket vendimit për t'i përdorë plumbat e gomës kundër turmës atë ditë" (f. 2-3). Megjithatë, në këtë Raport nuk i shtohet diçka substancës së të gjeturave në lidhje me identifikimin e atyre që janë drejtpërdrejt përgjegjës për vrasjen dhe plagosjen e protestuesve.

95. Për sa u përket veprimeve shtesë hetimore, në Raportin e dytë të prokurorit special thuhet:

> "Intervistat e tjera me dëshmitarët ... nuk ofruan ndonjë informatë shtesë që do të mundësonte identifikimin e një pushkatari të caktuar si i dyshuar për të shtënën për vdekje në MonBalajn, Arben Xheladinin, dhe plagosjen e ZenelZenelit. Hetuesit e Task Forcës ishin në gjendje të hetojnë dhe intervistojnë pjesëtarët e NJSHM në vend të ngjarjes, e cila nuk kishte ndodhur deri më 16 prill 2007. Po ashtu, këto intervista bënë pak për të konstatuar më tutje identitetin e ndonjë pushkatari të veçantë individual rumun të NJFP-së. Prandaj, të gjeturat e Raportit të prillit mbesin siç janë theksuar aty" (f. 4).

96. Prokurori special përfundoi se kishte pasur të meta të ndryshme për sa i përket kornizës ligjore, planifikimit dhe përgatitjes së policisë dhe operacionit dhe procesit vendimmarrës për protestën e 10 shkurtit. Në veçanti, ai identifikoi rrethanat vijuese si kontribuuese në përfundimin tragjik (f. 17-18):

- Mjedisi ligjor i kombeve kontribuuese;
- Municioni i vjetruar (13 vjet pas datës së skadimit);
- Ambiguiteti i urdhrit operacional (keqkuptimi sa i përket llojeve të pajisjeve për t'iu shpërndarë policëve që merrnin pjesë në kontrollin e turmës);
- Dështimi i zinxhirit komandues;
- Dështimi i mbikëqyrjes;
- Ambiguiteti dhe pasaktësia në autorizimin për të përdorur plumba gome.

97. Në rekomandimet e tij, prokurori special këshilloi OKB-në që të bëjë një shqyrtim të plotë të politikave të aplikueshme nga OKB-ja, të qartësojë nëse përdorimi i plumbave të gomës nga policia në misionet paqeruajtëse të OKB-së fare autorizohet.

5. Mbyllja e hetimeve nga prokurori special

98. Pas lëshimit të raporteve të lartpërmendura, të përkohshëm dhe të dytë, hetimi duket të jetë ndërprerë. Megjithatë, dosja në posedim të Panelit nuk përmban një kopje të një vendimi të prokurorit special në lidhje me këtë, i lëshuar në pajtim me kërkesat e KPPPK.

99. Në deklaratat e shumta publike, liderët e Vetëvendosjes, të afërmit e viktimave të vdekura, dhe gjithashtu dy viktimat që mbijetuan, shprehën pakënaqësinë e tyre me rezultatet e hetimit të UNMIK-ut, në veçanti dështimin e tij për të provuar përgjegjësinë

individuale penale dhe mungesën e ndonjë veprimi (duke përfshirë atë disiplinor) kundër komandantëve të përfshirë në planifikimin dhe koordinimin e operacionit policor më 10 shkurt 2007. Hetimi është quajtur një "mbulesë" për krimet e kryera nga Policia ndërkombëtare.

100. Megjithatë, me sa është në dijeni Paneli, nuk është bërë asnjë përpjekje për të rihapur këtë hetim. Në çdo rast, Panelit nuk i është paraqitur ndonjë dokument që do të tregonte se ankuesit, apo ndonjë palë tjetër e interesuar, kishte bërë ankesë ndaj atij vendimi, apo provuar të bëjnë ndjekje subsidiare penale, siç parashihet me rregullat e procedurës së aplikueshme penale (shih § 123 më poshtë).

6. Hetimi i kryer nga Inspektorati i Policisë së Kosovës

101. Më 11 shkurt 2007, komisari i Policisë së UNMIK-ut ftoi inspektorin kryesor të IPK-së të "... bëjë një përmbledhje të pavarur të hetimeve që ndërlidhen me vdekjet e personave gjatë trazirave të 10 shkurtit të vitit 2007 në Prishtinë." Në letrën e njëjtë, komisari garantoi bashkëpunimin e plotë nga ana e Policisë së UNMIK-ut.

102. Panelit i është paraqitur teksti i plotë i Raportit të jashtëzakonshëm inspektues të IPK-së, i datës 1 mars 2007, i cili është titulluar "*Hetim për sjelljen e SHPK-së gjatë trazirave civile në Prishtinë të shtunën e 10 shkurtit të vitit 2007*". Në pjesën "hyrëse", të raportit qartësohet se:

> "1.2 Objektivi i caktuar i inspektimit ishte të konstatohet dhe vlerësohet performanca e atyre oficerëve të lartë të SHPK-së të cilët ishin përgjegjës për sjelljen e policëve të SHPK-së në zonën te rruga "Nënë Tereza" gjatë trazirës civile të së shtunës së 10 shkurtit …
> 1.3 … Inspektimi i IPK-së nuk parashikoi të hetojë ndonjë pretendim për shkelje – penale apo disiplinore – të policëve të SHPK-së apo Policisë Civile të UNMIK-ut. Hetimi i tillë është duke u bërë nga një ekip i caktuar nga komisari i Policisë së UNMIK-ut…
> 1.4 Po ashtu, raporti nuk ka të bëjë me marrëveshjen e komisarit të Policisë së UNMIK-ut dhe ministrit të Punëve të Brendshme që Inspektorati Policor duhet të bëjë një përmbledhje të pavarur të hetimeve të UNMIK-ut që ndërlidhen me vdekjen e personave gjatë trazirës civile. Të gjeturat e IPK-së në lidhje me këtë çështje do të jenë subjekt i një raporti të veçantë, që do të publikohet pas përfundimit të hetimit të UNMIK-ut."

103. Raporti paraqet versionin tjetër se, si u zhvillua demonstrata më 10 shkurt 2007 dhe potencon gjërat në vijim:

- Kishte dy plane operacionale të përgatitura për t'u përballë me demonstratën: njëri i Policisë së UNMIK-ut dhe tjetri i SHPK-së; kishte dy qendra komanduese dhe dy zinxhirë komandues, të cilët e ngadalësuan bartjen e urdhrave dhe marrjen e udhëzimeve përmes dhe në mes oficerëve komandues dhe policisë në terren, dhe shtuan konfuzionin e përgjithshëm;
- Barrierat metalike, të cilat formuan linjën e parë të barrikadës policore nuk ishin të lidhura njëra me tjetrën e as që bënë ndonjë përpjekje policët e SHPK-së t'i ndalin

protestuesit që t'i largojnë ato; kështu duket se demonstruesve nuk u shkaktoi asnjë vështirësi largimi i barrierave;

- Policët e SHPK-së që drejtonin linjën e parë të kordonit policor, me gjithë trajnimin serioz kundër trazirave që u është ofruar atyre, u dukën konfuzë dhe u mungonte lidershipi dhe komanda e duhur;
- Policët e SHPK-së nuk ishin të pajisur me maska gazi, megjithëse ata i kanë ato në pajisjen e tyre speciale.

104. Raporti paraqet një listë prej shtatë rekomandimesh të një natyre të përgjithshme, në lidhje me përmirësimin e funksionimit të Policisë së Kosovës.

105. Në një e-mail, të datës 7 mars 2007, një këshilltar i lartë i zëvendësit kryesor të PSSP-së informoi asistentin special të drejtorit të DD-së se, Zyra e PSSP-së nuk ka asnjë vërejtje për publikimin e raportit të lartpërmendur të IPK-së, ashtu siç është "bashkëhartuar pas skenës nga OSBE-ja [dhe] para-rregulluar nga BobDean".

7. Hetimi nga autoritetet gjyqësore rumune

106. Duket se me kërkesën e UNMIK-ut, autoritetet përgjegjëse gjyqësore rumune kryen një hetim penal për ngjarjet e 10 shkurtit të vitit 2007 (shih § 156 më poshtë). Këto procedura u mbyllën më 15 dhjetor 2009 nga prokurori kompetent ushtarak i Sektorit të Prokurorisë Ushtarake në kuadër të Zyrës së Prokurorisë e bashkangjitur në Gjykatën e Lartë Rumune të Kasacionit dhe Drejtësisë. Panelit nuk i është paraqitur një përshkrim i detajuar i procedurave të ndërmarra nga autoritetet gjyqësore rumune, por vetëm vendimi i 15 dhjetorit të vitit 2009.

107. Në vendimin e tij, prokurori përfundoi se për arsye se individi (ët) përgjegjës që kanë shtënë në protestues dhe u kanë shkaktuar vdekje dhe plagë atyre nuk mund të identifikoheshin, do të ishte kundër kërkesave të Kodit të Procedurës Penale të Rumanisë, neni 10(1)(c), që të vazhdojë me hetimin penal të hapur nga autoritetet gjyqësore rumune dhe ai pushoi procedurat.

108. Më 1 korrik 2009, PSSP-ja përveç kësaj qartësoi se "UNMIK-u ka pak informata në lidhje me këtë pasi nuk është një çështje që bie në kuadër të mandatit të UNMIK-ut. Informatat që UNMIK-u i ka i mori nga shtypi dhe është bërë e ditur se AmnestyInternational ka pyetur autoritetet rumune rreth progresit të hetimit të tyre për çështjen."

109. Më 15 korrik 2013, me kërkesën e Panelit, përfaqësuesi ligjor i ankuesve konfirmoi se, për shkak se "…nuk kishte asnjë vendim të shkallës së parë- apo të dytë të gjykatave penale të Rumanisë … [m]ë saktë, vendimi për të mos vazhduar me hetimin ishte marrë nga Sektori i Prokurorisë Ushtarake në kuadër të Zyrës së Prokurorisë i bashkëngjitur në Gjykatën e Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë", ata nuk kishin paraqitur ndonjë kundërshtim zyrtar ndaj atij vendimi.

8. Hetimi administrativ i OKB-së/procedurat disiplinore

110. Në dosjen në posedim të Panelit nuk paraqitet asgjë për ndonjë hetim administrativ të kryer nga organet e autorizuara të OKB-së, në lidhje me ndonjë shkelje të mundshme dhe/apo neglizhencë të personelit të UNMIK-ut.

9. Procedura për ankesa nga pala e tretë e OKB-së /Pagesa e kompensimit

111. Për përshkrim të plotë të këtij procesi dhe rezultatit të tij, Paneli i referohet vendimeve të tij mbi pranueshmërinë për këtë rast, të datës 31 mars 2010 dhe 11 maj 2012 (shih më lart, §§ 5 dhe 8).

112. Në vitin 2010 dhe 2011, procesi për ankesa nga pala e tretë i OKB-së u përfundua për secilin nga ankuesit dhe u pagua kompensimi për dëmet materiale të lidhura me vdekjet e të afërmve të ankuesve dhe për plagosjet e dy ankuesve tjerë të shkaktuara nga aksionet e Policisë së UNMIK-ut.

113. Paneli rikujton se kompensimi që u është paguar ankuesve nuk është bazuar në ndonjë pranim të një shkelje të të drejtave të njeriut të viktimave. Më qartë, ai paraqiste një pagesë exgratia. Për më tepër, siç u është sqaruar në mënyrë të vazhdueshme ankuesve nga ekipi negociator i UNMIK-ut, kompensimi kufizohet në humbjen ekonomike, duke përfshirë në veçanti humbjen e fitimeve. Asnjë kompensim nuk është paguar për dhimbjen dhe vuajtjen, dëshpërimin moral, dëmet e ndëshkueshme ose morale, apo llojet e tjera të humbjes, të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me lëndimin (shih Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 52/247 e 17 korrikut të vitit 1998 mbi *Detyrimin e Palës së Tretë: kufizimet kohore dhe financiar*e).

III. ANKESA

114. Ankuesit pohojnë se vrasja e z. Mon Balaj dhe z. Arben Xheladini dhe plagosja serioze e z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovajt përbëjnë shkelje të së drejtës në jetë, shkelje të së drejtës për ndalim të torturës dhe trajtimit johuman dhe degradues dhe të së drejtës për tubim paqësor. Ata gjithashtu pohojnë se nuk ka pasur asnjë hetim efektiv për incidentin, që ka rezultuar me një shkelje të aspektit procedural të së drejtës për jetë dhe ndalimit të torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo degradues. Në fund, ata pohojnë se duke mos qenë në gjendje të paraqesin ankesë kundër UNMIK-ut, para një gjykate apo para një organi tjetër që do të ishte në gjendje të ofrojë kompensim, të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe kompensim efektiv janë shkelur.

115. Ata thirren në instrumentet vijuese për të drejtat e njeriut:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), në veçanti nenet 3, 5, 8, 10 dhe 20;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ), në veçanti nenet 2, 3, 6, 11 dhe 13;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, në veçanti nenet 2, 6, 7 dhe 21;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit tjetër Mizor, Johuman apo Degradues, në veçanti nenet 2, 10, 12, 13, 14 dhe 16.

116. Paneli konsideron se dispozitat specifike të katër instrumenteve të përmendura për të drejtat e njeriut faktikisht mbulojnë fushat e njëjta relevante vijuese: e drejta për jetë, e drejta për të qenë i lirë nga tortura dhe trajtimi johuman dhe degradues, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për tubim paqësor dhe e drejta për kompensim efektiv.

IV. LIGJI

A. Ligji relevant vendor

1. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1

117. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1 e 25 korrikut të vitit 1999 *Mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë*, e ndryshuar nga rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/25 (12 dhjetor 1999) dhe 2000/51 (27 shtator 2000), përcakton kornizën kryesore ligjore për funksionimin e Misionit të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në pjesët e saj relevante thuhet:

> **Neni 1**
>
> **Autorizimet e administratës së përkohshme**
>
> 1.1 Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.
>
> **Neni 2**
>
> **Respektimi i standardeve të pranuara ndërkombëtare**
>
> Të gjithë personat që marrin përsipër detyra publike ose mbajnë funksione publike në Kosovë, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre duhet t'i respektojnë standardet e pranuara ndërkombëtare të të drejtave të njeriut...

2. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24

118. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1 e 25 korrikut të vitit 1999 *Mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë*, e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59 (27 tetor 2000), qartëson cilat ligje vlejnë në Kosovë dhe ofron hierarkinë e ligjeve. Ajo përcakton si në vijim:

> **Neni 1**
>
> **Ligji në fuqi**
>
> 1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:
>
> (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to; dhe
>
> (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.
>
> Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

…

1.3 Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç paraqitet veçanërisht në:

(a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të 10 dhjetorit 1948;

(b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut të 4 nëntorit 1950 dhe protokollet e saj;

(c) Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të 16 dhjetorit 1966 dhe protokollet e saj;

(d) Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të 16 dhjetorit 1966;

(e) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial të 21 dhjetorit 1965;

(f) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave të 17 dhjetorit 1979;

(g) Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Tjetër Mizor, Johuman dhe Degradues të 17 dhjetorit 1984; dhe

(h) Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve të 20 dhjetorit 1989.

3. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë

119. Korniza Kushtetuese është nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9. Në pjesët e saj relevante thuhet:

Kreu 3
Të drejta e njeriut

3.1 Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
3.2 Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuara në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në:

(a)Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;
(b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj;
(c) Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokollet e saj;
(d) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;
(e) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave;
(f) Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
(g) Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare; dhe
(h) Kornizën e Konventës të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

3.3 Dispozitat për të drejtat dhe liritë të parashtruara në këto instrumente aplikohen në Kosovë drejtpërsëdrejti si pjesë e kësaj Kornize Kushtetuese.

4. Dispozitat e Ligjit dhe Procedurës Penale

120. Ligji vendor i aplikueshëm në këtë rast është Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), i cili është miratuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25 dhe hyri në fuqi më 6 prill 2004.

121. Akuzat e mundshme penale sipas KPPK-së të marra parasysh nga prokurori special ishin: vrasje (neni 146), vrasje e rëndë (neni 147), vrasje nga pakujdesia (neni 149), lëndim i rëndë trupor (neni 154), me sa duket të shpallura së bashku me tentativën (neni 20). Prokurori special ka marrë parasysh aplikimin e dispozitave të cilat dekriminalizojnë një akt apo lejojnë zvogëlimin apo heqjen e dënimit të mundshëm sikur mbrojtja e nevojshme (neni 8), nevoja ekstreme (neni 9), dhe urdhrat nga lart (neni 10).

122. Rregullat që rregullojnë kryerjen e procedurave penale ishin në kohën relevante ato të KPPK-së, të miratuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26, e cila gjithashtu kishte hyrë në fuqi më 6 prill 2004.

123. Për sa i përket të drejtës të palës së dëmtuar të bëjë ndjekje subsidiare penale, në KPPK thuhet:

Neni 62

(1) … [K]ur prokurori publik konstaton se nuk ka baza për të kryer hetim apo ndjekje penale për shkelje penale e cila ndiqet penalisht *ex officio* … prokurori publik duhet të njoftojë palën e dëmtuar për këtë brenda periudhës prej tetë ditësh dhe të udhëzojë atë se ai apo ajo mund të inicojë ndjekje subsidiare penale …

(2) Pala e dëmtuar ka të drejtë të inicojë apo vazhdojë ndjekjen penale brenda tetë ditësh nga data e pranimit të njoftimit sipas paragrafit 1 të nenit aktual.

Neni 64

(1) Nëse brenda periudhës kohore të paraparë me ligj pala e dëmtuar nuk inicion apo vazhdon ndjekjen penale … duhet supozuar se ai ose ajo ka hequr dorë nga ndjekja penale, veç nëse ndryshe parashihet nga Kodi aktual.

5. Ligji mbi Prokurorin Publik

124. *Ligji mbi Zyrën e Prokurorit Publik*, i publikuar në gazetën zyrtare nr. 32/76 (i ndryshuar së fundi nga *Ligji mbi Amendamentimet për Ligjin mbi Zyrën e Prokurorit Publik*, nr. 18/88), përmban dispozitat relevante vijuese:

Neni 8

Prokurori i lartë publik, sipas ligjit, mund t'i japë prokurorit të ulët publik udhëzime obligative për punën e tij/saj, dhe mund të marrë përsipër detyra nga kompetenca e prokurorit të ulët publik.

Neni 12

Në ndjekjen e autorëve të krimeve dhe akteve të tjera të dënueshme të përshkruara me ligj, prokurori publik me organet hetimore përcakton dhe merr masa për

zbulimin e autorëve dhe krimeve. Sipas autorizimeve të caktuara me ligj, prokurori publik kryen procedurën preliminare.

Neni 14

Kur prokurori publik provon se për shkak të [një] shkelje … ka baza për përdorimin e mjeteve juridike kundër një vendimi ekzekutiv të gjykatës apo … procedurë tjetër, ai mund të kërkojë shtyrje apo pezullim të ekzekutimit të atij vendimi, nëse ekzekutimi i atij vendimi mendohet se shkakton pasoja të dëmshme të paevitueshme.

Neni 17a

Nëse prokurori publik … nuk paraqet kërkesë për … hetime …, gjykata duhet të informojë prokurorin e lartë publik …

Kur prokurori publik pranon informatat nga paragrafi 1 i këtij neni ai/ajo ndërmerr veprime dhe masa për t'i eliminuar të gjitha parregullsitë në punë dhe për t'i parandaluar të gjitha pasojat të cilat mund të jenë shkaktuar.

6. Emërimi dhe caktimi i prokurorëve ndërkombëtarë

125. Në kohën në fjalë, prokurorët ndërkombëtarë publikë në Kosovë janë emëruar në pajtim me nenin 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/6 *Mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtarë dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë* (të ndryshuar me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 2000/34 dhe 2001/2), në të cilën në pjesët relevante thuhet:

Neni 1
Emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë

1.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund t'i emërojë dhe shkarkojë gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë, duke marrë parasysh kriteret e parapara në nenin 2 dhe 4 të kësaj rregulloreje. Emërimet e tilla mund të bëhen në cilëndo gjykatë apo prokurori publike në territorin e Kosovës.

1.2 Gjyqtarët ndërkombëtarë gëzojnë autoritetin dhe përgjegjësinë t'i kryejnë funksionet e tyre, duke përfshirë edhe autorizimin për të përzgjedhur dhe marrë përgjegjësinë për rastet e reja penale apo në zhvillim e sipër në kuadër të juridiksionit të gjykatës ku ai/ajo është emëruar.

1.3 Prokurorët ndërkombëtarë gëzojnë autoritetin dhe përgjegjësinë t'i kryejnë funksionet e tyre, duke përfshirë edhe autorizimin dhe përgjegjësinë për kryerjen e hetimeve penale dhe për të përzgjedhur dhe marrë përgjegjësinë për hetimet apo procedurat e reja apo në zhvillim e sipër në kuadër të juridiksionit të prokurorisë ku ai/ajo është emëruar.

1.4 Prokurori ndërkombëtar mund të ndërmarrë, rifillojë ose vazhdojë ndjekjen penale të një rasti, duke përdorur procedurat e zbatueshme për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ashtu siç parashihet në nenet 60 dhe 61 dhe nenet e përafërta të zbatueshme të Kodit të Procedurës Penale të Jugosllavisë. Gjatë ushtrimit të pushtetit të tillë, prokurori ndërkombëtar:

(a) Do t'i ketë të gjitha të drejtat si prokuror publik dhe funksionin e tij do ta ushtrojë si zyrtar i qeverisë;

Neni 5
Ligji në fuqi

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë në ligjin në fuqi që nuk është në pajtim me të.

126. Caktimi i rasteve për prokurorët ndërkombëtarë bëhet në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/64 *Mbi Caktimin e Gjyqtarëve/Prokurorëve Ndërkombëtarë dhe/apo Ndërrimin e Vendit të Tyre* (e ndryshuar me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 2001/34, 2005/50, 2006/60 dhe 2007/21), në të cilën në pjesët relevante thuhet:

Preambula
…

Duke pasur parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut) të 25 korrikut 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/6 të 15 shkurtit 2000, të ndryshuar, mbi Emërimin dhe Shkarkimin e Gjyqtarëve Ndërkombëtarë dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë,

Duke ditur se ekzistimi i kërcënimeve ndaj sigurisë mund ta rrezikojë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë dhe të pengojë aftësinë e sistemit gjyqësor për t'i luftuar krimet në mënyrë adekuate, të cilat seriozisht e rrezikojnë procesin paqësor dhe ndërtimin e sundimit të së drejtës në Kosovë,

Me qëllim të sigurimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësisë dhe administrimin adekuat të drejtësisë, …

Neni 1
Rekomandim për caktimin e gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe/apo ndërrimin e vendit të tyre

1.1 Në çdo fazë të procedurës penale, prokurori kompetent, i akuzuari ose mbrojtësi mund të parashtrojnë kërkesë në Departamentin e Drejtësisë për caktimin e gjyqtarëve-prokurorëve ndërkombëtarë dhe ndërrimin e vendit ku kjo konsiderohet e nevojshme për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë ose administrimin adekuat të drejtësisë.

1.2 Në çdo fazë të procedurës penale, Departamenti i Drejtësisë, në bazë të kërkesës së përmendur në nenin 1.1 më lart ose me vetiniciativë mund t'i bëjë rekomandim Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për caktimin e gjyqtarëve-prokurorëve ndërkombëtarë dhe/apo të ndërrimin e vendit të tyre nëse ai konstaton se kjo është e nevojshme për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë ose administrimin adekuat të drejtësisë.

1.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do ta shqyrtojë rekomandimin e paraqitur nga Departamenti i Drejtësisë dhe do ta shpreh aprovimin apo

refuzimin për këtë. Shqyrtimi i tillë nuk do ta ndalojë vazhdimin e procedurës penale.

Neni 2
Caktimi i gjykatësve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe/apo vendi i ri i tyre

2.1 Me rastin e miratimit nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me nenin 1 më lart, Departamenti i Drejtësisë menjëherë do të caktojë:

(a) një prokuror ndërkombëtar, …

Neni 3
Ligji në fuqi

3.1 Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë në ligjin në fuqi që nuk është në pajtim me të..

7. Dispozitat ligjore në fushën e sigurisë publike

127. *Ligji mbi Rendin dhe Qetësinë Publike* i Krahinës Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës *(*i publikuar në gazetën zyrtare të KSA të Kosovës, me nr. 13/81) në pjesët vijuese thotë*:*

Neni 2

Në vend publik, secili është i obliguar të sillet në një mënyrë që me sjelljen e tij, kryerjen apo moskryerjen e veprimeve, të mos ndikojë në jetën normale të qytetarëve, të mos rrezikojë sigurinë e tyre, të mos ndikojë në lëvizjen e lirë të personave, të mos i shqetësojë qytetarët, të mos pengojë shfrytëzimin e ndërtesave publike, banesave dhe shtëpive tjera dhe të mos pengojë personat zyrtarë dhe agjencitë shtetërore, dhe gjithashtu organizatat të lidhura me punën dhe organizatat e tjera, të cilat kryejnë autorizime publike dhe zyrtarët e tyre, dhe nuk e pengojnë rendin publik …

Neni 4

Organizatori i manifestimit publik apo mbajtësi i të drejtës së shfrytëzimit të mjeteve transportuese duhet të sigurojë qetësinë publike në manifestim, dhe gjithashtu në mjetet transportuese, dhe t'i caktojë personat për mbajtjen e rendit në manifestim, dhe gjithashtu mjetet e transportit publik.

…

Me kërkesën e organizatorit të ngjarjes publike … agjencitë kompetente për punë të brendshme [duhet] të ndihmojnë në rikthimin e rendit dhe qetësisë së prishur.

128. *Ligji mbi Tubimet Publike* (i publikuar në gazetën zyrtare të KSA të Kosovës me nr. 8/81-184)në pjesët vijuese thotë:

Neni 2

Liria për të thirrur dhe mbajtur tubime publike mund të kufizohet vetëm për ato rastet e parapara me këtë Ligj.

Neni 3

O [rganizatori i tubimit publik] është i obliguar ta raportojë tubimin publik më së voni 48 orë para kohës së paraparë për tubim publik, dhe është i obliguar të deklarojë në raportimin e tij kohën, vendin dhe qëllimin e mbajtjes së tubimit publik.

O [rganizatori] ia raporton mbajtjen e tubimit publik organit për punë të brendshme … komunës në territorin e së cilës [organizatori] ka për qëllim të mbajë tubimin publik.

Neni 6

Organi i autorizuar komunal për punë të brendshme është i autorizuar të mundësojë mbajtje të papenguar të tubimit publik dhe të kujdeset rreth sigurisë së njerëzve dhe pronës në tubim publik.

Neni 7

Mbajtja e tubimit publik ndalohet kur kjo kërkohet nga organi i departamentit të autorizuar për mbrojtje të shëndetit, në kuadër të kufizimeve të autorizimit të përcaktuar me një Ligj.

Neni 8

Mbajtja e tubimit publik gjithashtu mund të ndalohet kur [organizatori apo] organi komunal për punë të brendshme, nuk është në gjendje të sigurojë me kohë rendin dhe qetësinë dhe trafik normal publik, dhe është arsyeshëm e pritshme se rendi dhe qetësia publike do të çrregulloheshin apo siguria do të kërcënohej në tubim publik, apo mbajtja e tubimit publik do të pamundësonte trafikun normal publik.

Neni 9

…

Organi i autorizuar për punë të brendshme është i obliguar të informojë [organizatorin] rreth ndalesës për të mbajtur tubimin e paraqitur publik më së voni 24 orë para kohës të paraparë për tubim.

8. Rregullat që rregullojnë përdorimin e forcës nga Policia e UNMIK-ut

129. Përdorimi i forcës nga Policia e UNMIK-ut rregullohet me nenin 1 të Manualit mbi Procedurat dhe Politikën (i përmendur në 30 më lart), "Përdorimi i forcës dhe armëve të zjarrit". Në pjesët e tij relevante thuhet:

1.1 Përdorimi i forcës

1.Policët e UNMIK-ut do të përdorin forcën vetëm kur është e nevojshme, dhe atëherë vetëm sasinë e forcës të nevojshme për të arritur objektiva legjitime të zbatimit të ligjit.

2. Faktet apo rrethanat e panjohura për policin/ët në kohën e incidentit nuk do të shfrytëzohen për të përcaktuar nëse forca ishte e justifikueshme.

3. Policët e UNMIK-ut do të përdorin vijimësi forcegjatë përcaktimit se cilin nivel të forcës ta zbatojnë në ndonjë situatë të dhënë.

1.2 Vijimësia e forcës

1.Niveli i parë: Prania e policit dhe përdorimi i komandave verbale …

2. Niveli i dytë: Rezistenca pasive. Ku subjekti nuk i reziston aktivisht policit/ëve. Ai/ajo nuk bindet dhe nuk ndjek komandat e policit/ëve. Ky nivel mund të kërkojë kombinimin e komandave verbale dhe gjithashtu aplikimin e kontrollit të lehtë me duar.

3. Niveli i tretë: Rezistenca aktive. Ku subjekti aktivisht u reziston policëve. Ky nivel mund të kërkojë aplikimin e teknikës së dorës së fortë (goditjeve, shkelmave, sprejit që shkakton djegie në sy, etj.) dhe/apo goditjeve me shkop polici...

4. Niveli i katërt: Rezistenca e armatosur. Ku subjekti(et) janë të armatosur me një mjet të rrezikshëm apo armë vdekjeprurëse dhe aktivisht rezistojnë apo kërcënojnë përdorimin e mjeteve të rrezikshme apo armës vdekjeprurëse …

Vijimësia e forcësështë rregull e përgjithshme. Policët mund të kalojnë nga një nivel në ndonjë nivel tjetër më të lartë menjëherë, varësisht nga rrethanat. Nëse subjekti (et) e përfshira në incident e zvogëlojnë eskalimin e rezistencës së tyre, polici duhet të përdorë vetëm nivelin e forcës që është i nevojshëm të sjellë suksesshëm deri te fundi incidentin.

6.5 Menaxhimi i turmës

1.Policia e UNMIK-ut do të bëjë çdo përpjekje për të kontrolluar një turmë /bllokim rruge apo demonstratë dhe të përcaktojë nëse kërkohen Forcat Speciale Policore. Një vlerësim i seriozitetit të situatës dhe ndikimit në komunitet duhet bërë me qëllim të përcaktimit të nivelit të duhur të përgjigjes.

Nivelet e vlerësimit:

Niveli i parë: Pengesat e vogla, numër i vogël i pjesëmarrësve në turmë (20-30 persona), të gatshëm të negociojnë me Policinë.

Niveli i dytë: Turmë më e zhurmshme (50-100 persona), pengesë më e madhe për qarkullimin e trafikut/këmbësorëve, mundësi për eskalim, më pak negociata me udhëheqësin(ët) e turmës, shfaqja e objekteve/predhave.

Niveli i tretë: Eskalim i plotë i dhunës në turmë, pengesa të mëdha për trafikun dhe këmbësorët, nuk ka koordinim të dukshëm apo lidership në turmë, gjuhen predha, rrezik për jetën.

2. Mbikëqyrësi i Policisë së UNMIK-ut në vend të ngjarjes do të vendosë për burimet për t'u përballë me situatën (Policia Speciale, KFOR-i etj.). Përveç kësaj, mbikëqyrësi do të bëjë përpjekje t'i identifikojë shkaktarët e incidentit dhe të fillojë të negociojë …

Miratimi përfundimtar për kërkesat e demonstratës:

… Komandanti rajonal e ka autoritetin t'i plotësojë kërkesat që të mbahen demonstrata apo protesta të planifikuara.

Miratimi përfundimtar [i një vendimi] për të refuzuar leje për një demonstratë apo protestë është përgjegjësi e komisarit të Policisë.

B. Parimet dhe normat relevante ndërkombëtare

130. *Kodi i Mirësjelljes përzyrtarët e zbatimit tëligjit* (i miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së nr. 34/169 i 17 dhjetorit të vitit 1979) në pjesët vijuese thotë:

Neni 3
Zyrtarët për zbatimin e ligjit mund të përdorin forcën vetëm kur është qartas e nevojshme dhe deri në nivelin e kërkuar për kryerjen e detyrës së tyre.

131. Në komentin ndaj këtij neni nga Zyra e Komisarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNJ) [8] thuhet:

(a) Kjo dispozitë thekson se përdorimi i forcës nga zyrtarët për zbatimin e ligjit duhet të bëhet në raste të veçanta; ndërsa kjo nënkupton se zyrtarët për zbatimin e ligjit mund të autorizohen të përdorin forcën që është arsyeshëm e nevojshme sipas rrethanave për të parandaluar krimin apo kryer apo ndihmuar në arrestimin e ligjshëm të kundërvajtësve apo kundërvajtësve të dyshuar, dhe kurrfarë force përtej asaj nuk mund të përdoret.

(b) Ligji nacional zakonisht kufizon përdorimin e forcës nga zyrtarët për zbatimin e ligjit në pajtim me një parim të proporcionalitetit. Duhet kuptuar se parimet e tilla nacionale të proporcionalitetit do të respektohen në interpretimin e kësaj dispozite. Në asnjë rast kjo dispozitë nuk mund të interpretohet për të autorizuar përdorimin e forcës, e cila nuk është në proporcion me objektivin legjitim që dëshirohet të arrihet.

(c) Përdorimi i armëve të zjarrit konsiderohet një masë ekstreme. Duhet bërë çdo përpjekje për të përjashtuar përdorimin e armëve të zjarrit, veçanërisht kundër fëmijëve. Në përgjithësi, armët e zjarrit nuk duhet përdorur përveç kur një kundërvajtës i dyshuar bën rezistencë të armatosur apo ndryshe rrezikon jetët e të tjerëve dhe masat më pak ekstreme nuk janë të mjaftueshme për ta burgosur apo kapur kundërvajtësin e dyshuar. Në çdo rast në të cilin shkrepet një armë zjarri, duhet paraqitur shpejt një raport autoriteteve kompetente.

132. *Parimet Themelore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët për Zbatimin e Ligjit* (të miratuara më 7 shtator 1990 në Kongresin e Tetë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kundërvajtësve) parashohin në nenin 9 se "përdorimi i qëllimshëm vdekjeprurës i armëve të zjarrit mund të bëhet vetëm kur kjo është qartas epashmangshme me qëllim të mbrojtjes së jetës". Në dispozitat e tjera relevante thuhet si në vijim:

Dispozitat e përgjithshme

1.Qeveritë dhe agjencitë për zbatimin e ligjit duhet t'i miratojnë dhe zbatojnë rregullat dhe rregulloret mbi përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit kundër personave nga ana e zyrtarëve për zbatimin e ligjit. Në hartimin e rregullave dhe

[8] Teksti i këtij Kodi dhe komenti në të janë në dispozicion në faqen e internetit të ZKLDNJ [burimi elektronik]: www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/LawEnforcementOfficials.aspx (e qasur më 21 janar 2015)

rregulloreve të tilla, qeveritë dhe agjencitë për zbatimin e ligjit do t'i kenë parasysh në mënyrë konstante çështjet etike të lidhura me përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit.

2. Qeveritë dhe agjencitë për zbatimin e ligjit duhet të krijojnë një varg mjetesh sa më të mëdha që të jetë e mundshme dhe t'i pajisin zyrtarët për zbatimin e ligjit me lloje të ndryshme të armëve dhe municionit që lejon përdorim të diferencuar të forcës dhe armëve të zjarrit. Këto duhet të përfshijnë zhvillimin e armëve paaftësuesejovdekjeprurëse për t'u përdorur në situata të caktuara, me qëllim gjithnjë e më shumë përmbajtjen nga përdorimi i mjeteve të afta të shkaktojnë vdekje apo plagosje të personave. Për qëllimin e njëjtë, duhet të bëhet e mundshme për zyrtarët për zbatimin e ligjit që të pajisen me pajisje vetëmbrojtëse sikur mburojat, helmetat, jelekët antiplumb dhe mjete antiplumb transporti, me qëllim të zvogëlimit të nevojës për t'i përdorur armët e çfarëdo lloji.

3. Zhvillimi dhe përdorimi i armëve paaftësuesejovdekjeprurëse duhet vlerësuar kujdesshëm me qëllim të minimizimit të rrezikut për t'i rrezikuar personat e papërfshirë, dhe përdorimi i armëve të tilla duhet kontrolluar kujdesshëm.

4. Zyrtarët për zbatimin e ligjit, gjatë kryerjes së detyrave, sa më shumë që të jetë e mundshme, përdorin mjete jo të dhunshme para përdorimit të forcës dhe armëve të zjarrit. Ata mund të përdorin forcën dhe armët e zjarrit vetëm nëse mjetet e tjera mbesin joefektive apo nëse nuk ka ndonjë shpresë për arritjen e rezultatit të synuar.

5. Kurdo që përdorimi i ligjshëm i forcës dhe armëve të zjarrit është i pashmangshëm, zyrtarët për zbatimin e ligjit duhet:

(a) Të përmbahen gjatë përdorimit të tillë dhe veprojnë në proporcion me seriozitetin e shkeljes dhe objektivin legjitim që synohet të arrihet;

(b) Të minimizojnë dëmin dhe lëndimin, dhe respektojnë dhe ruajnë jetën e njeriut;

(c) Të sigurojnë që asistenca dhe ndihma mjekësore u është dhënë çdo personi të plagosur apo prekur në afatin më të shkurtër të mundshëm;

(d) Të sigurojnë që të afërmit apo miqtë e ngushtë të personit të plagosur apo prekur do të njoftohen në afatin më të shkurtër të mundshëm.

6. Ku plagosja apo vdekja shkaktohet nga përdorimi i forcës dhe armët e zjarrit nga zyrtarët për zbatimin e ligjit, ata e raportojnë incidentin menjëherë tek eprorët e tyre, në pajtim me parimin 22.

7. Qeveritë sigurojnë që përdorimi arbitrar apo abuziv i forcës dhe armëve të zjarrit nga zyrtarët për zbatimin e ligjit të dënohet si shkelje penale sipas ligjit të tyre.

8. Rrethanat e jashtëzakonshme sikur jostabiliteti i brendshëm politik apo ndonjë emergjencë tjetër publike nuk mund të përdoren për të arsyetuar ndonjë largim nga këto parime themelore.

Kryerja e detyrave policore në tubimet e paligjshme

13.Në shpërndarjen e tubimeve që janë të paligjshme por jo të dhunshme, zyrtarët për zbatimin e ligjit duhet të shmangin përdorimin e forcës apo, ku ajo nuk është

praktike, duhet të kufizojnë përdorimin e forcës së tillë në nivelin minimal të nevojshëm . …

14. Në shpërndarjen e tubimeve të dhunshme, zyrtarët për zbatimin e ligjit mund t'i përdorin armët e zjarrit vetëm kur mjetet më pak të rrezikshme nuk janë praktike dhe vetëm në nivelin minimal të nevojshëm.

18. Qeveritë dhe agjencitë për zbatimin e ligjit sigurojnë që të gjithë zyrtarët për zbatimin e ligjit të zgjedhen përmes procedurave të duhura të kontrollit, të kenë cilësitë e duhura morale, psikologjike dhe fizike për ushtrim efektiv të funksioneve të tyre dhe të marrin trajnim të vazhdueshëm dhe të plotë profesional. Përshtatshmëria e tyre e vazhdueshme të kryejnë këto funksione duhet të jenë subjekt shqyrtimi periodik.

19. Qeveritë dhe agjencitë për sundimin e ligjit sigurojnë që të gjithë zyrtarëve për zbatimin e ligjit u ofrohet trajnim dhe testohen në pajtim me standardet përkatëse të aftësisë në përdorimin e forcës. …

22. ... Qeveritë dhe agjencitë për sundimin e ligjit sigurojnë që është në dispozicion një proces efektiv shqyrtimi dhe që autoritetet e pavarura administrative apo prokuroriale janë në pozitë të përdorin juridiksionin në rrethana të duhura. Në rastet e vdekjes dhe plagosjes serioze apo pasojave tjera të rënda, një raport i detajuar u dërgohet menjëherë autoriteteve kompetente përgjegjëse për shqyrtim administrativ dhe kontroll gjyqësor.

23. Personat e prekur nga përdorimi i forcës dhe armëve të zjarrit apo përfaqësuesit e tyre ligjorë do të kenë qasje në një proces të pavarur, duke përfshirë një proces gjyqësor. Në rast të vdekjes të personave të tillë, kjo dispozitë vlen për vartësit e tyre në përputhje me rrethanat.

133. *Standardet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drejtësi Penale për Policinë Paqeruajtëse* (1994) në pjesët relevante përfshijnë:

PARIMET ESENCIALE

Forca të përdoret vetëm kur është qartas e nevojshme dhe jo jashtë mase.

2. FORCA DHE ARMËT E ZJARRIT

2.3 Zyrtarët për zbatimin e ligjit nuk përdorin forcën apo dhunën fizike veç në rastet kur metodat e tjera nuk kryejnë punë, dhe nuk përdorin më shumë forcë sesa është absolutisht e nevojshme të arrihet objektivi legjitim për zbatimin e ligjit.

2.7 Kurdo që përdorimi i ligjshëm i forcës dhe armëve të zjarrit është i pashmangshëm, zyrtarët për zbatimin e ligjit duhet:

1. Të veprojnë me përmbajtje dhe përdorin vetëm nivelin e forcës të nevojshme për të arritur objektivin legjitim për zbatimin e ligjit;

2. Të respektojnë jetën e njeriut dhe tu shkaktojnë njerëzve nivel minimal të lëndimit; …

2.9 Secili që është prekur nga përdorimi i forcës apo armëve të zjarrit ka të drejtë t'u kërkojë autoriteteve të bëjnë hetim apo shqyrtim zyrtar (duke përfshirë një shqyrtim nga një gjykatës apo autoritet i ngjashëm).

…

134. *Manuali i Policisë Civile i Kombeve të Bashkuara* (1995) është dizajnuar për të ndihmuar Policinë Civile të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (POLCIV) në kryerjen e detyrave të tyre në terren; ai ofron informata të përgjithshme për paqeruajtjen e OKB-së dhe përfshin parimet udhëheqëse të misioneve të POLCIV të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe konceptin e përbashkët të operacioneve. Ai përmban dispozitat vijuese relevante:

> **Përdorimi i forcës minimale.** Në operacionet paqeruajtëse, forca nuk do të përdoret për të kryer mandatin. Përdorimi minimal i forcës nuk përjashton vetëmbrojtjen e personelit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe pronës. Përdorimi i forcës duhet të definohet qartas në rregullat për angazhim.
> **Armët**. Këshilli i Sigurimit mundet, në raste të veçanta, të autorizojë një operacion të Policisë Civile të Kombeve të Bashkuara t'i bartë armët. Në rastet e tilla, do të përgatitet një udhëzim për përdorimin e armëve për këtë qëllim**.**

135. Paneli thekson se disa instrumente ndërkombëtare të përmendura më lart janë në formë të rezolutave, kodeve të mirësjelljes dhe udhëzimeve dhe, si të tilla, nuk janë ligjërisht detyruese. Sidoqoftë ai thekson se gjuha e tyre është normative dhe ato gjerësisht pranohen për t'i paraqitur standardet përkatëse ndërkombëtare të mirësjelljes për zyrtarët për zbatimin e ligjit dhe, si të tilla, duhet konsideruar si autoritative.

C. Shkelja e pretenduar e nenit 2 të KEDNJ-së

136. Ankuesit z. KadriBalaj dhe z. Shaban Xheladini ankohen se të afërmit e tyre kanë vuajtur dhe vdekur si rezultat i aksioneve të Policisë së UNMIK-ut për të shpërndarë demonstratën më 10 shkurt 2007, në kundërshtim me nenin 2 të KEDNJ-së. Sipas të njëjtit nen, ankuesit z. ZenelZeneli dhe z. MustafëNerjovaj pohojnë se jetët e tyre janë vënë në rrezik dhe se ata janë rrezikuar nga ato aksione dhe më pas kanë vuajtur. Të gjithë ankuesit gjithashtu pohojnë se hetimi penal i kryer nga autoritetet e UNMIK-ut kishte qenë joefektiv. Ata mbështeten, në mes tjerash, në nenet 2 dhe 3 të KEDNJ-së.

137. Një ankesë karakterizohet nga faktet e nxjerra në të dhe jo vetëm nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet (shih GJEDNJ, *Powell dhe Rayner kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9310/81, vendimi i 21 shkurtit të vitit1990, § 29, seria A nr. 172; GJEDNJ [DHL], *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2), nr. 10249/03, 17 shtator 2009, § 54). Meqë Paneli e bazon në ligj kualifikimin që do të jepet për faktet e rastit, nuk e konsideron veten të lidhur me karakterizimin e dhënë nga ankuesit (shih GJEDNJ, *AnzheloGeorgiev dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, vendimi i 30 shtatorit të vitit 2014, § 46; GJEDNJ [DHL], *Tarakhel kundër Zvicrës*, nr. 29217/12, vendimi i 4 nëntorit të vitit 2014, § 55). Në rastin aktual, Paneli konstaton se ankesa në mënyrën më të përshtatshme ekzaminohet sipas mbrojtjes së të drejtës për jetë. Në nenin e KEDNJ-së, nenin 2, thuhet si në vijim:

> 1. E drejta e secilit në jetë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk privohet nga jeta e tij qëllimisht përveç në rast të ekzekutimit të një dënimi të gjykatës pas dënimit të tij për krim për të cilin ky dënim parashihet me ligj.
>
> 2. Privimi nga jeta nuk vlerësohet si i shkaktuar në kundërshtim me këtë nen kur ai rezulton nga përdorimi i forcës, i cili është më shumë se absolutisht i nevojshëm:

(a) në mbrojtje të ndonjë personi nga dhuna e paligjshme;

(b) me qëllim të kryerjes së një arrestimi të ligjshëm apo për të parandaluar ikjen e një personi të mbajtur ligjshëm;

(c) në aksion të ndërmarrë ligjshëm me qëllim të shtypjes së një trazire apo kryengritje.

Pranueshmëria

138. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja rithekson se vendimi i Panelit për t'i rihapur procedurat nuk kishte ndonjë bazë ligjore dhe nuk parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/12 dhe Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2009/1.

139. Paneli tanimë e ka analizuar dhe hedhur poshtë vërejtjen e njëjtë të PSSP-së për vendimin e tij mbi pranueshmërinë për rastin të 11 majit të vitit 2012 (§§ 47 - 54).

140. Paneli nuk sheh ndonjë arsye për të hequr dorë nga përfundimi i vet i mëparshëm për çështjen dhe hedh poshtë këtë vërejtje të PSSP-së.

Bazueshmëria

1. Parashtresat e palëve

a. Mbi obligimin esencial sipas nenit 2

141. Ankuesit në esencë argumentojnë se nuk ka asnjë dëshmi se z. Mon Balaj, z. Arben Xheladini, z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj ishin të përfshirë në ndonjë aktivitet të paligjshëm që kërcënonte jetën e ndonjë individi gjatë demonstratës në shkurt të vitit 2007, prandaj nuk ka pasur arsye për Policinë e UNMIK-ut t'i përdorë plumbat e gomës. Përveç kësaj, plumbat janë përdorur në mënyrë të papërshtatshme dhe ishin përtej datës së tyre të skadimit, e cila e shkaktoi rrezikun e vdekshmërisë.

142. Po ashtu argumentohet se para përdorimit të forcës vdekjeprurëse, nuk ishte bërë asnjë përpjekje për të penguar demonstratën që të vazhdojë. Ankuesit pohojnë se ishin aksionet e policëve të UNMIK-ut (përdorimi i gazit lotsjellës dhe plumbave të gomës) që provokoi shfaqjet e vogla të rebelimit, jo e kundërta.

143. Për sa i përket çështjes së pajtueshmërisë së demonstratës së 10 shkurtit të vitit 2007 me dispozitat relevante të ligjit të zbatueshëm (shih §§ 253 më poshtë), ankuesit shtojnë se "[n]ë çdo rast, nuk është në mënyrë strikte relevante për çështjet për të cilat Paneli është i ftuar të vendosë … sepse standardet relevante ndërkombëtare (siç janë përmbledhur në parimet 12-14 të Parimeve Themelore mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët për Zbatimin e Ligjit, të miratuara në Kongresin e Tetë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kundërvajtësve, Havanë, Kubë, prej 27 gusht deri më 7 shtator 1990) dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlejnë njëlloj për tubimet e ligjshme dhe të paligjshme."

144. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e kësaj pjese të ankesës, PSSP-ja informoi Panelin se ai "mori shënime" për pretendimet dhe e referoi Panelin te konkluzionet e prokurorit special të paraqitura në raportet e tij mbi çështjen, të cilat UNMIK-u i pranon plotësisht, dhe të cilat duhet marrë parasysh në vend të përgjigjes së PSSP-së.

b. Mbi obligimin procedural sipas nenit 2

145. Ankuesit në thelb ankohen se hetimi për ngjarjen nuk është kryer në pajtim me kërkesat procedurale të nenit 2 të KEDNJ-së, e as në pajtim me kërkesat e ligjit të zbatueshëm, se ishte plot parregullsi dhe se ai përfshiu policët rumunë si hetues, në një konflikt të pastër interesi.

146. Në veçanti, ankuesit argumentojnë se hetimi nuk ishte i shpejtë, pasi "ai nuk ishte nisur deri pas 4 ditësh nga ngjarjet në fjalë, gjatë të cilave mund të jetë humbur dëshmi e vlefshme"; kishte gjithashtu vonesë në sigurimin e bashkëpunimit të kontingjentit të NJSP rumune, e kjo "rezultoi me hetim që nuk ishte në gjendje t'i identifikojë dhe dënojë ata që janë përgjegjës".

147. Ankuesit pohojnë më tutje se hetimi nuk ishte i pavarur, pasi të dy prokurori special dhe Policia e UNMIK-ut i raportuan PSSP-së. Ankuesit gjithashtu pohojnë në lidhje me këtë se policët rumunë të Policisë së UNMIK-ut morën pjesë në hetim "pavarësisht se ishte e qartë se si të dyshuar u përfshinë policët rumunë të Policisë së UNMIK-ut"; këto "lidhje në mes individëve të cilët kryen hetim dhe atyre që hetoheshin kompromotojnë pavarësinë e hetimit."

148. Ankuesit gjithashtu pohojnë se "hetimi nuk dukej të jetë përpjekje e mirëfilltë të kërkohet të mbahet dikush përgjegjës"; sasi e madhe e dëshmisë së mbledhur nuk "u mor parasysh me rigorozitetin e mjaftueshëm", kishte plot mospërputhje, të cilat nuk u trajtuan si duhet. Ata specifikojnë në lidhje me këtë se:

- pjesëtarët rumunë të NJSP-së "dhanë deklarata identike në gjuhën angleze, pavarësisht se asnjëri nga ta madje nuk e fliste këtë gjuhë";
- kur policët e NJSP-së u intervistuan si duhet, "disa javë më vonë", ata "morën tregimin e tyre ndershmërisht", për të mbuluar ndonjë veprim të mundshëm ilegal nga ana e tyre;
- dëshmitarët okularë nuk u pyetën për t'i përshkruar pushkatarët;
- "asnjë nga policët rumunë të Policisë së UNMIK-ut nuk u morën në pyetje si të dyshuar në pajtim me LPPPK, duke e paraqitur çdo dëshmi kundër tyre të papranueshme";
- "transkripti/përkthimet në gjuhën angleze të intervistave të policëve rumunë të Policisë së UNMIK-ut përmbanin informata që nuk i përmbanin shënimet origjinale rumune për intervistat të shkruara me dorë"; dhe
- "pavarësisht faktit se shumë prej provave të paraqitura nga pushkatarët rumunë të NJFP-së ishin kontradiktore dhe/apo të pavërteta, nuk është dhënë asnjë shpjegim për këtë dhe tregimet e tyre janë pranuar si të tilla".

149. Në fund, ankuesit deklarojnë se ata nuk ishin "të përfshirë aktivisht në procedurë në mënyrë adekuate apo nuk ishin përfshirë fare. Është shqetësim i madh se një shumë i afërm i Mon Balajt u ndie aq i hidhëruar nga mungesa e përfshirjes së familjes në hetim, sa që ai shkoi në zyrën e Robert Dean, dhe refuzoi të largohet derisa ai siguroi një takim me të."

150. Me kërkesën e Panelit, përfaqësuesit e ankuesve qartësuan se sipas njohurive të tyre, procedurat penale të ndërmarra nga organet përgjegjëse të Republikës së Rumanisë kurrë nuk kanë arritur te gjykata. Procedurat e lartpërmendura ishin pezulluar me një vendim për të mos vazhduar me hetimin të kryer nga prokurori i Sektorit të Prokurorisë Ushtarake në kuadër të Zyrës së Prokurorisë e bashkëngjitur në Gjykatën e Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, i cili nuk mund të konsiderohet as vendim i shkallës së parë apo të dytë i gjykatave penale rumune.

151. Në komentet e tij, PSSP-ja pajtohet në përgjithësi se ishte përgjegjësi e UNMIK-ut të kryejë hetim efektiv për ngjarjet që çuan te vdekjet dhe plagosjet e protestuesve, me qëllim të sigurimit që ata që janë gjetur përgjegjës për to të mbahen përgjegjës. Ai shton se një hetim i tillë përfshin obligimin për të përcaktuar, e para, nëse përdorimi i forcës ishte i justifikueshëm dhe nëse vdekjet dhe plagosjet ishin shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe, e dyta, ku ato ishin të paligjshme, që ata që ishin përgjegjës të sillen para drejtësisë.

152. PSSP-ja mendon se përgjigjja e UNMIK-ut në ngjarjet e 10 shkurtit të vitit 2007 ishte e shpejtë, pasi hetimi policor ishte filluar menjëherë nga Policia e UNMIK-ut pas ngjarjeve përmes krijimit të Task Forcës dhe emërimit të prokurorit special për të mbikëqyrë hetimin dhe udhëheqë ekipin hetimor (shih §§ 63-64 më lart).

153. PSSP-ja parashtron më tutje se Task Forca ishte e pavarur dhe e paanshme, të dyja sipas ligjit dhe në praktikë. Ajo përbëhej nga policët ndërkombëtarë të nacionaliteteve të ndryshme, duke përfshirë dy policë të Kosovës. PSSP-ja thekson se sipas skemës organizative, nuk kishte policë të Policisë së UNMIK-ut të nacionalitetit rumun, megjithëse hetuesve u kërkohej t'i shfrytëzojnë përkthyesit rumunë. PSSP-ja thekson në këtë drejtim se "hetimi i policëve të të njëjtit nacionalitet si i dyshuari mund të mos sjellë, vetvetiu, te përfundimi se hetimi ishte i anshëm."

154. PSSP-ja shton se vetë hetimi vetvetiu ishte gjithashtu i shpejtë dhe i plotë, pasi ai kishte siguruar dëshminë e nevojshme të mjekësisë ligjore dhe deklaratat Të dy raportet e dorëzuara nga Task Forca prokurorit special, specifikojnë të gjitha veprimet e ndërmarra, duke përfshirë një përmbledhje të procesit të mbledhjes së dëshmive. Konkluzionet e dy raporteve të prokurorit special ishin të plota, objektive dhe të paanshme. Viktimat dhe familjet e viktimave janë mbajtur të njoftuar për progresin e hetimit gjatë gjithë kohës në fjalë; atyre dhe avokatëve të tyre iu ofrua qasje në dosjet e prokurorit special.

155. Sipas mendimit të PSSP-së, kritikat drejtuar nga ankuesit nuk prekin në efektivitetin e përgjithshëm të hetimit dhe vlerën e raporteve të Task Forcës dhe prokurorit special, pavarësisht faktit se asnjë nuk është identifikuar për të mbajtur përgjegjësinë penale për vdekjet/plagosjet. Raporti i prokurorit special sqaron qartas mjetet dhe metodat e përdorura për të mundësuar identifikim të tillë dhe arsyet se pse përfundimisht nuk ndodhi asnjë identifikim. Në veçanti, nuk kishte asnjë dëshmitar okular që ishte në

gjendje të identifikojë policin i cili shkrepi të shtënën (at) vdekjeprurëse dhe dëshmia e mbledhur fizike ishte e pamjaftueshme për një identifikim përfundimtar.

156. Përveç kësaj, me kërkesën e UNMIK-ut, autoritetet gjyqësore rumune kryen hetim për ngjarjet e 10 shkurtit të vitit 2007. Megjithatë, procedurat penale në Rumani u mbyllën më 15 dhjetor 2009 nga prokurori kompetent ushtarak i Sektorit të Prokurorisë Ushtarake në kuadër Zyrës së Prokurorisë e bashkëngjitur në Gjykatën e Lartë Rumune të Kasacionit dhe Drejtësisë. Në vendimin e tij, prokurori përfundoi se për shkak se individi(ët) përgjegjës që shtinë në protestues dhe u shkaktuan vdekje dhe lëndime protestuesve nuk mund të identifikoheshin, do të ishte në kundërshtim me kërkesat e Kodit rumun të Procedurës Penale, neni 10(1)(c), të vazhdohet me hetimin penal të hapur nga autoritetet gjyqësore rumune dhe ai pezulloi procedurat.

157. Duke përfunduar komentet e tij për këtë pjesë të ankesës, PSSP-ja parashtron se UNMIK-u kreu hetim efektiv në pajtim me obligimin procedural të nenit 2 të KEDNJ-së për të vërtetuar fatin e personave të vdekur dhe, në shkallën e mundshme, të identifikojë autorët dhe t'i sjellë ata para drejtësisë. Megjithëse individi përgjegjës nuk mund të identifikohej, PSSP-ja konsideron se kjo nuk ishte për shkak të të metave në hetim, por më parë nga mungesa e dëshmisë së dëshmitarit okular. Nuk ka asnjë indikacion për ndonjë dështim specifik në procesin e hetimit.

158. Përveç kësaj, PSSP-ja thekson se nëse do të ishte mbledhur dëshmi e mjaftueshme për përgjegjësi individuale penale, në pajtim me politikën ekzistuese të OKB-së, imunitetit i të dyshuarit(ve) do të hiqej nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, me qëllim që të sigurohet se drejtësia është përmbushur.

159. Në fund, për sa i përket hetimit disiplinor apo tjetër për përgjegjësinë e mundshme të një apo disa personave (siç janë oficerët në komandë të operacionit), PSSP-ja, në fazën e pranueshmërisë (shih § 2 më lart), në përgjigjen e tij të 1 korrikut të vitit 2009 në pyetjet e Panelit nëse ai hetim ishte kryer, thotë:

> "Nuk është kryer asnjë hetim penal në kontekst të nenit 129 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Përgjegjësia komanduese vetëm mund të çojë te përgjegjësia penale në kontekst të krimeve të luftës, por jo te personat që komandojnë operacionet në një kontekst civil. Pavarësisht kësaj, Raporti i përkohshëm i prokurorit special i 16 prillit të vitit 2007 përmend tërthorazi fusnotën në f. 2 për "përpjekje të veçanta hetimore … të bëra lidhur me aktivitetin e mundshëm kriminal të atyre që planifikuan, udhëhoqën dhe ishin të përfshirë në protestë".

2. Vlerësimi i Panelit

160. Panelit i kërkohet të vërtetojë nëse faktet në rastin aktual zbulojnë një dështim të UNMIK-ut që të mbrojë të drejtën e ankuesve në jetë dhe të veprojë në pajtueshmëri me obligimin procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së, për të kryer hetim adekuat dhe efektiv për vdekjet e të afërmve të ankuesve dhe plagosjet e ankuesve.

a. Dorëzimi i dosjeve relevante

161. Siç është përmendur më lart, më 30 tetor 2013, Paneli pranoi nga UNMIK-ut dosjen që më parë e kishte mbajtur prokurori special i UNMIK-ut dhe Task Forca (shih §§ 61-62 më lart).

162. Paneli thekson se dosja hetimore përfshinë vetëm një DVD dhe një incizim në video nga demonstrata. Megjithatë, në dosje tregohet se kishte së paku tre policë të SHPK-së dhe një numër policësh ndërkombëtarë dhe pjesëtarë të KFOR-it të cilët gjithashtu filmonin ngjarjet. Në dosje tregohet më tutje se "incizimi në video dhe fotografitë e zakonshme (mbi 1.800 fotografi) të demonstratës dhe përleshjes ishin mbledhur dhe analizuar." Asgjë nga ky video material shtesë nuk i është paraqitur Panelit, ndërsa numri i fotografive të zakonshme që i është vënë në dispozicion atij ishte konsiderueshëm më i vogël nga numri i treguar nga prokurori special.

163. Megjithatë, Paneli nuk është në pozitë të verifikojë plotësinë e dosjeve të pranuara të hetimit. Prandaj, Paneli do të vlerësojë bazueshmërinë e ankesave në bazë të dokumenteve që janë në dispozicion (në këtë kuptim shih GJEDNJ, *Tsechoyev kundër Rusisë*, nr. 39358/05, vendimi i gjykatës, 15 mars 2011, § 146).

b. Aplikueshmëria e nenit 2 të Konventës

164. Për sa i përket z. Mon Balajt dhe z. Arben Xheladinit, të cilët të dy vdiqën si rezultat i aksionit të Policisë së UNMIK-ut, ankesa bie në kuadër të fushëveprimit të nenit 2 të KEDNJ-së.

165. Në rastin aktual ngrihet pyetja nëse neni 2 është i aplikueshëm vetëm në lidhje me ankuesit z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj, të cilët iu shmangën vdekjes por u plagosën.

166. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të shprehur në rastin *Makaratziskundër Greqisë*, vendimi i 20 dhjetorit të vitit 2004. Në atë rast, në të cilin forca e përdorur kundër ankuesit nuk ishte vdekjeprurëse, Gjykata vendosi që kjo:

> "nuk e përjashton në parim shqyrtimin e ankesavetë ankuesit sipas nenit 2, teksti i të cilit, i lexuar si i tërë, demonstron se mbulon jo vetëm vrasjen e qëllimshme por gjithashtu situatat ku lejohet përdorimi i forcës që mund të rezultojë, si rezultat i paqëllimshëm, në humbje të jetës ... Në fakt, Gjykata tanimë ka shqyrtuar ankesat sipas kësaj dispozite ku viktima e cekur nuk kishte vdekur si rezultat i sjelljes kundërshtuese. Në lidhje me këtë, mund të shihet, në njërën anë, se Gjykata tanimë ka pranuar se mund të ketë një obligim pozitiv mbi Shtetin sipas fjalisë së parë të nenit 2 § 1 për të mbrojtur jetën e individit nga palët e treta apo nga rreziku i sëmundjes që rrezikon jetën …. Në anën tjetër, praktika gjyqësore vërteton se ndodh vetëm në rrethana të veçanta që keqtrajtimi fizik nga agjentët e shtetit, i cili nuk rezulton me vdekje mund të zbulojë një shkelje të nenit 2 të Konventës. Është e saktë që në procedurat e parashtruara sipas Konventës përgjegjësia penale e atyre që janë të përfshirë në përdorimin e forcës kundërshtuese nuk është çështje për tu biseduar. Megjithatë, shkalla dhe lloji i forcës të përdorur dhe synimi apo qëllimi pas përdorimit të forcës, në mes faktorëve të tjerë, mund të jenë relevantë në vlerësimin, nëse në

> një rast të caktuar veprimet e agjentëve të shtetit në shkaktimin e lëndimit por jo vdekjes janë të tilla që të sjellin faktet në kuadër të qëllimit të mbrojtjes të lejuar me nenin 2 të Konventës, duke pasur parasysh objektin dhe qëllimin e ndjekur nga ai nen" (GJEDNJ, *Makaratzis kundër Greqisë* [DHL], nr. 50385/99, vendimi i 20 dhjetorit të vitit 2004, §§ 49 - 50, KEDNJ 2004-XI).

167. Në vendimin *EvrimÖktem kundër Turqisë* të 4 nëntorit të vitit 2008, lidhur me një plagë serioze të shkaktuar nga një plumb i shtënë rastësishëm nga arma e një polici gjatë operacionit për të ndërprerë një demonstratë, Gjykata rikujton se ku agjentët e shtetit janë të përfshirë në plagosjen e ankuesit, duhet përcaktuar nëse forca e përdorur kundër tij ishte potencialisht vdekjeprurëse dhe çfarë ndikimi kishte pasur sjellja e policëve të përfshirë, jo vetëm në integritetin e tij fizik por gjithashtu në interesimin që të synohet mbrojta e së drejtës në jetë (shih GJEDNJ, *EvrimÖktem kundër Turqisë*, nr. 9207/03, vendimi i 4 nëntorit të vitit 2008, § 40).

168. Ngjashëm, në vendimin *Trévalec kundër Belgjikës* të 14 qershorit të vitit 2011, Gjykata konsideroi se, "në dritë të rëndësisë së mbrojtjes të ofruar me nenin 2, [a]jo duhet kushtuar humbjes së jetëve shqyrtimin më të kujdesshëm, duke marrë në konsideratë jo vetëm veprimet e agjentëve të shtetit, por gjithashtu të gjitha rrethanat e ndërlidhura, duke përfshirë çështjet e tilla sikur planifikimi dhe kontrolli i aksioneve nën shqyrtim (…). Kjo gjithashtu vlen ku nuk është humbur asnjë jetë në rastin ku, si në këtë, Gjykata gjeti se forca e përdorur nga zyrtarët për zbatimin e ligjit kundër një personi e vuri jetën e tij apo saj në rrezik." (shih GJEDNJ, *Trévalec kundër Belgjikës*, nr. 30812/07, vendimi i 14 qershorit të vitit 2011, § 74).

169. Paneli thekson se që të jetë i aplikueshëm neni 2, plagosja duhet të ndodhë në një situatë kërcënimi me jetë. Në lidhje me këtë, Paneli konstaton se e ka provuar se plumbat e gomës, megjithëse jo vdekjeprurës sipas dizajnit të tyre, mund të paraqesin rrezik serioz për jetë, për shembull kur ata përdoren në distancë të afërt, të shtënë drejtpërdrejt drejt shënjestrës apo janë të vjetruar. Paneli rikujton se në këtë rast ishte e pakontestueshme se plumbat ishin përtej datës së tyre të skadimit, ndërsa mundësia që plumbat të jenë shtënë në hapësirë të afërt drejtpërdrejt në drejtim të viktimave nuk është përjashtuar.

170. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, ky rast qartas ka të bëjë me një përgjigje potencialisht të rrezikshme për jetën nga autoritetet gjatë operacionit për kontroll të turmës që kishte për qëllim mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe e cila rezultoi me vdekje dhe plagosje. Prandaj, është mendim i Panelit se kjo situatë lidhur me plagët serioze të shkaktuara z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj mbulohet plotësisht me nenin 2 të KEDNJ-së, i cili është i aplikueshëm në rastin aktual (shih gjithashtu GJEDNJ, *SašoGorgiev kundër "ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*", nr. 49382/06, vendimi i 19 prillit të vitit 2012, § 38; GJEDNJ, *Kitanovski kundër "ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*", nr. 15191/12, vendimi i 22 janarit të vitit 2015, § 57).

c. Shkelja e pretenduar e obligimit esencial sipas nenit 2

i. Parimet e përgjithshme

171. Obligimet esenciale sipas nenit 2 të KEDNJ-së janë gjetur ngjashëm në obligimet paralele sipas nenit 3 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

172. Siç ka përsëritur Komiteti për të Drejtat e Njeriut i OKB-së (KDNJ) në *Komentin e vet të përgjithshëm nr. 6*, "E drejta në jetë e shpallur në nenin 6 të Konventës është trajtuar në të gjitha raportet e shtetit. Është e drejtë supreme nga e cila nuk lejohet asnjë shmangie madje edhe në kohën e emergjencave publike të cilat kërcënojnë jetën e kombit (neni 4). Megjithatë, Komiteti ka theksuar se shpeshherë informata e ofruar në lidhje me nenin 6 ishte e kufizuar vetëm në njërin apo tjetrin aspekt të kësaj të drejte. Është një e drejtë e cila nuk duhet interpretuar ngushtë" (KDNJ, Komenti i Përgjithshëm nr. 6: neni 6 (E drejta në jetë), Sesioni i 16-të, i miratuar më 30 prill 1982, § 1, Dok. i OKB-së HRI/GEN/1/Rev.9 (Vëll. I), f. 176).

173. KDNJ ka theksuar se privimi nga jeta nga autoritetet e shtetit është një çështje e seriozitetit më të madh. Prandaj, palët shtetërore duhet të marrin masa jo vetëm të parandalojnë dhe dënojnë privimin nga jeta nga aktet kriminale, por gjithashtu të parandalojnë vrasjen arbitrare nga vetë forcat e tyre të sigurisë (shih ibid., në § 3; shih gjithashtu KDNJ, *Baboeram dhe të tjerët kundër Surinamit*, komunikatat nr. 146/1983 dhe 148-154/1983, 4 prill 1985, § 14.3). Përdorimi i armëve të zjarrit nga policia duhet të rregullohet nga afër me qëllim të parandalimit të shkeljeve të së drejtës në jetë dhe siguri personale. Është për t'u theksuar se forca policore rumune është njoftuar paraprakisht në mënyrë specifike nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut në lidhje me këtë (shih KDNJ, *Observime përfundimtare mbi Rumaninë* (1998), KDCP/C/79/Add. 97, në § 12).

174. Siç është përsëritur shumë herë nga Gjykata Evropiane, neni 2 radhitet si njëra nga dispozitat më fundamentale në Konventë. Së bashku me nenin 3, ai gjithashtu ruan njërën nga vlerat themelore të shoqërive demokratike që e përbëjnë Këshillin e Evropës. Synimi dhe qëllimi i Konventës si një instrument për mbrojtjen e qenieve individuale njerëzore është që neni 2 të interpretohet dhe zbatohet ashtu që t'i bëjë masat e veta mbrojtëse praktike dhe efektive (shih GJEDNJ, *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 27 shtatorit të vitit 1995, §§ 146-147, seria A nr. 324; GJEDNJ, *Perevedentsevy kundër Rusisë*, nr. 39583/05, vendimi i 24 prillit të vitit 2014, § 90).

175. Përjashtimet e paraqitura në paragrafin 2 të nenit 2 tregojnë se ai shtrihet, por nuk ka të bëjë ekskluzivisht, te vrasja e qëllimshme. Teksti i nenit 2, i lexuar si i tërë, paraqet se paragrafi 2 nuk përcakton në radhë të parë rastet ku lejohet të vritet qëllimshëm një person, por përshkruan situatat ku lejohet "përdorimi i forcës" e cila mund të rezultojë, si rezultat i paqëllimshëm, me humbjen e jetës. Përdorimi i forcës, megjithatë, duhet të jetë më shumë se "absolutisht i nevojshëm" për arritjen e njërit nga qëllimet e përcaktuara në nënparagrafët (a), (b) apo (c) (shih GJEDNJ, *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 174 më lart, në § 148, dhe GJEDNJ, *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë* [DHL], nr. 23458/02, vendimi i 24 majit të vitit 2011, § 175).

176. Sipas mendimit të Gjykatës Evropiane, termi "absolutisht i nevojshëm" përdoret për të treguar se një kriter më i rreptë dhe më detyrues duhet përdorur, sesa ai që aplikohet normalisht kur përcaktohet nëse veprimi i shtetit është "i nevojshëm në një shoqëri demokratike" sipas paragrafëve 2 të nenit 8 deri 11 të Konventës. Në veçanti, forca e përdorur duhet të jetë qartas proporcionale me arritjen e qëllimeve të përcaktuara në nënparagrafët 2 (a), (b) dhe (c) të nenit 2.

177. Përveç kësaj, pranohet se humbjet e jetëve duhet të jenë subjekt i shqyrtimit më të kujdesshëm, veçanërisht ku përdoret forca vdekjeprurëse. Duke nënvizuar se neni 2 "jo vetëm që mbron të drejtën në jetë por gjithashtu përcakton rrethanat kur privimi nga jetamund të justifikohet", Gjykata ka theksuar se duhet konsideruar jo vetëm aksionet e agjentëve të shtetit, të cilët aktualisht administruan forcën por gjithashtu edhe rrethanat e ndërlidhura, "duke përfshirë çështjet e tilla sikur planifikimi dhe kontrolli i aksioneve nën shqyrtim", (shih GJEDNJ [DHL], *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, përmendur në § 175 më lart, në § 176, dhe GJEDNJ, *McCann dhe të tjerët*, përmendur në § 174 më lart, në §§ 147 - 150).

178. Kur forca vdekjeprurëse përdoret nga autoritetet (në kuadër të një "operacioni policor"), sipas mendimit të Gjykatës Evropiane është e vështirë të ndahen obligimet negative të shtetit sipas Konventës nga obligimet e veta pozitive. Duke vlerësuar një situatë të tillë, duhet shqyrtuar nëse operacioni i policisë është planifikuar dhe kontrolluar nga autoritetet ashtu që të minimizojë, në nivelin më të madh të mundshëm, mbështetjen në forcë vdekjeprurëse dhe humbje njerëzore dhe nëse janë marrë masat e mundshme paraprake në zgjedhjen e mënyrave dhe metodave të një operacioni policor (shih p.sh. GJEDNJ, *Finogenov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 18299/03 dhe 27311/03, vendimi i 20 dhjetorit të vitit 2011, § 208).

179. Gjykata Evropiane është veçanërisht vigjilente në rastet ku pretendohen shkelje të nenit 2 të Konventës. Kur ka pasur procedura penale në gjykatat vendore lidhur me pretendimet e tilla, ajo sjell ndërmend se përgjegjësia individuale penale është e dallueshme nga përgjegjësia e shtetit sipas Konventës. Në lidhje me këtë, Gjykata ka theksuar se kompetenca e saj kufizohet vetëm tek i dyti: "Përgjegjësia sipas Konventës bazohet në dispozitat e saj, të cilat duhet interpretuar në dritë të synimit dhe qëllimit të Konventës, duke marrë parasysh rregullat relevante apo parimet e së drejtës ndërkombëtare. Përgjegjësia e një shteti sipas Konventës, që del nga aktet e organeve të tij, agjentëve apo shërbyesve, nuk duhet ngatërruar me çështjet ligjore vendore të përgjegjësisë individuale penale nën shqyrtim në gjykatat nacionale penale. Gjykata nuk është e interesuar të arrijë te ndonjë përfundim për sa i përket fajësisë apo pafajësisë në atë kuptim" (shih GJEDNJ, *Tanli kundër Turqisë*, nr. 26129/95, vendimi i 10 prillit të vitit 2001, § 111, KEDNJ 2001-III, dhe GJEDNJ [DHL], *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, përmendur në § 175 më lart, në § 182). Kompetenca e Panelit është gjithashtu e kufizuar në vlerësimin e përgjegjësisë së UNMIK-ut sipas instrumenteve të lartpërmendura për të drejtat e njeriut.

ii. Pajtueshmëria me obligimin esencial sipas nenit 2

180. Duke iu kthyer veçorive të këtij rasti, Paneli së pari thekson se as ankuesit e as UNMIK-u nuk i kontestojnë konkluzionet e prokurorit special se përdorimi i plumbave të gomës nuk ishte i arsyeshëm dhe se vdekjet e z. Mon Balajt dhe z. Arben Xheladinit, si dhe plagosja e z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj, ishin të panevojshme dhe të shmangshme (shih § 91 "A" më lart).

181. Në veçanti, në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 2 të KEDNJ-së, PSSP-ja informoi Panelin se ai "mori shënime" për pretendimet dhe e referoi Panelin te konkluzionet e prokurorit special të paraqitura në

raportet e tij mbi çështjen, të cilat UNMIK-u i pranoi plotësisht, dhe të cilat duhet marrë parasysh në vend të përgjigjes së tij (shih § 144 më lart).

182. Përveç kësaj, në vlerësimin e dëshmisë, Gjykata Evropiane për të Drejta e Njeriut ka miratuar standardin e dëshmisë "përtej dyshimit të arsyeshëm"; megjithatë ky standard nuk duhet të zbatohet në mënyrë strikte. Sipas praktikës së saj të provuar gjyqësore, dëshmia mund të pasojë nga koekzistenca e konkluzioneve mjaftueshëm të forta, të qarta dhe të pajtueshme apo nga mundësi të pakundërshtueshme për fakte të ngjashme (GJEDNJ [DHL], *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, vendimi i 6 korrikut të vitit 2005, § 147; GJEDNJ, *Finogenov dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur në 178 më lart, në § 199; GJEDNJ [DHL], *El-Masri kundër "ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*", vendimi i 13 dhjetorit të vitit 2012, §§ 151 dhe çfarë vijon; GJEDNJ, *Al Nashiri kundër Polonisë*, vendimi i 24 korrikut të vitit 2014, §§ 394 dhe çfarë vijon). Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjithashtu ka theksuar vështirësitë për ankuesit të marrin dëshminë e nevojshme në mbështetje të pretendimeve në rastet ku shteti i paditur posedon dokumentacion relevant dhe dështon ta dorëzojë atë. Ku ankuesi paraqet një rast prima facie, i takon shtetit të argumentojë përfundimisht pse dokumentet në fjalë nuk mund të vërtetojnë pretendimet e bëra nga ankuesit, apo të ofrojë një sqarim të kënaqshëm dhe bindës se si kanë ndodhur ngjarjet në fjalë. Kështu pesha e dëshmisë është bartur te shteti dhe nëse ai dështon në argumentet e veta, atëherë dalin çështje sipas nenit 2 (shih GJEDNJ, *Toğcu kundër Turqisë*, nr. 27601/95, vendimi i 31 majit të vitit 2005, § 95; GJEDNJ, *Musayev dhe të tjerët kundër Rusisë*, vendimi i 26 korrikut të vitit 2007, § 144).

183. Në këto rrethana, Paneli nuk sheh baza të dyshojë në të gjeturat dhe konkluzionet e prokurorit special. Për më tepër, në mungesë të ndonjë indikacioni për parregullsi apo gabime në raportet e tij, Paneli nuk gjen asnjë arsye për të rivlerësuar dëshminë e mbledhur dhe konkluzionet e prokurorit special.

184. Në këtë rast, konkluzionet e prokurorit special, që nuk janë kontestuar nga palët dhe janë pranuar nga Paneli, konfirmojnë se asnjëra nga kërkesat e nenit 2 në lidhje me privimin legjitim nga jeta nuk duket të jenë plotësuar në këtë situatë në terren në Prishtinë më 10 shkurt 2007, kur në viktimat ishte shtënë nga Policia e UNMIK-ut gjatë demonstratës.

185. Në pajtim me nenin 2 (2) të KEDNJ-së, privimi nga jeta është legjitim vetëm kur kjo rezulton nga përdorimi i forcës në situatat kur është absolutisht e nevojshme, me qëllim që të mbrohet një person nga dhuna e paligjshme, të kryhet një arrestim apo të parandalohet ikja e një të arrestuari apo për të shtypur një trazirë apo rebelim. Asnjëri nga këto raste nuk është në situatën në fjalë.

186. Kur gjykohet nëse aksionet e shtetit mund të arsyetohen sipas nenit 2 (2), rrethanat i nënshtrohen shqyrtimit më të kujdesshëm publik, ekzaminimit të detajeve të tilla sikur korniza ligjore apo rregulluese në vend dhe çështja nëse operacioni ishte planifikuar dhe kontrolluar ashtu që të minimizojë rrezikun për jetë (shih GJEDNJ, *Isayeva, Yusupova dhe Bazayeva kundër Rusisë*, nr. 57947/00, 57948/00 dhe 57949/00, vendimi i 24 shkurtit të vitit 2005, § 171; GJEDNJ, *McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 174 më lart, në § 194; GJEDNJ, *Bubbins kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 50196/99, vendimi i 17 marsit të vitit 2005, § 136; GJEDNJ, *Ergi kundër Turqisë*, nr. 23818/94, vendimi i 28 korrikut të vitit 1998, § 79). Shqyrtimi duhet të jetë akoma më i rreptë ku organet e shtetit përdorin forcën për të shtypur trazirën e cila "mund të pritej" (shih GJEDNJ, *Güleç kundër Turqisë*, nr. 21593/93, vendimi i 27 korrikut të vitit 1998, § 71,

Raportet 1998-IV). Duhet marrë të gjitha masat paraprake të mundshme për të shmangur apo minimizuar humbjen incidentale të jetës civile (shih GJEDNJ, *Ergi kundër Turqisë*, përmendur më lart).

187. Korniza rregulluese kërkon një numër masash mbrojtëse, të cilat duhet të jenë në vend për të parandaluar përdorimin e tepërt të forcës dhe humbjen e jetës. Në këtë rast, një numër masash të tilla mbrojtëse duket të kenë ekzistuar në parim, sikur trajnimi i policisë për operacione kundër trazirave, veçanërisht mbi standardet për përdorimin e forcës dhe përdorimin e pajisjeve speciale, të paraqitura në procedurat standarde të Policisë së UNMIK-ut dhe rregullat për angazhim, sistemin e kontrollit për armët dhe municionin të përdorur nga policia, planifikimin paraprak, njoftimet për opinion, etj. Megjithatë, ky obligim nuk plotësohet thjesht me hartimin e një kornize adekuate të masave mbrojtëse, por vetëm kur bëhet një sistem i bashkërenduar si duhet dhe funksional (krahasoje me PKDNJ, *Stojkoviq*, nr. 87/09, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2013, § 164).

188. Nuk është kontestuar në këtë rast të veçantë se Policia e UNMIK-ut përdori forcë të tepërt për të shpërndarë demonstratën, dështoi të ushtrojë kontroll të duhur për municionin dhe gjithashtu dështoi të sigurojë që policët të jenë të trajnuar në mënyrë adekuate dhe të kenë marrë urdhra të qarta. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, tërësia e këtyre dështimeve përbëjnë një shkelje të nenit 2.

189. Në veçanti, Paneli thekson se nuk ka pasur të kuptuar të qartë për sa i përket asaj se kush ishte në komandë të përgjithshme të operacionit dhe, për shembull, shumë policë theksuan se komisari i Policisë së UNMIK-ut vetë i kontribuoi konfuzionit. Po ashtu, mungesa e zinxhirit të qartë komandues dhe mjetet e pamjaftueshme të komunikimit e bënë më të vështirë të merren informatat e azhurnuara me kohë mbi situatën në terren dhe t'u ofrohet udhëzim adekuat njësiteve që ishin të angazhuara me protestuesit.

190. Duke pasur parasysh krejt që u tha më lart, Paneli konstaton se në rrethanat e këtij rasti forca e përdorur për të shpërndarë demonstruesit, e cila shkaktoi vdekjen e z. Mon Balajt dhe z. Arben Xheladinit dhe plagosjen e z. Zenel Zenelit dhe z. Mustafë Nerjovajt, nuk ishte absolutisht e nevojshme në kuadër të kuptimit të nenit 2(2) të KEDNJ-së. Prandaj, Paneli konsideron se ka pasur shkelje të obligimit esencial të nenit 2 të KEDNJ-së.

d. Shkelja e pretenduar e obligimit procedural sipas nenit 2

i. Parimet e përgjithshme

191. Paneli rikujton se Gjykata Evropiane ka përsëritur në një numër rastesh se neni 2 përmban një obligim pozitiv të një karakteri procedural. "Obligimi për të mbrojtur të drejtën në jetë sipas kësaj dispozite, shpallur në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit sipas nenit 1 të Konventës për t'i "siguruar secilit brenda juridiksionit të vet të drejtat dhe liritë e përcaktuara në [K]onventë", kërkon shprehimisht që duhet të ketë disa forma të hetimit zyrtar efektiv kur individët janë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës nga, interalia, agjentët e shtetit" (shih GJEDNJ, *McCann dhe të tjerët*, përmendur në § 174 më lart, në § 161; GJEDNJ, Kaya kundër Turqisë nr. 22729/93, vendimi i 19 shkurtit të vitit 1998, § 105, Raportet 1998-I; GJEDNJ [DHL], *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, përmendur në § 175 më lart, në § 298 – 306; GJEDNJ, *Myhailova dhe Malinova kundër Bullgarisë*, nr. 36613/08, vendimi i 24 shkurtit të vitit 2015, § 60).

192. Në kohën e njëjtë, Gjykata konsideron se jo çdo hetim duhet të jetë domosdoshmërisht i suksesshëm dhe as të vijë te një përfundim që përputhet me rrëfimin e paditësit për ngjarjen; megjithatë, ai në parim duhet të jetë në gjendje të çojë kah vërtetimi i fakteve për rastin dhe, nëse pretendimet dëshmohet të jenë të vërteta, kah identifikimi dhe, mundësisht, dënimi i atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ, *Mahmut Kaya kundër Turqisë*, nr. 22535/93, vendimi i 28 marsit të vitit 2000, § 124, GJEDNJ 2000-III; shih gjithashtu GJEDNJ, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, vendimi i 14 marsit të vitit 2002, § 71, KEDNJ 2002-II).

193. Duke vendosur standardet për një hetim efektiv, gjykata ka shpallur që përveç të qenit i pavarur, i qasshëm për familjen e viktimës me gatishmërinë dhe saktësinë, dhënies së elementit të mjaftueshëm për shqyrtim publik të hetimit dhe rezultateve të tij, hetimi duhet gjithashtu të jetë efektiv në kuptimin që të jetë në gjendje të shpie në përcaktimin nëse vdekja është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe nëse po, kah identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90 dhe të tjerët, vendimi i 18 shtatorit të vitit 2009, § 191; GJEDNJ [DHL], *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, përmendur në § 175 më lart, në § 301; GJEDNJ [DHL], *Jaloud kundër Holandës*, nr. 47708/08, vendimi i 20 nëntorit të vitit 2014, § 200; shih gjithashtu GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, nr. 4704/04, vendimi i 15 shkurtit të vitit 2011, § 63). Ky nuk është vetëm një obligim për arritjen e rezultateve, por edhe për përdorimin mjeteve të duhura. Autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapash të arsyeshëm që munden për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin, duke përfshirë ndër të tjera dëshmitë e dëshmitarit okular, dëshmitë e mjekësisë ligjore dhe, ku është e nevojshme, një autopsi e cila siguron të dhëna të plota dhe të sakta për lëndimin dhe një analizë objektive të të gjeturave klinike, duke përfshirë shkaktarin e vdekjes. Çdo e metë në hetim e cila rrezikon aftësinë për të vërtetuar shkaktarin e vdekjes apo plagosjes apo identitetin e personit apo personave përgjegjës, do të rrezikojë të jetë si parregullsi sa i përket këtij standardi (shih GJEDNJ, *AhmetÖzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 21689/93, vendimi i 6 prillit të vitit 2004, § 312; GJEDNJ *Isayeva kundër Rusis*ë, nr. 57950/00, vendimi i 24 shkurtit të vitit 2005, § 212; GJEDNJ, nr. 52404/08, *UzeyirJafarov kundër Azerbajxhanit*, vendimi i 29 janarit të vitit 2015, § 46).

194. Në veçanti, përfundimi i hetimit duhet të bazohet në analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve relevante. Mosndjekja e një piste të qartë të hetimit rrezikon deri në shkallë vendimtare aftësinë për t'i vërtetuar rrethanat e rastit dhe identitetin e atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ, *Kolevi kundër Bullgarisë*, nr. 1108/02, vendimi i 5 nëntorit të vitit 2009, § 201). Megjithatë, natyra dhe shkalla e shqyrtimit, të cilat plotësojnë pragun minimal të efektivitetit të hetimit, varen nga rrethanat e rastit të veçantë. Ato duhen vlerësuar në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore (shih GJEDNJ, *Velcea dhe Mazăre kundër Rumanisë*, nr. 64301/01, vendimi i gjykatës, 1 dhjetor 2009, § 105). Në të njëjtën kohë, autoritetet duhet gjithmonë të bëjnë përpjekje serioze për të zbuluar se çfarë ka ndodhur dhe nuk duhet të mbështeten në konkluzione të nxituara apo të pabazuara për të mbyllur hetimin e tyre (shih GJEDNJ [DHL], *El-Masri kundër "ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*", përmendur në §182 më lart, në § 183; GJEDNJ [DHL], *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, vendimi i 17 shtatorit të vitit 2014, § 322). Ata duhet të marrin të gjithë hapat e arsyeshëm në dispozicion të tyre për të siguruar dëshmi.

195. Një kërkesë për shpejtësi dhe ekspeditivitet të arsyeshëm nënkuptohet në këtë kontekst. Madje edhe ku mund të ketë pengesa apo vështirësi të cilat pengojnë progresin në një hetim në një situatë të veçantë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet është jetike për ruajtjen e besimit publik për zbatimin e sundimit të ligjit nga ana e tyre dhe për parandalimin e çdo forme të ndonjë marrëveshje të fshehtë apo tolerance për aktet e paligjshme (shih GJEDNJ, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në §192 më lart, në § 72, GJEDNJ [DHL], *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, përmendur në § 194 më lart, në § 323).

196. Sa i përket kërkesës për shqyrtim publik, gjykata ka shpallur më tutje që duhet të ketë elemente të mjaftueshme të shqyrtimit publik të hetimit apo rezultateve të tij për të siguruar përgjegjësi në praktikë dhe në teori. Shkalla e shqyrtimit të kërkuar publik mundet të ndryshojë mjaft nga rasti në rast. Në të gjitha rastet, megjithatë, i afërmi i viktimës duhet të jetë i përfshirë në procedurë deri në shkallën që mbron interesat e tij legjitime (shih, *AhmetÖzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 193 më lart, në §§ 311 314; GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, përmendur në § 193 më lart, në §§ 211-214 dhe rastet e përmendura aty; GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i gjykatës nr. 55721/07, 7 korrik 2011, § 167, KEDNJ 2011; GJEDNJ [DHL], *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, përmendur në § 194 më lart, në § 324).

197. Gjykata gjithashtu ka theksuar rëndësinë e madhe të hetimit efektiv për gjetjen e së vërtetës se çfarë ka ndodhur, jo vetëm për familjet e viktimave por gjithashtu edhe për viktimat e tjera të krimeve të ngjashme, dhe gjithashtu publikun e gjerë, të cilët kanë të drejtë të dinë se çfarë ka ndodhur (GJEDNJ [DHL], *El-Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, përmendur në § 182 më lart, në § 191; GJEDNJ, *AlNashiri kundër Polonisë* nr. 28761/11, vendimi i gjykatës, 24 korrik 2014, §§ 495-496). Organet e Kombeve të Bashkuara gjithashtu pranojnë rëndësinë e së drejtës për të ditur të vërtetën. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, "e drejta për ta ditur të vërtetën nënkupton njohurinë e tërë dhe të plotë rreth shkeljeve dhe ngjarjeve që kanë ndodhur, rrethanat e tyre specifike dhe kush mori pjesë në to. Në rastin e personave të zhdukur … ajo gjithashtu nënkupton të drejtën për të ditur për fatin dhe vendndodhjen e viktimës" (shih Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Personat e zhdukur, Dokument i OKB-së A/67/267, 8 gusht 2012, § 5). Paneli beson se e drejta për të ditur të vërtetën ngjashëm vlen në situatën sikur situate aktuale.

198. Para vlerësimit të këtij rasti të veçantë, Paneli rikujton jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, që tanimë ka konsideruar se ndalimi i përgjithshëm ligjor i vrasjes arbitrare nga shteti i vënë në nenin 2 do të ishte joefektiv, në praktikë, po të mos ekzistonin procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të forcës nga autoritetet e shtetit (shih GJEDNJ, *Güleç kundër Turqisë*, përmendur në § 186 më lart, në § 77). Gjykata gjithashtu ka konsideruar se mbrojtja procedurale për të drejtën në jetë nënkupton që veprimet e shtetit duhet t'u nënshtrohen një forme të shqyrtimit të pavarur dhe publik që është në gjendje të përcaktojë nëse forca e përdorur ishte apo nuk ishte e arsyeshme në rrethana të veçanta (ibid., § 78).

199. Gjykata gjithashtu ka vendosur se obligimi sipas nenit 2 për të mbrojtur jetën detyron që, madje në kushte të vështira sigurie, të gjitha hapat e arsyeshëm duhet të ndërmerren për të siguruar se kryhet një hetim efektiv, i pavarur për shkeljet e pretenduara të së drejtës në jetë (shih, mes shembujve tjerë: GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 196 më lart, në § 164; GJEDNJ, *Güleç kundër*

Turqisë, përmendur në § 186 më lart, në § 81; GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, përmendur në § 193 më lart, në §§ 180 dhe 210; GJEDNJ; GJEDNJ [DHL], *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, përmendur në § 194 më lart, në § 319).

ii. Pajtueshmëria me obligimin procedural sipas nenit 2

200. Në përmbledhje, Paneli rikujton që në mënyrë që të jenë efektive, veprimet hetimore duhet të kryhen shpejt dhe në mënyrë ekspeditive, nga një organ me nivel të nevojshëm të pavarësisë, duke ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm dhe ndjekur pista të qarta të hetimit për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin, duke përfshirë, *inter alia* dëshminë e dëshmitarit okular, dëshminë e mjekësisë ligjore, etj. Hetimi gjithashtu duhet të sigurojë element të arsyeshëm të shqyrtimit publik dhe të jetë arsyeshëm i qasshëm për palët e dëmtuara. Përfundimi i hetimit duhet të bazohet në analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve relevante. Përveç kësaj, hetimi duhet të shqyrtohet periodikisht me qëllim që të sigurohet se të gjitha informatat në dispozicion janë marrë parasysh (shih §§ 193-196 më lart).

Shpejtësia e hetimit

201. Për sa i përket shpejtësisë së veprimit hetimor të Policisë së UNMIK-ut dhe prokurorit special, Paneli së pari rithekson se "është vendimtare në rastet e vdekjeve në situata të diskutueshme që hetimi të jetë i shpejtë. Kalimi i kohës do të humb paevitueshëm sasinë dhe cilësinë e dëshmisë në dispozicion dhe shfaqja e mungesës së kujdesit do të hedhë dyshim në qëllimin e mirë të përpjekjeve hetimore, dhe gjithashtu do ta zgjasë përvojën e hidhur të anëtarëve të familjes" (GJEDNJ, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 192 më lart, në § 86; GJEDNJ, *Perevedentsevy kundër Rusisë*, përmendur në § 174 më lart, në § 108).

202. Duke iu kthyer rrethanave të këtij rasti, Paneli thekson se hetimi është filluar menjëherë, ekzaminimi i vendit të krimit është bërë brenda orësh pas demonstratës dhe iniciativat e tjera relevante janë ndërmarrë më 10 shkurt 2007 (shih §§ 63-67 më lart). Një numër i veprimeve të rëndësishme për të gjetur dhe siguruar dëshmi, duke përfshirë autopsitë e viktimave të vdekur, janë kryer më 11 shkurt 2007 (shih §§ 68-73 më lart). Përveç kësaj, Task Forca speciale hetimore u formua më 12 shkurt 2007 dhe më 14 shkurt 2007 PSSP-ja emëroi prokurorin special të udhëheqë këtë hetim (shih §§ 74 dhe 78 më lart). Të gjeturat e hetimit u komunikuan në dy raportet e prokurorit special të 16 prillit të vitit 2007 dhe 29 qershorit të vitit 2007 (shih § 89 më lart). Këto raporte u bazuan në Raportin e përkohshëm mbi hetimet (13 mars 2007) dhe në Raportin e parë (16 prill 2007) dhe të dytë (11 qershor 2007) të Task Forcës (shih § 88 më lart).

203. Në fund, Paneli thekson se marrjet në pyetje të policëve të NJFP-së të cilët morën pjesë në operacion filluan disa ditë pas ngjarjeve. Policët polakë u morën në pyetje më 13 dhe 14 shkurt, policët rumunë më 15 dhe 16 shkurt dhe policët ukrainas më 20 shkurt 2007 (shih §§ 80 - 81 dhe 83 më lart). Sipas mendimit të Panelit, një interval i tillë kohor ka mundur t'u japë policëve mundësi të mjaftueshme për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe për të siguruar se asnjë informatë në lidhje me përdorimin e plumbave të gomës nuk u ishte dhënë hetuesve dhe kështu të shtrembërohet e vërteta, nëse ata e kanë menduar ta bëjnë këtë. Për më tepër, duket se nuk është marrë asnjë masë paraprake për ta parandaluar këtë që të ndodhë (shih GJEDNJ [DHL], *Jaloud kundër Holandës*,

përmendur në § 193 më lart, në § 207). Në të vërtetë, policët e NJFP-së u kthyen në komplekset e tyre dhe duket se nuk ka pasur asnjë kufizim të vendosur ndaj ndonjërit prej tyre nga komandantët e tyre apo nga autoritetet e UNMIK-ut.

204. Paneli konstaton se aksionet e Policisë së UNMIK-ut dhe prokurorit special në lidhje me hapjen e hetimit dhe kryerjen e veprimeve fillestare hetimore ishin mjaftueshëm të shpejta për t'i përmbushur kërkesat e nenit 2 të KEDNJ-së. Megjithatë, vonesa në marrjen në pyetje të policëve të NJFP-së për të cilën nuk është ofruar asnjë sqarim nga prokurori special në raportet e tij, fakti se nuk janë marrë hapat e duhur për të zvogëluar rrezikun nga një marrëveshje e fshehtë, sipas mendimit të Panelit, përbën një të metë në mjaftueshmërinë e hetimit (shih GJEDNJ [DHL], *Jaloud kundër Holandës*, përmendur në § 193 më lart, në § 208).

Pavarësia e hetimit

205. Lidhur me pavarësinë e hetimit, ankuesit pohojnë se hetimi i kryer nga Task Forca nën mbikëqyrjen e prokurorit special të emëruar nga PSSP-ja nuk ishte i pavarur. Përveç kësaj, ata pohojnë mungesën e pavarësisë në atë se disa policë rumunë të UNMIK-ut morën pjesë në hetim.

206. Në këtë drejtim, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane se në mënyrë që të jetë efektiv një hetim për vrasjen e pretenduar të paligjshme nga agjentët e shtetit, mund të vlerësohet përgjithësisht si e nevojshme që personat përgjegjës për kryerjen e hetimit të jenë të pavarur nga ata të përfshirë në ngjarje. Kjo nënkupton jo vetëm mungesën e lidhjes hierarkike apo institucionale por gjithashtu një pavarësi praktike (shih GJEDNJ, *HughJordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 4 majit të vitit 2001, § 105; GJEDNJ [DHL], *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, përmendur në § 175 më lart, në § 300; GJEDNJ [DHL], *Ramsahai dhe të tjerët kundër Holandës*, nr. 52391/99, vendimi i 15 majit të vitit 2007, § 325, KEDNJ 2007-II).

207. Fakti se hetimi duhet të kryhet "nga një organ i duhur dhe i paanshëm" gjithashtu theksohet në praktikën gjyqësore të KDNJ të OKB-së, veçanërisht në rastet mbi zhdukjet (KDNJ, *JoaquínDavidHerreraRubio dhe të tjerët kundër Kolumbisë*, § 10.3, Komunikata nr. 161/1983, Dok. i OKB-së KDCP/C/OP/2 (1990); KDNJ, *BasilioLaureanoAtachahua kundër Perusë*, § 8.3, Komunikata nr. 540/1993, Dok. i OKB-së KDCP/C/56/D/540/1993 (1996)).

208. Paneli thekson se, në rastin aktual, hetimi fillimisht ishte nisur nga NJRH e Prishtinës me përkrahjen e nevojshme të ofruar nga ZQPP e Prishtinës dhe Gjykata e Qarkut. Të tri institucionet hapën raste, një prokuror publik lokal dhe një gjykatës i procedurës paraprake u caktuan dhe ata kryen një numër të veprimeve në pajtim me dispozitat e LPPPK-së (shih §§ 65-69).

209. Më 11 shkurt 2007, një prokuror ndërkombëtar i UNMIK-ut i kërkoi Policisë së UNMIK-ut t'ua sigurojë të gjitha informatat e mbledhura në lidhje me këtë hetim prokurorëve ndërkombëtarë, duke treguar kështu se hetimi ishte marrë përsipër nga ta. Emërimi i z. Robert L. Dean si prokuror special nga PSSP-ja është shpallur tri ditë më vonë, më 14 shkurt 2007.

210. Siç është përmendur më lart, caktimi i prokurorëve ndërkombëtarë në një hetim të veçantë rregullohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64 (shih § 126 më lart). Prandaj, është dashur të ketë një rekomandim të DD të UNMIK-ut për PSSP-në që t'ia caktojë këtë rast një prokurori ndërkombëtar. Një rekomandim i tillë duhet të ofronte baza për këtë lëvizje, duke sqaruar pse hetimi në vazhdim nuk është konsideruar se arrinte nivelin e mjaftueshëm të "paanësisë së gjyqësisë apo administrimit të duhur të drejtësisë" për të justifikuar caktimin e një prokurori ndërkombëtar.

211. Kjo do të mund të sqaronte pohimin e ankuesve se hetimi nuk ishte i pavarur në dritë të faktit se nuk ishte kryer nga Task Forca nën mbikëqyrjen e prokurorit special.

212. Megjithatë, duke shqyrtuar dosjen hetimore në dispozicion të tij, Panelit konstaton se nuk mund të shoh qartë ndonjë të metë në hetim të prokurorit ndërkombëtar, i cili do të tregonte për një mungesë pavarësie (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ [DHL], *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, vendimi i 6 majit të vitit 2003, § 190, KEDNJ 2003-VI). Prandaj, pa ofrimin e dëshmisë për ndonjë dështim serioz në hetim, ankuesit nuk mund të pohojnë arsyeshëm se ata kanë arsyetuar objektivisht dyshimet rreth pavarësisë së prokurorit special (shih, mutatismutandis, GJEDNJ, *Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 shkurtit të vitit 2002, KEDNJ 2002-I). Në anën tjetër, ankuesit e bazojnë pjesën e parashtresave të tyre në të gjeturat e prokurorit special që Policia e UNMIK-ut dështoi t'i mbrojë jetët e viktimave.

213. Paneli në fund thekson se në pajtim me nenin 62 (2) të KPPPK-së, ankuesit, si palë të dëmtuara, kanë pasur të drejtën të bëjnë ndjekje penale subsidiare. Megjithatë, nuk ka asnjë indikacion se kjo ishte bërë.

214. Një element për shqetësim serioz është pjesëmarrja e policëve rumunë të UNMIK-ut në hetim. Ankuesit argumentojnë se "lidhjet në mes individëve të cilët kryen hetimin dhe atyre që po hetoheshin komprometojnë pavarësinë e hetimit".

215. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se Task Forca për hetim nuk përfshiu zyrtarisht ndonjë polic rumun, e as që prokurori special përmendi pjesëmarrjen e tyre në raportet e tij (shih § 75 më lart). PSSP-ja konfirmoi se asnjë polic i UNMIK-ut i nacionalitetit rumun nuk ishte pjesëtar i Task Forcës por se "hetuesve u duhej t'i shfrytëzojnë përkthyesit rumunë". Megjithatë, PSSP-ja gjithashtu argumenton se "hetimi nga policët e të njëjtit nacionalitet mund të mos sjellë, vetvetiu, te përfundimi se hetimi ishte i anshëm" (shih § 153 më lart).

216. Paneli tanimë ka konstatuar se dosja përmban dëshmi për pjesëmarrjen e policëve rumunë të UNMIK-ut në hetim. Në veçanti, Paneli thekson se, në kundërshtim me parashtresën e PSSP-së, një numër i madh i marrjeve në pyetje të policëve të NJSP polake, rumune dhe ukrainase, të kryera më 13 dhe 14, 15 dhe 16, dhe 20 shkurt 2007, duke përfshirë marrjet në pyetje të atyre policëve rumunë të NJSP-së, të cilët përdorën plumba gome si dhe komandantët e tyre, u bënë nga hetuesit rumunë të Policisë së UNMIK-ut. Megjithatë, duket se fakti i pjesëmarrjes së tyre në hetim nuk është bërë kurrë publik.

217. Paneli mund të pranojë se mund të ketë pasur arsye për pjesëmarrjen e policëve rumunë të Policisë së UNMIK-ut në hetim. Në të vërtetë, menjëherë pas ngjarjeve të 10 shkurtit të vitit 2007, ekzistonte nevoja për t'i marrë në pyetje policët rumunë të NJSP të UNMIK-ut, të cilët nuk flisnin anglisht. Megjithatë, marrjet në pyetje filluan vetëm tri ditë më

vonë, dhe madje jo tëpolicëve rumunë por atyre polakë, ku nuk kishte asnjë arsye për të pasur rumunë në mesin e oficerëve që kryenin hetimin. Prandaj, situata nuk ofroi garanci të mjaftueshme për të përjashtuar ndonjë dyshim legjitim lidhur me pavarësinë dhe paanësinë e hetimit (shih, mutatis mutandis, GJEDHNJ [DHL], *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, përmendur në § 212 më lart, në § 191).

218. Paneli thekson se policët rumunë të NJSP, të cilët së pari u morën në pyetje nga hetuesit rumunë të Policisë së UNMIK-ut, u riintervistuan më vonë nga dy oficerë tjerë të Policisë së UNMIK-ut të nacionaliteteve të ndryshme, me ndihmën e përkthyesve profesionistë nën betim. Megjithatë, pranohet se garancitë për gjykim të drejtë duhet të vlejnë që nga fazat e hershme të procedurave penale, duke pasur parasysh se drejtësia e një gjykimi ka të ngjarë të paragjykohet seriozisht nga një dështim fillestar për të vepruar në pajtim me to (shih GJEDNJ, *Imbrioscia kundër Zvicrës*, nr. 13972/88, vendimi i 24 nëntorit të vitit 1993, § 36, seria A nr. 275). Në këtë rast, sipas mendimit të Panelit, mungesa e pavarësisë dhe paanësisë në marrjet në pyetje në fillim, të cilat kanë pasur mundësi të ndikojnë seriozisht në dëshmi, nuk mund të kompensohen me marrjet pasuese në pyetje.

219. Në fund, për sa i përket hetimit të kryer nga IPK, Paneli thekson se inspektori kryesor i IPK-së u ftua që të "bëjë një përmbledhje të pavarur të hetimeve që ndërlidhen me vdekjet e personave gjatë trazirave të 10 shkurtit të vitit 2007 në Prishtinë" (shih § 101 më lart). Megjithatë, në Raportin mbi hetimin të IPK-së, i datës 1 mars 2007, vetëm "u konstat[ua] dhe vlerës[ua] performanca e atyre oficerëve të lartë të SHPK-së, të cilët ishin përgjegjës për sjelljen e policëve të SHPK-së", të cilët morën pjesë në operacionin policor më 10 shkurt 2007 (shih § 102 më lart).

220. Në raportin e njëjtë, IPK qartësoi se një raport shtesë në lidhje me rezultatet e "përmbledhjes së pavarur mbi hetimet e UNMIK-ut" do të "publikohej pas përfundimit të hetimit të UNMIK-ut". Megjithatë, Paneli nuk ka ndonjë informatë nëse ky raport shtesë ishte publikuar ndonjëherë. Përveç kësaj, Paneli rikujton informatat në dispozicion në dosje që tregonin se raporti i IPK-së, i 1 marsit të vitit 2007, ishte "bashkëhartuar prapa skenës nga OSBE-ja [dhe] para-rregulluar nga [prokurori special]" (shih § 105 më lart). Në dritë të krejt kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se ky informacion nuk mund të konsiderohet një shqyrtim i pavarur i hetimit.

221. Duke marrë parasysh të metat e përmendura më lart, Paneli konstaton se hetimi nuk ofroi garanci të mjaftueshme për pavarësi dhe paanësi, siç përcaktohet me nenin 2 të KEDNJ-së.

Plotësia e hetimit

222. Hetimi vërtetoi se z. MonBalaj u plagos për vdekje derisa po ikte me vrap nga hoteli Iliria, pasi një grup i vogël policësh ndërkombëtarë hyri në hollin e atij hoteli dhe ndiqte protestuesit të cilët ishin fshehur atje. Duke marrë parasysh faktin se z. MonBalaj është qëlluar në pjesën e pasme të kokës dhe në dritë të deklaratave të dy dëshmitarëve okularë, mund të supozohet se ai është qëlluar nga njëri prej këtyre policëve.

223. Hetimi gjithashtu ishte në gjendje të vërtetojë se togu rumun i NJFP-së "Charlie" ishte i pozicionuar më së afërmi hotelit. Megjithatë, hetuesit nuk bënë asnjë përpjekje të ngushtojnë listën e të dyshuarve përmes identifikimit të policëve të cilët hynë në hotel;

me sa duket asnjërit prej policëve të intervistuar nuk u është bërë ndonjë pyetje në lidhje me këtë. Hetuesit nuk ishin në gjendje të marrin në pyetje pjesëtarët e NJSHM-së franceze dhe italiane nën komandën e KFOR-it, të cilat gjithashtu morën pjesë në operacionin kundër trazirës (shih § 86 më lart), pasi komanda e tyre refuzoi të bashkëpunojë. Vetëm pak më shumë se një muaj më vonë, hetuesit morën "raportet zyrtare që oficerët" i kishin marrë nga pjesëtarët e NJSHM-së.

224. Paneli thekson më tutje se kishte një përpjekje të pasuksesshme për t'i identifikuar policët rumunë të NJSP-së të cilët shtinë në viktimat. Megjithatë, dëshmitarëve okularë iu kanë treguar fotografitë në format të kartelës së identifikimit (letërnjoftimit), që paraqisnin vetëm fytyrat e policëve. Paneli nuk gjen asnjë sqarim sa i përket asaj se pse nuk ka pasur paradë të drejtpërdrejtë identifikimi me policët, të cilët ishin të gjithë në Kosovë (shih GJEDNJ, *UzeyirJafarov kundër Azerbajxhanit*, përmendur në § 193 më lart, në § 50).

225. Nuk kontestohet se në mungesë të ndonjë identifikimi të të dyshuarve, dëshmia e mjekësisë ligjore u bë veçanërisht e rëndësishme si një burim i informatave. Sipas mendimit të Panelit, plumbat e nxjerrë nga trupat e viktimave janë ekzaminuar për gjurmë për "rikoshet" pasi policët e NJSP-së pohuan se ata nuk kanë shtënë drejtpërdrejt në protestues. Po ashtu, një ekzaminim kimik i mjekësisë ligjore i rrobave të viktimave, për mbetje baruti në to, mund të tregonte distancën e përafërt nga e cila ishte shtënë në ta. Megjithatë, nuk janë kryer ekzaminime të tilla.

226. Paneli thekson se për sa i përket përdorimit të plumbave të gomës ka dy mundësi: ose pushkatarët i përdorën plumbat e gomës në mënyrë jo të duhur apo ata në fakt i ndoqën të gjitha udhëzimet mbi përdorimin e forcës, por plumbat shkaktuan lëndime shumë më të gjera sepse ata ishin përtej datës së tyre të skadimit. Në këtë situatë pyetja më relevante do të ishte se si ata plumba "vdekjeprurës" gome përfunduan të mbushur në armët e policëve rumunë të NJSP-së.

227. Paneli rikujton se prokurori special pranoi në Raportin e tij se municioni i plumbave të gomës ishte përtej datës së vet të skadimit dhe nuk është dashur të përdoret (shih § 96 më lart). Megjithatë, nuk është kryer asnjë hetim se si ka ndodhur kjo dhe nuk ka pasur asnjë përfundim për sa i përket përgjegjësisë së mundshme individuale penale të atyre, të cilët, përmes mosveprimit të tyre, lejuan që kjo të ndodhë.

228. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Paneli konsideron se hetimi i kryer në këtë rast nuk plotësoi kërkesën për plotësi, siç kërkohet me nenin 2 të KEDNJ-së.

229. Në fund, Paneli rikujton se hetimi për shkelje të mundshme në lidhje me shkeljet administrative dhe standardet e aplikueshme është pjesë e pandarë e obligimit procedural me qëllim të shmangies së mosndëshkueshmërisë (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Khashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë*, vendimi i 24 shkurtit të vitit 2005; GJEDNJ, Okkali kundër Turqisë, vendimi i 17 tetorit të vitit 2006; GJEDNJ, *Ould Dah kundër Francës*, vendimi i 17 marsit të vitit 2009). Ky element bëhet veçanërisht i rëndësishëm në situatën, kur, si në rastin aktual, hetimi nuk ishte në gjendje të vërtetojë përgjegjësinë individuale penale.

230. Në lidhje me këtë, Gjykata Evropiane ka vendosur se "një sistem efektiv gjyqësor, siç kërkohet me nenin 2, mundet, dhe nën rrethana të caktuara duhet, të përfshijë mbështetje

në të drejtën penale. Megjithatë, [dhe veçanërisht] nëse e drejta në jetë apo integritet personal nuk është cenuar qëllimisht, obligimi pozitiv i përcaktuar me nenin 2 për të krijuar një sistem efektiv gjyqësor nuk kërkon domosdoshmërisht dispozitë për një mjet penal-ligjor për secilin rast … Masat disiplinore gjithashtu mund të parashihen" (shih p.sh. GJEDNJ,*Byrzykowski kundër Polonisë*, nr. 11562/05, vendimi i 27 qershorit të vitit 2006, § 105).

231. Prandaj, Paneli shpreh shqetësimin e tij në lidhje me mungesën e informatave për ndonjë procedurë disiplinore kundër atyre që janë përgjegjës për dështime të mëdha administrative dhe organizative (shih § 110 më lart) siç identifikohen nga prokurori special.

232. Me pak fjalë, të metat dhe mangësitë e përshkruara më lart ngritin arsye serioze të dyshohet nëse hetimi ishte në gjendje t'i gjejë ata që ishin përgjegjës dhe t'i sjellë para drejtësisë. Prandaj, Paneli përfundon se UNMIK-u dështoi të kryejë hetim efektiv për vrasjen e z. Mon Balaj dhe z. Arben Xheladini dhe plagosjen e rëndë të z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj. Prandaj, ka pasur një shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, obligimi procedural.

D. Shkelja e pretenduar e neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së

233. Duke pasur parasysh se ankuesit ankohen sipas nenit 6 dhe nenit 13 të KEDNJ-së, se ata nuk kishin në dispozicion asnjë mjet juridik pasi raportet e prokurorit special nuk çuan tek identifikimi dhe ndjekja penale e atyre që janë përgjegjës për vrasjen e z. MonBalaj dhe z. Arben Xheladini dhe plagosjen e z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj, Paneli, në dritë të të gjeturave të tij lidhur me ankesën sipas nenit 2, aspekti procedural i KEDNJ-së, e konsideron si të panevojshme të shqyrtojë ndaras këtë pjesë të ankesës.

234. Duke pasur parasysh se ankuesit ankohen sipas nenit 6 dhe 13, se ata nuk kanë pasur ndonjë mjet tjetër për dëmshpërblim për sa i përket vrasjes së z. MonBalajt dhe z. Arben Xheladinit dhe plagosjes së Zenel Zenelit dhe Mustafë Nerjovajt, Paneli, pasi ka marrë në konsideratë se ankuesit e kanë shfrytëzuar vetë procesin për ankesa nga pala e tretë të OKB-së dhe në dritë të rezultatit të këtij procesi, e konsideron gjithashtu si të panevojshme të shqyrtojë ndaras këtë pjesë të ankesës.

E. Shkelja e pretenduar e nenit 11 të KEDNJ-së

235. Ankuesit ankohen se refuzimi i autoriteteve të UNMIK-ut për të lejuar që demonstrata e 10 shkurtit të vitit 2007 të vazhdojë siç ishte planifikuar dhe shpërndarja e dhunshme e demonstratës, që rezultoi me vdekjet e dy protestuesve dhe plagosjen e një numri të tjerëve, duke përfshirë dy nga ankuesit, shkeli të drejtën e tyre për tubim paqësor, të garantuar me nenin 11 të KEDNJ-së.

236. Në nenin 11 thuhet si në vijim:

> "1. Secili ka të drejtën e lirisë për tubim paqësor dhe lirisë për t'u bashkuar me të tjerët, duke përfshirë të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave për mbrojtjen e interesit të tij.

2. Nuk vendoset asnjë kufizim në ushtrimin e këtyre të drejtave përveç atyre që janë përcaktuar me ligj dhe janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për interesa të sigurisë nacionale apo sigurisë publike, për parandalimin e trazirës apo krimit, për mbrojtjen e jetës apo moralit apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Ky nen nuk parandalon caktimin e kufizimeve të ligjshme në ushtrimin e këtyre të drejtave nga pjesëtarët e forcave të armatosura, të policisë apo të administratës së shtetit."

1. Parashtresat e palëve

237. Ankuesit parashtrojnë se, më 10 shkurt 2007, Lëvizja Vetëvendosje kërkonte të ushtrojë të drejtën e vet për tubim paqësor; se demonstrata ishe organizuar dhe planifikuar "në sytë e publikut disa javë para se të mbahej". Ankuesit gjithashtu theksojnë se UNMIK-u ishte plotësisht në dijeni për itinerarin që do ta kishte demonstrata, dhe se UNMIK-u kishte pasur kohë të mjaftueshme të përgatisë dhe vendosë në vend masa adekuate paqësore të reagimit. Sipas ankuesve, demonstrata ishte paqësore për nga karakteri derisa Policia e UNMIK-ut përdori gazin lotsjellës dhe plumbat e gomës për të shpërndarë demonstratën. Ankuesit pranojnë se, pas kësaj, disa "elemente të çorientuara në turmë u përgjigjën duke gjuajtur objekte në drejtim të policisë".

238. Sipas mendimit të ankuesve, "nuk mundet të thuhet në mënyrë të arsyeshme se autoritetet e UNMIK-ut nuk ranë ndesh" me të drejtën e tyre për liri të tubimit sepse:

- demonstrata ishte penguar ta ketë itinerarin e vet të planifikuar;
- ishte përdorur forcë që kërcënonte jetën për t'i shpërndarë ata që morën pjesë në demonstratë;
- njëri nga organizatorët kryesorë të demonstratës ishte ndjekur për rolin e tij në demonstratë.

239. Ankuesit pohojnë më tutje se kjo ndërhyrje ishte e pajustifikueshme dhe joproporcionale, sepse:

- organizatorët e demonstratës janë pajtuar me kërkesat e vendosura nga ligjet vendore për sa i përket organizimit dhe përgatitjes së demonstratës;
- demonstrata kishte qëllime të ligjshme dhe nuk kishte asnjë bazë të veçantë, sikur rrezik i madh për pronën apo rrezik për jetë apo gjymtyrë, e cila do ta arsyetonte ndërhyrjen serioze në demonstratë;
- nuk ka pasur urdhër të qartë për policinë që të përdorë plumba gome, prandaj përdorimi i kësaj force për t'i shpërndarë protestuesit ishte e paligjshme;
- policia nuk bëri përpjekje madje as të marrë në konsideratë ndonjë "ndërhyrje më pak serioze në demonstratë", por më saktë "pothuajse menjëherë ndali demonstratën dhe përdori forcë që kërcënonte jetën kundër pjesëmarrësve të saj".

240. Prandaj, sipas mendimit të ankuesve, autoritetet e UNMIK-ut shkelën të drejtat e tyre sipas nenit 11 të KEDNJ-së përmes aksioneve të tyre më 10 shkurt 2007 që "goditi mu në zemër të konceptit të lirisë për tubim".

241. Nga ana e tij, PSSP-ja konsideron në fillim se ankuesit nuk kanë pretendime specifike për shkelje të këtij neni dhe që "Vlerësimi preliminar i Panelit nuk specifikon ndonjë të dhënë për shkelje të mundshme". PSSP-ja, megjithatë, po ashtu thekson se "UNMIK-u megjithatë nuk i ka vënë ndonjë kufizim të drejtës së anëtarëve të Vetëvendosjes për t'u bashkuar me të tjerët dhe për protestë në ditën në fjalë", dhe se "Policia e UNMIK-ut ishte e pranishme për të mbështetur Policinë e Kosovës dhe mbrojtur ndërtesat dhe të sigurojë kontroll të turmës."

2. Vlerësimi i Panelit

a. Aplikueshmëria e nenit 11 të Konventës

242. E drejta për t'u tubuar dhe bashkuar e garantuar sipas nenit 11 të KEDNJ-së, përbën shtyllën esenciale për të ekzistuar një shoqëri pluraliste dhe tolerante, meqë ajo i shërben qëllimit të lejimit të shprehjes së mendimeve, besimeve dhe praktikave politike, kulturore dhe religjioze, duke përfshirë shprehjen e mendimeve të pakicës dhe/apo kundërshtuese (shih GJEDNJ, *Çiloğlu dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 7333/01, vendimi i 6 marsit të vitit 2007, § 51).

243. Paneli rithekson se ky nen vetëm mbron të drejtën në "tubim paqësor"; ai nuk përfshin situatat ku organizatorët dhe pjesëmarrësit e ndonjë tubimi publik kanë qëllime të dhunshme (shih GJEDNJ, *G. kundër Gjermanisë*, nr. 13079/87, vendimi i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut i 6 marsit të vitit 1989, *Vendimet dhe raportet* 60, f. 256; GJEDNJ, *Të krishterët kundër racizmit dhe fashizmit kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i Komisionit i 16 korrikut të vitit 1998, nr. 8440/78, *Vendimet dhe raportet* 21, f. 138), apo ku tubimi ka shumë të ngjarë të rezultojë në dhunë (shih GJEDNJ, *Stankov dhe Organizata e Bashkuar Maqedonase Ilinden kundër Bullgarisë*, nr. 29221/95 dhe 29225/95, vendimi i 2 tetorit të vitit 2001, § 77, KEDNJ2001-IX).

244. Megjithatë, pasi e drejta për tubim paqësor paraqet njërin nga themelet e një shoqërie demokratike, ajo nuk duhet interpretuar në mënyrë restriktive (shih p.sh. GJEDNJ, ÉvaMolnár kundër Hungarisë, nr. 10346/05, vendimi i 7 tetorit të vitit 2008). Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se termi "paqësor" duhet interpretuar ashtu që të përfshijë sjelljen që mund të shqetësojë apo shkaktojë kundërvajtje ndaj personave (shih GJEDNJ, *Fáber kundër Hungarisë*, nr. 40721/08, vendimi i 24 korrikut të vitit 2012, § 37), dhe madje sjellje që përkohësisht pengon, ndalon apo bllokon aktivitetet e palëve të treta (shih *Udhëzimet mbi lirinë e tubimit publik. Botimi i dytë*, i përgatitur nga Paneli i ekspertëve i OSBE /ZIDDNJ mbi Lirinë e Tubimit dhe nga Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut), Varshavë/Strasburg, OSBE/ZIDDNJ, 2010, 1.3)[9] .

245. Paneli gjithashtu rikujton qëndrimin e Gjykatës Evropiane, në të cilin thuhet se "E drejta për tubim e një individi nuk pushon si rezultat i dhunës sporadike apo akteve tjera të dënueshme të kryera nga të tjerët gjatë demonstratës, nëse individi në fjalë mbetet paqësor në qëllimet apo sjelljen e tij apo saj (shih GJEDNJ, *Ziliberberg kundër Moldavisë*, nr. 61821/00, vendimi i 4 majit 2004, § 2; GJEDNJ, *Primov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 17391/06, vendimi i 12 qershorit të vitit 2014, § 155). Paneli rikujton

[9]Në dispozicion në faqen e OSBE-së [burimi elektronik]: http://www.osce.org/odihr/73405 (e qasur më 25 shkurt 2015)

më tutje se "[M]undësia e ekstremistëve me qëllime të dhunshme, jo anëtarëve të asociacionit organizues, për t'iu bashkuar demonstratës nuk mundet si e tillë të heqë [të drejtën sipas nenit 11]. Madje edhe nëse ka rrezik real për procesion publik që rezulton me çrregullim për shkak të zhvillimeve jashtë kontrollit të atyre që e organizojnë atë, procesioni i tillë nuk bie vetëm për këtë arsye jashtë fushëveprimit të nenit 11 (1) të Konventës" (shih *Të krishterët kundër racizmit dhe fashizmit kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 243 më lart, në f. 148).

246. Duke aplikuar parimet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të dosjes, Paneli konsideron se nuk ka asnjë indikacion se, ata që ishin të përfshirë në organizimin e demonstratës kishin planifikuar nga fillimi të përdorin ndonjë dhunë serioze. Prandaj, madje edhe nëse autoritetet e UNMIK-ut kishin arsye për të besuar se dhuna dhe provokimet kundër policisë mund të ndodhin, në mungesë të ndonjë dëshmie për të kundërtën, demonstrata e organizuar nga Vetëvendosje në qendër të Prishtinës, më 10 shkurt 2007, duhet konsideruar si tubim paqësor. Prandaj, neni 11 vlen plotësisht për këtë rast.

b. Ekzistenca e një interference me të drejtat e ankuesve

247. UNMIK-u mbron pohimin se "nuk i ka vënë ndonjë kufizim të drejtës së anëtarëve të Vetëvendosjes për t'u bashkuar me të tjerët dhe për protestë në ditën në fjalë". Ankuesit nuk pajtohen dhe deklarojnë se ka pasur interferencë në të drejtat e tyre, dhe se interferenca ishe e paarsyeshme dhe qartë joproporcionale.

248. E para, Paneli rikujton në këtë drejtim deklaratën e PSSP-së në lidhje me obligimin esencial të nenit 2 të KEDNJ-së, që konfirmon se Misioni plotësisht pranon dhe qëndron prapa konkluzioneve të prokurorit special të paraqitura në raportet e tij mbi çështjen (shih § 144 më lart). Në Raportin e parë të prokurorit special në lidhje me këtë thuhet:

> "Gjatë rrjedhës së demonstratës protestuesit hodhën objekte mbi policinë dhe iu vërsulën njësiteve të SHPK-së që kishin bllokuar rrugën "Nënë Tereza" ndërsa i afroheshin ndërtesës së Qeverisë. Policia zbrazi bombolat me gaz lotsjellës dhe pastaj avancoi poshtë rrugës "Nënë Tereza" ku ndodhën përleshje të tjera. Lëndime pësuan policia dhe protestuesit."

249. Përveç kësaj, Paneli thekson se ankuesit morën pjesë në demonstratë me qëllimin për të protestuar kundër Planit të Ahtisaarit, një propozim i pranuar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe UNMIK-u, i cili ishte i rëndësishëm për të ardhmen e Krahinës. Qëllimi i tyre ishte me sa duket të tërheqin vëmendjen publike për këtë dokument dhe t'i inkurajojnë njerëzit që ta kundërshtojnë atë. Megjithatë, takimi i tyre u përfundua me forcë nga forcat policore, pasi një grup i vogël i aktivistëve provoi të depërtojë përmes kordonit të policisë dhe t'i afrohet ndërtesës së Qeverisë, me sa duket për shkak të një kërcënimi për çrregullim të madh publik.

250. Sipas mendimit të Panelit, qëllimi që autoritetet e UNMIK-ut e kishin ndaj ngjarjeve publike të organizuara nga Lëvizja Vetëvendosje, që u materializua përmes interferencës në demonstratë dhe forcës së përdorur për t'i shpërndarë pjesëmarrësit, ishte i dizajnuar të ketë "efekt trishtues" dhe t'i dekurajojë pjesëmarrësit që të marrin pjesë në takime të ngjashme (krahasoje me GJEDNJ, *Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë*, nr. 1543/06, vendimi i 3 majit të vitit 2007, §§ 67-68).

251. Prandaj, Paneli konsideron se ankuesit janë prekur negativisht nga intervenimi policor dhe ka pasur padyshim një interferencë në ushtrimin e së drejtës së tyre për liri të tubimit publik.

c. Arsyetimi për interferencë

252. Paneli rithekson se një interferencë do të përbëjë shkelje të nenit 11 po të mos "parashihet me ligj", ndjek një apo më shumë qëllime legjitime sipas paragrafit 2 dhe është "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për arritjen e atyre qëllimeve.

253. Në lidhje me këtë, Paneli vëren që interferenca në rastin aktual kishte bazë ligjore në Ligjin e Përgjithshëm mbi Rendin dhe Qetësinë Publike dhe *lex specialis* në Ligjin mbi Tubimin Publik. Madje edhe nëse supozohet se interferenca është "paraparë me ligj" në kuadër të kuptimit të nenit 11 (2) të Konventës dhe se ndiqet një qëllim legjitim, Paneli e konsideron të nevojshme të shqyrtohet nëse ajo në fakt është "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

254. Paneli, e para, rikujton se autoritetet e kanë për detyrë të marrin masa të duhura për sa i përket demonstratave të ligjshme me qëllim të sigurimit të drejtimit të tyre paqësor dhe sigurisë së të gjithë qytetarëve (shih GJEDNJ, *Oya Ataman kundër Turqisë*, nr. 74552/01, vendimi i 5 dhjetorit të vitit 2006, § 35). Paneli gjithashtu thekson se autoritetet jo vetëm që duhet të mbrojnë të drejtën për tubim paqësor, por gjithashtu duhet të përmbahen nga aplikimi i kufizimeve të paarsyeshme indirekte për atë të drejtë. Në lidhje me këtë, masat e marra duhet të jenë proporcionale dhe të paraqesin mjetet më së paku kufizuese dhe të rënda në mesin e atyre që janë arsyeshëm në dispozicion për t'i shërbyer qëllimit të njëjtë.

255. Paneli vëren që në kohën në fjalë legjislacioni i aplikueshëm nuk kërkonte një autorizim zyrtar nga autoritetet për mbajtjen e demonstratave publike; por organizatorët ishin të obliguar t'i njoftojnë autoritetet (policinë dhe komunën) 48 orë para ngjarjes (Neni 3, Ligji mbi Tubimin Publik). Në lidhje me këtë, Paneli rikujton qëndrimin e Gjykatës Evropiane, i cili konfirmon se është e rëndësishme që asociacionet dhe të tjerët që organizojnë demonstrata, si aktorë në proces demokratik, t'i respektojnë rregullat që rregullojnë atë proces duke u pajtuar me rregulloret në fuqi (shih GJEDNJ, *Oya Ataman kundër Turqisë*, përmendur në § 254 më lart, § 38). Në këtë rast të veçantë, nuk është paraqitur asnjë njoftim zyrtar. Megjithatë, Vetëvendosje në disa raste ka njoftuar publikisht për demonstratën; më 29 janar 2007, një buletin në lidhje me atë gjithashtu është publikuar nga Lëvizja.

256. Duket se demonstruesit, duke përfshirë ankuesit, dëshiruan të tërheqin vëmendjen për një propozim të ndjeshëm lidhur me të ardhmen e Kosovës dhe se tubimi i tyre ishte në fillim paqësor. Megjithatë, kishte të ngjarë se ata do të mund të shkaktonin trazirë para ndërtesës së Qeverisë në qendër të Prishtinës. Prandaj, policia nuk lejoi demonstratën të vazhdojë te ndërtesa e Qeverisë, duke bllokuar rrugën me kordon policor.

257. Ankuesit mbrojnë pohimin se ishin barrierat e policisë që i parandaluan ata të vazhdojnë për në ndërtesën e Qeverisë, që i bëri protestuesit të përplasen në një konfrontim fizik me policët, ndërsa tentonin të gjejnë rrugën e tyre nëpër kordon. Paneli nuk e pranon këtë pikëpamje.

258. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se negocimi dhe/apo ndërmjetësimi mund të jenë të dobishme që të mos eskalojë konflikti: "Nëse ka dështim të plotë për të arritur marrëveshje apo mospajtim tjetër gjatë rrjedhës së tubimit, negocimi apo dialogu i ndërmjetësuar mund të jetë mjet i duhur për të provuar për të arritur zgjidhje të pranueshme. Dialogu i tillë – megjithëse jo gjithmonë i suksesshëm – mund të shërbejë si mjet parandalues për të ndihmuar që të shmanget eskalimi i konfliktit, detyrimi i kufizimeve arbitrare dhe të panevojshme, apo mbështetja në përdorimin e forcës" (shih OSBE/ZIDDNJ dhe Udhëzimet e Komisionit të Venedikut, përmendur në § 244 më lart, në 5.4). Megjithatë, në këtë rast, Paneli nuk e sheh ndonjë indikacion të një përpjekjeje të udhëheqjes së Vetëvendosjes që të bisedojë me Policinë e UNMIK-ut.

259. Megjithatë, Paneli vëren që nuk ka asnjë dëshmi që tregon se demonstrata në përgjithësi, dhe veçanërisht të vdekurit z. Mon Balaj dhe z. Arben Xheladini dhe të plagosurit z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj, kanë paraqitur një rrezik serioz për rendin publik as para përpjekjes për të depërtuar përmes kordonit policor, apo pas saj. Megjithëse demonstrata gradualisht u bë e dhunshme, nuk ka asnjë indikacion se ata vetë ishin të përfshirë në ndonjë dhunë apo se ata kishin qëllime të dhunshme.

260. Paneli konsideron se, madje edhe nëse ka pasur një rrezik, veçanërisht kur konfrontimi fizik në mes policëve dhe demonstruesve filloi, reagimi i policisë është dashur të jetë selektiv dhe gradual. Përgjithësisht pranohet se, kur ka konfrontim me një demonstrim agresiv, aksioni i policisë duhet t'i vë në shënjestër ata demonstrues specifikë të cilët veprojnë dhunshëm (shih GJEDNJ, *Ziliberberg kundër Moldavisë*, përmendur në § 245 më lart, dhe GJEDNJ, *Ezelin kundër Francës*, vendimi i 26 prillit të vitit 1991, seria A nr. 202; shih gjithashtu OSBE/ZIDDNJ dhe Udhëzimet e Komisionit të Venedikut, përmendur në § 244 më lart, në §§ 25, 71, 111, 159, 164 dhe 167).

261. Përveç kësaj, policia duhet të përdorë mjete më të rrezikshme të reagimit kur ato më pak të rrezikshmet janë provuar të jenë joefektive, pas njëvijimësie të përdorimittë forcës që duhet të përcaktohet me ligj dhe përfshijnë komandat me gojë, përdorimi i duarve dhe forcës së trupit, topi me ujë, gazi lotsjellës dhe agjentët e tjerë kimikë, shkopinjtë apo armët e tjera që kanë ndikim, qentë, plumbat plastikë apo të gomës dhe objektet e tjera jovdekjeprurëse, dhe vetëm në fund forca vdekjeprurëse. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se Gjykata Evropiane e ka theksuar vazhdimisht nevojën e, së pari, kërkimit ndihmë nga tjetri, më pak mjeteve të forcës që kërcënojnë jetën, sikur gaz lotsjellës apo topa uji, para përdorimit të forcës që kërcënon jetën (shih GJEDNJ, *Simşek dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 35072/97 dhe 37194/97, vendimi i 26 tetorit të vitit 2005, § 108, shih gjithashtu OSBE/ZIDDNJ dhe Udhëzimet e Komisionit të Venedikut, përmendur në § 244 më lart, në 5.5 dhe §§ 171-172). Përveç kësaj, mjetet veçanërisht të rrezikshme, sikur bombolat me gaz lotsjellës, duhet të përdoren në pajtim të qartë me udhëzimet e aplikueshme teknike për të shmangur dëmin e panevojshëm, dhe në veçanti të mos hedhen "drejt në njerëz".

262. E tillë nuk ishte situata në terren më 10 shkurt 2007, ku disa policë bënë të kundërtën. Atë ditë, menjëherë pasi një grup shumë i vogël i protestuesve të paarmatosur (rreth 10 persona) provuan të kalojnë përmes kordonit policor, autoritetet intervenuan me shpejtësi me forcë të konsiderueshme me qëllim të shpërndarjes të krejt demonstratës, dhe nëpërmjet kësaj shkaktuan ngritje të tensioneve, të pasuara me përleshje sporadike. Panelit i duket se reagimi i duhur ndaj atij akti të veçantë do të mund t'i shtynte

protestuesit të zmbrapseshin, të ruajnë linjën e policisë dhe të marrin veprim individual drejtpërdrejt kundër këtij grupi të protestuesve.

263. Përkundrazi, bombola me gaz lotsjellës dhe plumba gome ishin gjuajtur pa diskriminim në turmë, duke goditur dhe lënduar protestuesit pa menduar për jetët e tyre dhe sigurinë; shumica e atyre protestuesve nuk po provonin të bëjnë diçka të dhunshme kundër policisë. Si rezultat, pjesëmarrësit në demonstratë u bënë më nervozë dhe u përgjigjën me gjuajtjen e objekteve të rënda mbi policinë. Në vend të përpjekjes për të qetësuar situatën, policia reagoi me përdorimin e më shumë gazi dhe plumbash gome. Përveç kësaj, disa pjesëmarrës në demonstrate ishin vënë në shënjestër qëllimisht me plumba gome, madje edhe kur nuk paraqisnin ndonjë rrezik.

264. Kjo situatë mori jetët e dy demonstruesve, dhe u shkaktoi plagë të ndryshme, duke përfshirë plagëserioze dhe ato të rrezikut për jetë, një numri të madh protestuesish tjerë, duke përfshirë dy nga ankuesit. Për sa i përket palës tjetër në përleshje, lëndimet e policëve ishin tepër të vogla, pasi shumica nga ta kishin "pajisjen e plotë KTT" (shih §§ 40 dhe 46 më lart). Sipas mendimit të Panelit, kjo mbështet pohimin se megjithëse ka pasur ca dhunë, niveli i rrezikut për policët ishte i ulët.

265. Paneli gjithashtu rikujton një konkluzion të prokurorit special të UNMIK-ut që hetonte çështjen, ku ai konfirmoi se "vdekjet e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit ishin të panevojshme dhe të shmangshme. Duket të mos ketë pasur asnjë justifikim për të shtënë në kokë të Mon Balajt dhe në kokë të Arben Xhelladinit apo në gjoks të Zenel Zenelit." Në raportin e njëjtë, prokurori special theksoi se "Qëllimet e planit operacional ishin të mbrohen ndërtesat dhe të kontrollohet turma [por] [s]hkaktimi i lëndimeve fatale dhe afër fatales ndodhi në një distancë të konsiderueshme nga ndërtesat qeveritare që duhej mbrojtur."

266. Në lidhje me këtë, Paneli rithekson qëndrimin e Gjykatës Evropiane, i cili nënvizon se ku demonstruesit nuk përfshihen në akte të dhunës, është e rëndësishme për autoritetet publike të shfaqin një shkallë të caktuar të tolerancës ndaj tubimeve publike, nëse lirisë së tubimit të garantuar me nenin 11 të Konventës nuk i hiqet e gjithë substanca (shih GJEDNJ, *NurettinAldemir dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 32124/02 et al., vendimi i 18 dhjetorit të vitit 2007, § 46; GJEDNJ, *Primov dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur në § 245 më lart, në §§ 118 dhe 145).

267. Prandaj, Paneli konsideron se në rastin aktual intervenimi me forcë i policëve ishte joproporcional dhe jo i nevojshëm në një shoqëri demokratike për parandalimin e trazirës në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 11 të Konventës Evropiane.

268. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Paneli konstaton se ka pasur shkelje të nenit 11 të KEDNJ-së.

V. KOSTOT DHE SHPENZIMET

269. Ankuesit i kanë kërkuar Panelit të vendosë mbi çështjen e kompensimit dhe pagesës së kostove dhe shpenzimeve (parashtresa e 17 shkurtit të vitit 2009, §§ 291.3 dhe 291.4; parashtresa e 3 korrikut të vitit 2009, § 70.2). Po ashtu është bërë e ditur se "Përfaqësuesit ligjorë të [a]nkuesve do të bëjnë parashtresa më të detajuara në lidhje me këtë aspekt të

ankesës kur është e përshtatshme" (parashtresa e 17 shkurtit të vitit 2009, § 292). Megjithatë, Paneli nuk ka pranuar asnjë parashtresë të tillë.

VI. KOMENTE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

270. Paneli thekson se dështimi për t'i mbrojtur jetët përbën shkelje serioze të të drejtave të njeriut. Paneli gjithashtu thekson që UNMIK-u si administrues territorial i Kosovës nga viti 1999 deri më 2008 kishte përgjegjësinë primare për një mbrojtje të tillë.

271. Do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i korrigjojë aq sa është e mundshme efektet nga kjo. Megjithatë, pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës, më 17 shkurt 2008, dhe më pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u ndaloi kryerjen e funksioneve ekzekutive në Kosovë. Ky fakt kufizon aftësinë e tij për të siguruar korrigjim të plotë dhe efektiv të shkeljeve të kryera, siç kërkohet me parimet e vendosura në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

272. Megjithatë, Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për t'i korrigjuar aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.

273. Në lidhje me gjetjen e shkeljes së obligimit procedural të nenit 2, Paneli thekson se personat, të cilët janë drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt përgjegjës për vdekjet e z. MonBalajt dhe z. Arben Xheladini dhe shkaktimin e plagëve serioze trupore z. ZenelZeneli dhe z. MustafëNerjovajt, mbesin të paidentifikuar deri më tani.

274. Paneli gjithashtu e ka parasysh faktin se dëmi material që iu shkaktua ankuesve me vrasjen e z. Mon Balaj dhe z. Arben Xheladini dhe plagëve të shkaktuara z. Zenel Zenelit dhe z. Mustafë Nerjovajt është kompensuar në mënyrë adekuate nga OKB-ja përmes procesit të ankesave nga pala e tretë (shih § 8 më lart). Prandaj, nuk kërkohet asnjë kompensim tjetër në këtë drejtim. Megjithatë, kompensimi për dëmin moral në lidhje me shkelje të të drejtave të tyre sipas neneve 2 dhe 11 të KEDNJ-së është akoma i nevojshëm.

Për sa i përket ankuesve dhe rastit Paneli konsideron se është e nevojshme që UNMIK-u:

- Të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme përgjegjësinë për sa i përket përdorimit të forcës së tepërt nga UNMIK-u që rezultoi me vrasjen e z. Mon Balaj dhe z. Arben Xheladini dhe plagosjen e z. Zenel Zeneli dhe z. Mustafë Nerjovaj dhe t'u kërkojë falje publike ankuesve në lidhje me këtë;

- Të ndërmarrë hapa të duhur për pagesën e kompensimit adekuat për ankuesit, për dëmin e shkaktuar moral për shkak të shkeljes nga ana e UNMIK-ut të neneve 2 dhe 11 të KEDNJ-së;

- Në rast se hetimi për këtë çështje rihapet, të sigurojë se do t'i ofrohet e gjithë ndihma e nevojshme çdokujt me autoritet që të hetojë këtë çështje, në pajtim me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 66/93, e miratuar më 9 dhjetor 2011, mbi

Përgjegjësinë Penale të Zyrtarëve dhe Ekspertëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Mision.

Paneli gjithashtu e konsideron të nevojshme që UNMIK-u:

- Të ndërmarrë hapa të nevojshëm para organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, për të siguruar që në të gjitha rastet e përdorimit të forcës në operacionet paqeruajtëse të OKB-së, të gjithë pjesëtarët e Policisë Civile të OKB-së respektojnë plotësisht standardet ndërkombëtare dhe që standardet e përgjithshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mbështeten në çdo kohë nga OKB-ja, duke përfshirë kohën kur kryhen funksione administrative dhe ekzekutive mbi një territor.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË OBLIGIMIT ESENCIAL NGA ANA E UNMIK-ut SIPAS NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT E CILA REZULTOI ME VRASJEN E Z. MON BALAJ DHE Z. ARBEN XHELADINIT, SI DHE ME PLAGOSJEN E Z. ZENEL ZENELI DHE Z. MUSTAFË NERJOVAJT;**

2. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË OBLIGIMIT PROCEDURAL SIPAS NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SA I PËRKET OBLIGIMIT TË UNMIK-ut PËR TË KRYER HETIM EFEKTIV PËR VRASJEN E Z. MON BALAJ DHE Z. ARBEN XHELADINI DHE PLAGOSJEN E RËNDË TË Z. ZENEL ZENELIT DHE Z. MUSTAFË NERJOVAJT;**

3. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE NGA ANA E UNMIK-ut PËR SA I PËRKET TË DREJTËS PËR TUBIM PUBLIK TË GARANTUAR ME NENIN 11 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

4. **KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHEN ANKESAT NDARAS SIPAS NENEVE 3, 6 DHE 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

5. **REKOMANDON QË UNMIK-u:**

a. **TË PRANOJË PUBLIKISHT, DUKE PËRFSHIRË MEDIET, PËRGJEGJËSINË PËR DËSHTIMIN E VET QË TË MBROJË JETËT E Z. MON BALAJ DHE Z. ARBEN XHELADINI, SI DHE PËRGJEGJËSINË PËR PLAGOSJEN E Z. ZENEL ZENELI DHE Z. MUSTAFË NERJOVAJT, DHE T'U KËRKOJË FALJE PUBLIKE ANKUESVE NË LIDHJE ME KËTË;**

b. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESVE PËR DËMIN MORAL NË LIDHJE ME GJETJEN E SHKELJEVE TË NENIT 2 DHE 11 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

c. NË RAST SE HETIMI PËR KËTË ÇËSHTJE RIHAPET, TË SIGUROJË SE DO T'I OFROHET E GJITHË NDIHMA E NEVOJSHME ÇDO ORGANI ME AUTORITET TË HETOJË KËTË ÇËSHTJE, NË PAJTIM ME REZOLUTËN 66/93 TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË OKB-së, E MIRATUAR MË 9 DHJETOR 2011, MBI PËRGJEGJËSINË PENALE TË ZYRTARËVE DHE EKSPERTËVE TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA NË MISIONE;

d. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR NË KOMBET E BASHKUARA SI NJË GARANCI PËR MOSPËRSËRITJE;

e. TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIT DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.

Andrey Antonov
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues

Shtojca

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

Plani Ahtisaari – Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i përgatitur nga përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. MarttiAhtisaari
BBP- Policia Kufitare
CRC –Kontrolli i turmës dhe trazirës
DOJ - Departamenti i Drejtësisë
DPKO-Departamenti i OKB-së për Operacione Paqeruajtëse
ECHR - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ECtHR - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
FPU – Njësiti i Formuar Policor
FRY - Republika Federale e Jugosllavisë
GC – Dhoma e Lartë e GJEDNJ-së
HRAP - Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
HRC - Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut
IPO – Polic ndërkombëtar
KFOR - Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
KPS – Shërbimi Policor i Kosovës
MHQ – Shtabi (Selia) i Përgjithshëm
MSD – Lëvizja për Vetëvendosje
MSU – Njësiti Shumëkombësh për Mbështetje
ODIHR – Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut
OHCHR- Zyra e Komisarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut
Ops Plan – Plani Operacional i quajtur "Urdhri Operacional Demonstratat e LVV më10 shkurt 2007" i përgatitur nga Policia e UNMIK-ut
OSCE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PCCK – Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
PCPCK – Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës
PIK – Inspektorati Policor i Kosovës
PISG – Institucionet e Përkohshme për Vetëqeverisje
RIU - Njësiti Rajonal për Hetim
ROSU – Njësiti Rajonal për Mbështetje të Operacioneve
SPU – Njësiti Special i Policisë
SAP – Krahina Socialiste Autonome
SRSG - Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (të Kombeve të Bashkuara)
UN - Kombet e Bashkuara
UNMIK - Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë